
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti VI (XX) - Nr. 23 (176) ISSN: 2305-655X

SHKENCA ISLAME | SOCIOLOGJ | PSIKOLOGJ | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

23

2018

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI VI (XX) 2018, NR. 23 (176)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2018

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI VI (XX), prill, maj, qershor 2018 nr. 23 (176)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: **Godina e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Foto G. Marubi, 1938.**

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al
www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Ruajtja e identitetit fetar në një shoqëri moderne,
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë5
2. Sfidat e myslimanëve në shekullin XXI,
**Dr. Mustafa Ceriç, President i Asamblesë Botërore Boshnjake,
Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë**13
3. Etika e punës nga këndvështrimi Islam,
Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup19
4. Shtatë llojet e këndimit të Kur'anit,
Adnan Merja, SHBA31

Sociologji

5. Globalizmi, dialogu, feja dhe metafizika,
Dr. Genti Kruja, Kryeredaktor i Revistës Shkencore “Zani i Naltë”
.....41

Studime

6. Detyrat e imamëve dhe thirrësve drejt myslimanëve dhe të tjerëve”,
**Dr. Xhemal Seferti, Departamenti i Shkencave Islame,
Kolegji Universitar “Bedër”**49

Jurisprudencë

7. Garancitë Juridiko-Kushtetues i të Drejtave të Bashkësive Fetare në Shqipëri,
Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës56

Histori

8. Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909),
**Syrja bej Vlora, pjesa e I-rë, editor Dr. Hasan Bello,
Instituti i Historisë, QSA**68

Reçencë

9. Reçencë mbi librin: “*Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912)*” me autor Dr. Nuredin Ahmeti,
Dr. Ilirjana Kaceli, KU “Bedër”91

Personalitet

10. Hafiz Halit Bushati96

Retrospektivë

11. Nji andërr e imja, Hafiz Ibrahim Dalliu103
12. Abstracts in English117
13. Rregullat e shkrimit126



Ruajtja e identitetit fetar në një shoqëri moderne

Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë

Abstrakt

Njëra prej dukurive, që më së shumti vibet re në jetën shoqërore të myslimanëve, në mbarë Evropën sot, pa dyshim, është shprehja e lirë e vetëdijes fetare, e cila ishte aq e penguar në shtetet evropiane me regjim komunist dhe kjo shprehje e lirë e vetëdijes fetare është fryt i çmuar i zhvillimit të demokracisë në jetën tonë, pas shembjes së komunizmit.

Sot evropianët, masa dërmuese, e kanë të defnuar identiteti e tyre fetar, kombëtar dhe shtetëror shumë qartë dhe bindshëm, ku barazia ndëretnike, toleranca ndërfetare dhe multikultura kanë genë dhe mbeten të domosdoshme. Po ndodh dhe, nuk është aspak e vështirë që të vërehet, se nganjëherë shprehja e vetëdijes fetare, vende-vende e kohë pas kohe, po sendërtohet përmes tejshquarjes, tejtheksimit, tejvlerësimit të ndonjë besimi karshi besimeve të tjera. Përkatësia multifetare, përpos që e bën më të pasur dhe më të përbërë identitetin fetar, mund të ndodhë ndonjëherë, ta bëjë edhe më të plogshëm, natyrisht, në qoftë se ndonjëra prej këtyre feve do të favorizohet, e posaçërisht prej institucioneve politike e shtetërore, siç po ndodh kohë pas kohe në disa vende evropiane. Islami nuk pranon dhe nuk duhet t'i nënshtrohet pikëpamjes së inferioritetit, duke humbur individualitetin e as identitetin e tij në asnjë shoqëri e asnjë shtet modern.

Duhet pasur parasysh se kjo botë është e krijuar në atë mënyrë sa që njeriu nuk mund të ekzistojnë krejtësisht më vete edhe pse ai ka identitetin dhe personalitetin e vetë.

Ashtu siç njeriu është qeliza e parë e shoqërisë, ashtu është edhe krijesa më e bukur dhe më e përsosur.¹ Njeriu është një qenie dualiste e përbërë nga trupi dhe shpirti.

1. Kur'ani, surja Et-Tijn, ajeti 4.

Për trupin thamë që është krijuar në formën më të bukur, por kur mendojmë rreth shpirtit, përballemi me një botë tjetër. Shpirti i njeriut është si një fletë e bardhë, e cila pret që të shkruhet. Njeriu është një qenie tek i cili manifestohet gjendja e tij fizike, morale dhe shpirtërore. Pjesa trupore e njeriut bën jetë kalimtare, ndërsa shpirtit, i cili është pjesë e frymës së Shpirtit të Krijuesit të gjithësisë, është i amshueshëm.

Një parim thelbësor i sociologjisë islame është se Islami siguron një harmoni të përsosur mes individit dhe shoqërisë, duke mbajtur në harmoni njërin me tjetrin. Ai beson në personalitetin individual të njeriut dhe i mban të gjithë personalisht përgjegjës ndaj Allahut xh. sh. dhe, ju garanton të drejtat themelore të individit, madje nuk duhet të lejohet që dikush të abuzojë me të drejtat e tij njerëzore, duke insistuar në mënyrë qytetëruese, për ta ruajtur identitetin e tij fetar dhe kombëtar, pa marrë parasysh se në cilin sistem apo hapësirë gjeografike ndodhet, edhe në qoftë se jeton në të ashtuquajturat, shoqëri moderne.

Njëra prej dukurive, që më së shumti vihet re në jetën shoqërore të myslimanëve, në mbarë Evropën sot, pa dyshim, është shprehja e lirë e vetëdijes fetare, e cila ishte aq e penguar në shtetet evropiane me regjim komunist dhe kjo shprehje e lirë e vetëdijes fetare është fryt i çmuar i zhvillimit të demokracisë në jetën tonë, pas shembjes së komunizmit.

Sikundër gjithë evropianët, po ashtu edhe shqiptarët, në masë të madhe, e kanë të definuar identitetin e tyre fetar, kombëtar dhe shtetëror shumë qartë dhe bindshëm. Synimi i tyre i përhershëm ishte barazia ndëretnike, toleranca ndërfitare e multikultura; këto kanë qenë dhe mbeten të domosdoshme. Ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë që, në emër të tolerancës fetare, etnike dhe kulturore, të aplikohet i ashtuquajturi diskriminim pozitiv. Assesi, mendoj unë, nuk mund të lejohet e as të pranohet, në emër të tolerancës; tjetërsimi, inferioriteti, përbuzja, nënçmimi, fyerja e shumicës apo, siç e heton dhe quan, pak më butë, një Akademik i joni si tejshquarje e njëres vetëdije fetare². Shoqëria Islame, e cila përbëhet nga shumë kombe dhe kultura të ndryshme, ka pasur një qytetërim të përbashkët dhe një identitet të përbashkët, në një farë mase, pavarësisht nga ekzistenca e dallimeve-diversiteteve midis anëtarëve të saj. Mendoj se edhe është e mundur të specifikohen burimet e këtyre ngjashmërive kulturore, të cilat duken jashtëzakonisht të dukshme në një shkallë globale.

Sot evropianët, masa dërmuese, e kanë të definuar identiteti e tyre fetar, kombëtar dhe shtetëror shumë qartë dhe bindshëm, ku barazia

2. Rexhep Qosja, Identiteti kombëtar dhe vetëdija fetare, "Forumi Shqiptar", 10 shkurt, 2006.

ndëretnike, toleranca ndërftare dhe multikultura kanë qenë dhe mbeten të domosdoshme. Po ndodh dhe, nuk është aspak e vështirë që të vërehet, se nganjëherë shprehja e vetëdijes fetare, vende-vende e kohë pas kohe, po sendërtohet përmes tejshquarjes, tejtheksimit, tejvlerësimit të ndonjë besimi karshi besimeve të tjera. Përkatësia multifetare, përpos që e bën më të pasur dhe më të përbërë identitetin fetar, mund të ndodhë ndonjëherë, ta bëjë edhe më të plogshëm, natyrisht, në qoftë se ndonjëra prej këtyre feve do të favorizohej, e posaçërisht prej institucioneve politike e shtetërore, siç po ndodh kohë pas kohe në disa vende evropiane. Islami nuk pranon dhe nuk duhet t'i nënshtrohet pikëpamjes së inferioritetit, duke humbur individualitetin e as identitetin e tij në asnjë shoqëri e asnjë shtet modern.

Nuk ka dyshim se Qytetërimi islam dhe normat morale juridike islame, janë të përbashkëta dhe unike për gjithë besimtarët myslimanë anekënd botës, pa kufizim kohe apo hapësire. Do theksuar edhe këtu se një nga burimet dytësore të Sheriatit Islam është “*Urfi*”- *Traditat* e një populli, për deri sa ato nuk janë në kundërshtim me parimet burimore islame, kjo edhe për t'u ruajtur identiteti dhe përkatësia, qoftë edhe përmes traditës dhe zakoneve, duke pasur parasysh ndryshimin e pozitave dhe shkallën e veprimit sipas

këtyre normave e mësimëve. Islami pranon dallimet dhe diversitetet e qytetërimeve lokale dhe specifikat vendore, kur merren parasysh ndryshimet e natyrave të popujve që i përkasin Islamit, natyrat e vendeve të ndryshme, natyrat e sistemimeve qeverisëse si dhe pozitave gjeografike, përkatësive kombëtare, dokeve, traditave etj.

Edhe pse struktura politike dhe ekonomike e qytetërimit islam, në nivel global, herë pas here ka përjetuar tronditje; edhe pse myslimanët brendapërbrenda lëkundjeve, që i ka sjellë rendi i ri botëror, herë-herë, duke rënë në pozitë të injorimit të fesë së vet, duke rendur pas lakmive, që janë të largëta nga thelbi i fesë së tyre, fuqia e Islamit për të ndikuar te besimtarët, vazhdon të jetë shumë e madhe edhe në kohën aktuale.

Problemet dhe sfidat me të cilat përballen myslimanët emigrantë në Perëndim, janë të shumta dhe të llojllojshme dhe nisin e shfaqen në forma të ndryshme, që nga ato personale, individuale, familjare, kombëtare, racore, e deri në nivel komuniteti e shoqërie. Myslmanët emigrantë, brezi i dytë e në vazhdim, që po adaptohet në Evropë, janë në një rrezik në mes të asimilimit, ku ata mund plotësisht të shkrihen në mesin-shoqërinë në të cilën ata ndodhen, dhe, nga ana tjetër, të izolimit në bashkësinë vetanake, në grupime pa ndonjë integrim të rëndësishëm, në shoqërinë në të cilën jetojnë.

Si një problem i theksuar, këtu nuk përjashtohet edhe përgjegjësia jonë. Dhe, mendoj që e vetmja gjë, në rastin konkret, që mund të ruajë dhe të shpëtojë identitetin myslimanëve dhe përkatësinë e tyre, qoftë fetare apo kombëtare, posaçërisht ndaj brezave të ardhshëm që po lindin, zhvillohen, shkollohen, edukohen në Evropë, duhet të jetë integrimi i mirëfilltë në shoqërinë ku jetojnë dhe mësimi e jetësimi i identitetit të tij dhe të përkatësisë. Të gjithë emigrantët në vend të huaj, që kanë fituar statusin e qëndrimit në atë vend, e kanë për detyrë dhe duhet të mësojnë gjuhën e vendit ku ata jetojnë, duhet të respektojnë ligjet e të drejtat e vendit në të cilin ata jetojnë dhe punojnë, por, gjithsesi, duhet të ruajnë e jetojnë fenë dhe kulturën e vet autoktone, gjithnjë në frymën e dialogut, tolerancës dhe bashkëjetesës me të tjerët.

Në mars 2018, Kancelarja Gjermane-Merkel, pas takimit me kryeministrin e Suedisë, Stefan Löfven, mbajti një konferencë për media ku iu përgjigj pyetjes së një gazetari lidhur me atë se çfarë mendon për deklaratën e ministrit të Brendshëm, Horst Seehofer, se “Islami nuk i përket Gjermanisë”, ku ajo tha:

“Shtetin tonë në masë të madhe e ka formësuar krishterimi. Edhe judaizmi ka lënë gjurmë. Por, në ditët tona tanimë në Gjermani jetojnë 4 milionë myslimanë. Pra, edhe myslimanët i përkasin

Gjermanisë si dhe feja e tyre Islami. Ne kërkojmë një Islam në bazë të kushtetutës dhe që i përshtatet kushtetutës...”, theksoi Merkel.

Sipas fakteve të mirënjohura, komuniteti mysliman në Evropë përbën komunitetin me moshën më të re në kontinent. Megjithatë ky komunitet ka problemet e veta. Një numër i madh i të rinjve myslimanë përballen me kriza identiteti, i cili endet ndërmjet kulturës së prindërve të tyre dhe të ambientit ku ata rriten. Si rrjedhojë, ngjallja dhe qëndrueshmëria e Islamit në Evropë duhet të ngrihet mbi këtë kontekst.

Është edhe një realitet që duhet cekur dhe duhet ta ketë në mendje çdo mysliman se, përkatësia dhe qytetërimi islam nuk mund ta kryejë rolin e ndikimit në qytetërimin njerëzor-botëror, nëse bëhet imitues, vjedhës apo viktimë e qytetërimeve të tjera. Ai duhet të ketë një shkallë të lartë të zhvillimit shpirtëror, shoqëror, kulturor e material e jo imitues i verbër i të tjerëve, sepse, siç ka thënë Muhammedi a.s.:

«من تشبه بقوم فهو منهم»

“Kushdo që e imiton një popull ai është prej tyre”³(ai llogaritet si i tjetërsuar dhe lehtë mund të asimilohet). Imituesi i të tjerëve nuk mund ta ruajë identitetin dhe përkatësinë e vet, e lëre më t’i joshë popujt e tjerë ta përvetësojnë atë! Ndikimi mund të arrihet vetëm

3. Sunen Ebi Davud, hadithi 3530 (Hadith Sahih).

nëse myslimani beson bindshëm se qytetërimi i tij është i pavarur, me identitet dhe përkatësi të posaçme, hyjnor, qiellor, i vlefshëm për çdo kohë e vend, i ngritur mbi baza të forta, i mbështetur në Kur'anin dhe hadithet e Pejgamberit a.s.

Është imperativ i kohës që Islami sot të interpretohet, në atë mënyrë që t'i përshtatet kohës dhe vendit në të cilin jetojmë, njëkohësisht, duke mos kapërcyer principet dhe parimet themelore të fesë, por gjithnjë duke u mbështetur mbi bazën e normave ligjore, të dala nga burimet themelore, dhe të mësimëve morale islame. Thënë ndryshe, është e domosdoshme që të lexojmë, të mësojmë, të studiojmë në vazhdimësi Kur'anin dhe Synein e Pejgamberit, por edhe të lirohemi nga mendimet e ngurta që janë grumbulluar gjatë shekujve të kaluar.

Duhet vënë theksi në atë se nevojat elementare të arsimit fetar, në kuptimin më të ngushtë, nisin me edukimin fetar të fëmijës në familje. Mësimi fetar në shkollë do t'u ndihmojë fëmijëve dhe rinisë që sa më lehtë dhe sa më bukur të shoqërohen me moshatarët e vet, të kuptojnë më mirë dhe të respektojnë prindërit e vet, të mësojnë për sjellje të bukur e qytetëruese, të kuptojnë rëndësinë e familjes, miqësisë, humanizmit dhe dashurisë. Dashuria prindërore, kushtet për zhvillim normal, gjuha e nënës, prejardhja gjenealogjike, identiteti dhe përkatësia fetare e

kombëtare, janë detyrimet e para që çdo prind duhet t'i jetësojë në rrethin e ngushtë familjar të brezi i ri. Sa më e fortë të jetë lidhja familjare, aq më e madhe dhe më e fuqishme është lumturia e saj, po aq shtohen, në kohën e sotme, edhe detyrimet, obligimet e problematikave të saj. Sot duhet të ofrojmë përgjigje për çështjet bashkëkohore që kanë nevojë apo i mundojnë myslimanët, e posaçërisht brezin e ri.

Pejgamberi a.s. në lidhje me këtë është prononcuar: “Në çdo brez që do vijë njerëzit e drejtë do ta transmetojnë këtë dije me radhë...”, “Kjo dije është feja, prandaj, kini kujdes nga kush e merrni atë...”

Ndërsa mesazhi i Aliu r. a. për edukimin e fëmijëve ishte:

رَبُّوا أَوْلَادَكُمْ عَلَى غَيْرِ مَا دَرَجْتُمْ عَلَيْهِ لِأَنَّهُمْ
مَخْلُوقُونَ إِلَى زَمَانٍ غَيْرِ زَمَانِكُمْ.

“Edukoni fëmijët tuaj përtej asaj që jeni edukuar ju, ngase ata janë krijuar në një kohë përtej kohës tuaj.”⁴ Apo siç shprehej Haxhi Vehbi Dibra, para tetëdhjetë e sa vjetësh, “...me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjykimet.”⁵

Por edhe praktika e zakonshme e modernistëve, duhej të ndërtohej mbi respektin e mos akuzimin e fesë, aq më tepër Islamit, por ta drejtojnë kritikën drejt fanatikëve. Është

4. Hadi Nasir Seid El-Bakir, “El-Hiuaru El-Mutemeddin”, nr. 2506,

5. Gazmend SHPUZA, “Rëndësia dhe Mesazhi i Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923”, PERLA –Revistë shkencore, Kulturore tremujore, Viti XI 2006, nr. 2 (41) Botuesi: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi” Tiranë

fanatizmi tek autoritetet fetare që i ka zënë frymën lëvizjes shkencore islame, dikur shumë madhështore, e sidomos lirisë së mendimit e të fjalës së lirë.

Pejgamberi a.s., në një rast tha: *“Njeriu që merret me njerëz dhe nuk u bën padrejtësi atyre; dhe bisedon me ta dhe nuk i gënjen; dhe bëri një besëlidhje me ta dhe nuk e thyen atë, një person i tillë është një zotëri i përsosur; dhe ndershmëria e tij dihet (dhe pranohet) dhe vëllazëria e tij vlen të kërkohet.”*⁶

Ndarja e popujve, feve apo kulturave në aziatikë e evropianë, ka konotacione të racizmit, qoftë racizmit nacional apo religjioz. Tani, duket sikur dikush po harron se pozita gjeostrategjike e tokave tona në Evropë, në të cilat kemi jetuar e do të jetojmë, dhe përbërja multifetare e popujve në këto troje, duhet të na bëjnë të mendojmë se fati ynë historik është i paracaktuar për të sendërtuar zbutjen e kundërshtimeve mes Lindjes e Perëndimit.

Duhet hequr etiketimi se Islami na qenkësh fe antievropiane dhe antiperëndimore, kur dihet se trualli i të tri feve monoteiste është i njëjti (Orienti) dhe vetë shpalljet hyjnore janë unike. Mesazhi kur’anor porositi:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا
وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ
بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّنْ دُونِ اللَّهِ*

“**Thuaju** (o Muhamed): **“O ithtarë të librit** (Tevrat e Inxhil), **ejani** (të bashkohemi) **te një fjalë që**

6. Biharu El-Enuari, vol. 75.

është e njëjtë (e drejtë) **mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë tjetër pos All-llahut, të mos i shoqërojmë Atij asnjë shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut!”**⁷(Kur’an, 3:64)

Rrjedhimisht, edhe Islami i shqiptarëve duhet të pranohet ashtu siç është në të vërtetë: përqaftim i Shpalljes Hyjnore, e cila askujt nuk i imponohet me dhunë, por e cila vërtet nuk mund të mposhtet nga asnjë ideologji dhe nga asnjë luftë që i bëhet. Duhet kuptuar se ka ardhur koha të mos injorohet identiteti aktual fetar i shqiptarëve. Në pajtim me këtë, duhet të pranohet edhe kontributi vendimtar i dhënë nga shqiptarët myslimanë në krijimin dhe zhvillimin e identitetit shqiptar dhe në zhvillimin e gjithmbarshëm shqiptar në këta shtatë shekujt e fundit.

Pra, të bëhemi pjesë e familjes evropiane dhe botërore, që synon ndërtimin e një qytetërimi të bazuar në këto vlera, jo e Evropës egoiste, e as e Lindjes së prapambetur tani, por e asaj Evrope, që nuk vuan nga fobia prej një bashkëjetese multikulturore dhe multireligjioze, dhe së cilës nuk i pengon që edhe Islami të jetë pjesë e rëndësishme e jetës dhe zhvillimit të ardhshëm dhe që të mësohet edhe në shkollat shtetërore të Evropës. Ta jetësojmë thënien e Wolfgang Petriç në New York Times: *“edhe Islami është pjesë e traditës evropiane”*.

Kjo do të thotë, sikurse në të kaluarën edhe sot, por edhe në të ardhmen, myslimanët do ta kenë

7. Kur’ani, surja Al ‘Imran, ajeti 64.

rolin e tyre në formësimin e së ardhmes së Evropës. Islami është edhe grupi i dytë më i madh fetar në Evropë.⁸ Në Evropë tanimë jetojnë afër 45 milion myslimanë, popullatë e cila përbën gjashtë për qind të popullsisë së përgjithshme.

“Nuk ka paqe mes kombeve pa paqe mes feve. Nuk ka paqe mes feve pa dialog midis feve. Nuk ka dialog ndërmjet feve pa një studim themelortëfeve”.(Hans Küng)⁹

Por tani, njerëzve të këtyre trojeve, e jo vetëm, por edhe botës në përgjithësi, po ju kanoset, sipas meje, një e keqe tjetër, jo më pak e rrezikshme se ideologjia komuniste. Është kjo një ideologji, që në emër të qytetërimit modern, njerëzve po ju ofrohet, e në njëfarë mënyre, po ju imponohet që të jetojnë gjithnjë më ngjashëm, të shkollohen e edukohen gjithnjë e më njësoj, të mendojnë e flasin për gjëra gjithnjë e më të përbashkëta, të vishen e të ç’vishen ngjashëm, të argëtohen e të festojnë ngjashëm, për mos të thënë njësoj, duke i anashkaluar, qëllimisht, specifikat që i dallojnë një popull nga tjetri, duke mos veçuar një qytetërim nga tjetri, duke abuzuar një kulturë

karshi tjetrës, duke anashkaluar një qytetërim karshi tjetrit, duke favorizuar një fe karshi tjetrës, dhe të gjitha këto bëhen në emër të qytetërimit modern-bashkëkohor e që po e emërtojnë globalizëm.

Çështja e ruajtjes së identitetit dhe përkatësisë fetare, kombëtare e kulturore të myslimanëve në Perëndim është një çështje substanciale, dhe posaçërisht e rëndësishme, siç u tha më lart, për gjeneratën e dytë dhe të tjerët në vijim të myslimanëve në Evropë. E vërteta është se, nga të gjitha komunitetet emigrante, një pjesë e tyre, herët a vonë, është në rrezik për tu asimiluar. Për këtë realitet duhet të jemi të gatshëm edhe ne shqiptarët. Asimilimi i fëmijëve tanë në Perëndim është një proces që tashmë është duke ndodhur. Tani brezi i dytë dhe i tretë i emigrantëve, lidhja e të cilëve me familjen dhe me atdheun nuk është aq e fortë, kanë probleme me identitetin, përkatësinë fetare, por edhe me gjuhën amtare, e të cilët gjithnjë e më shumë po identifikohen dhe personifikohen me vlerat e vendit në të cilin kanë lindur, po shkollohen dhe jetojnë.

Duhet theksuar edhe kjo se, ne shqiptarët, që kemi dy fe (Islamin dhe Krishterimin) me disa konfesionet fetare, paraqesim një shembull karakteristik dhe shumë të avancuar në botën e qytetëruar për tolerancë fetare dhe mirëkuptim ndërfejar.

8. Sipas një studimi të Qendrës Kërkimore të vitit 2011, në botë ishin 49 shtetet në të cilat myslimanët ishin shumicë.

9. Dr. Hans Küng ishte presidenti i Fondacionit për Etikë Globale (Weltethos). Prej vitit 1960 deri në daljen e tij në pension, në vitin 1996, ai ishte profesor i Teologjisë dhe Drejtor i Institutit për Hulumtime të Përgjithshme në Universitetin e Tübingenit.

Th. Arnold për këtë problem thekson: “Ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë nuk ekziston kurrfarë antagonizmi edhe kjo ka vazhduar në breza të tërë. Faktori i besimit nuk ka qenë përçarës ndërmjet tyre.”¹⁰

Vlen të nxjerrim në pah dhe të theksojmë gjithashtu se, shqiptarët, në të kaluarën, nuk u tjetërsuan, por u bënë ballë përpjekjeve për t’u trajtuar si rum, grekë latinë, sllavë apo turq.¹¹

Duhet nxjerrë mësim të dobishme nga përvojat e dy mijëvjeçarëve të shkuar, duke e ruajtur identitetin fetar e kombëtar. Ta zëmë, gjuha shqipe, e cila mbahet si argumenti më i fuqishëm i identitetit kulturor e kombëtar të shqiptarët, në të ardhmen mund të marginalizohet edhe nga vetë shqiptarët, të cilët, nën presionin e globalizimit, integritetit dhe modernitetit, do të parapëlqejnë të flasin e të shkruajnë në gjuhë të

10. Shaqiri, Artan “Rritja e përgjegjësisë individuale dhe shoqërore nëpërmjet edukatës fetare”, “Edukata Islame”, nr. 70, f. 221, Prishtinë, 2003.

11. Gazmend Shpuza, “Rëndësia dhe Mesazhi i Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923”, PERLA –Revistë shkencore – Kulturore tremujore, Viti XI, 2006, nr. 2 (41) f. 102-117, Botuesi: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi” – Tiranë.

tjera si: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, dhe krejt kjo, ndoshta në emër të modernes.

Këto do të ishin pikat kryesore që nuk duhen pranuar nga qytetërimi bashkëkohor dhe në bazë të tyre ta ngrinin projektin tonë qytetërues islam të shpresuar.¹²

Në këtë pikëpamje sociologu francez dhe studiues i njohur mbi modernitetin, Alain Tourain, në veprën e tij “Kritika e modernitetit”, thotë:

“Shoqëria moderne nuk është ajo që shfuqizon të kaluarën dhe besimet, por ajo që transformon të vjetrën në moderne duke mos e shkatërruar atë...”

Në përfundim të themi edhe këtë se çdo shoqëri, patjetër, duhet të ketë kujtesë kolektive për identitetin fetar e kombëtar, që nënkupton historinë dhe kulturën kolektive, e kjo vlen edhe për Islamin. Humbja e kujtesës kolektive, apo shpërbërja e saj, do të ishte një rrezik i madh për mbijetesën e një shoqërie, ngase asnjë shoqëri nuk mund të ekzistojë dhe të ndërtojë të ardhme fatlume, pa pasur një kujtesë kolektive mbi të kaluarën.

12. Marrë nga libri “Hyrje në projektin tonë civilizues” f. 43-49, nga autori Xhemal Sultani.

Dr. Mustafa Ceriç

Kryemyfti Nderi i Bosnjës & President i Asamblesë Botërore Boshnjake Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë

Abstrakt

Megjithëse, çështjet e jashtme ose globale dhe të brendshme në shoqëritë myslimane po konvergojnë fuqishëm dhe pavarësisht faktit se nuk është gjithmonë i dallueshëm se cili prej tyre ka më shumë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm politik të myslimanëve, unë do të thosha se punët e brendshme janë më sfiduese për shpirtin dhe mendjen myslimane sot se sa të jashtmit ose ato globale. Dhe, në kundërshtim me një perceptim të përbashkët se mungesa e një uniteti të fortë mysliman është pengesa më e madhe për një stabilitet dhe prosperitet të përgjithshëm mysliman, megjithatë do të thosha se mungesa e nocionit të qartë të diversitetit në mendimin teologjik dhe politik mysliman është çelësi që shkakton një trazirë dhe madje edhe dhunë të përgjakshme në shoqëritë myslimane. Deri tani besimi islam dhe besimtarët myslimanë janë më të bashkuar në besimet e tyre themelore sesa çdo grup tjetër fetar në botë. Në të vërtetë, pa përjashtim të gjithë myslimanët në mbarë botën kanë të njëjtin besim në origjinën hyjnore të Kur'anit, në originalitetin dhe përshtatshmërinë e Profetit të fundit Muhamed, paqja qoftë mbi të, në drejtimin e dubur në lutjet myslimane drejt Kibles, në të djathtën dhe të njëjtën ditë të Arafatit të pelegrinazhit të haxhit etj. Pra, këtu nuk ka asnjë çështje mospërputhje të myslimanëve për sa i përket pjesëve të tyre themelore të besimit. Prandaj, myslimanët duhet të kursejnë kohë duke u marrë me unitetin që padyshim ekziston. Në vend të kësaj, myslimanët duhet të fillojnë të flasin për faktin e diversitetit të tyre, që padyshim ekziston gjithashtu, por që nuk njihet siç duhet në kuptimin e një mënyre kreative dhe pasuruese siç duhet dhe siç ka qenë gjithmonë. Prandaj, sfida më e madhe e shoqërive myslimane sot, siç e shoh, është të mësojmë se si të jetojmë unitetin në diversitetet e përkatësisë etnike, nacionale, raciale, kulturore dhe politike, në të vërtetë,

potencialet e tyre krijuese. Shkurtimisht, shoqëritë myslimane sot dubet të mësojnë se si të respektojnë dallimet e njëri-tjetrit po aq shumë sa e duan njëri-tjetrin për hir të të njëjtit besim të Islamit. Kjo, me të vërtetë, është më sfiduese se çdo gjë tjetër, pra është më sfiduese sot të vlerësojmë diversitetin mysliman se sa të këmbëngulim për unitetin mysliman si një propagandë boshe që na çon në një populizëm dhe demagogji të lirë. Më lejoni të them, pra, që nëse myslimanët do të respektonin jetën, besimin, lirinë, pronën dhe dinjitetin e njëri-tjetrit aq shumë sa e duan njëri-tjetrin për shkak të besimit të tyre të përbashkët në Zot, në engjëjt e Zotit, në Librat e Zotit, në Profetët e Zotit, në Ditën e Fundit të Gjykimit dhe në dekretin përfundimtar të Zotit për fatin e tyre përfundimtar, shoqëritë e tyre do të ishin shumë më të mira në aspektin e jetës politike dhe shoqërore, të cilën ata e ndajnë edhe me të tjerët dhe do të ishte shumë më mirë në vetë-mjaftueshmërinë e tyre të zhvillimit kulturor, politik dhe civilizues.

Ndihem i nderuar nga ftesa e rektorit të Kolegjit Universitar Bedër në Tiranë, Prof. dr. Ferdinand Gjana për të marrë pjesë në Konferencën e Parë Ndërkombëtare në Studimet Islame me një temë shumë sfiduese: “Sfidat e myslimanëve në shoqërinë e shekullit XXI”. Njëkohësisht edhe unë jam i sfiduar të flas për sfidat e myslimanëve të kësaj kohe.

Në të njëjtën kohë ndihem i kënaqur nga prezenca e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Skender Bruçaj, i cili ka përmbushur premtimin që më ka dhënë në Abu Dabi për një ftesë në Tiranë. Dhe unë jam shumë mirënjohës, që kam këtë mundësi për të takuar vëllezërit dhe kolegët e mi në Ballkan dhe për të folur për sfidat myslimane të kohës sonë. Këtu jam edhe për të dëshmuar përmbushjen e premtimit të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili tashmë

ka fituar një respekt të madh në botën myslimane, po aq sa heroi i madh shqiptar i shekullit XX Shejh Sabri Koçi, i cili meriton të mbahet mend, jo vetëm si hero i Shqipërisë, por edhe si hero i Ballkanit dhe botës myslimane, si një e tërë, për besimin e tij njerëzor dhe mysliman, këmbënguljen në kohë të vështira të mungesës së lirisë fetare (një Fatiha për shpirtin e tij).

Pra, më lejoni të filloj duke thënë se, ndoshta nuk jam plotësisht i përshtatshëm për përgjegjësinë, që më është ngarkuar sot, por sigurisht që kjo është një përgjegjësi krejtësisht dhe sigurisht e rëndë, jo vetëm për mua, por për të gjithë myslimanët, që janë sot kulturalisht dhe politikisht përgjegjës, si dhe moralisht të ndjeshëm.

Në të vërtetë, Islami dhe myslimanët, sot, janë në qendër të vëmendjes, me të drejtë ose jo, më shumë se çdo besim tjetër botëror, dhe jo vetëm në mediat botërore,

por edhe në botën akademike, politike dhe publikun e gjerë. Ajo që nënvizoi Shiraz Maher, në esenë¹ me titull “Çfarë dëshiron vërtet ISIS?”, ishte një sukses i menjëhershëm. Ishte artikulli më i lexuar në historinë thuajse 160 vjeçare të Atlantikut dhe ishte historia më e lexuar digjitale e vitit 2015 - që mori më shumë se një milion faqe gjatë ditës së botimit.

Duket se ne jemi duke u përballur me një fenomen të pashembullt të aktorëve të dhunës, në skenën globale, ku askush nuk e di identitetin e tyre të vërtetë, ose disa e dinë se kush janë, por i fshehin ata, sepse ata duhet të fshehin identitetin e tyre, i cili, nëse zbulohet disi, përdoret kundër tyre në mënyrë të tillë që do të tregoheshin aktorët e vërtetë që ndodhen prapa këtij cirku të përgjakshëm në skenën botërore, që po etiketohen si Islam dhe myslimanë në mbarë botën, dhe që është çmenduri e budallallëk.

Në të vërtetë, myslimanët janë sot përpara një sfide të civilizimit islam, e cila është e pashembullt në tërë historinë e tyre. A duhet t’ju kujtoj për faktin se, qytetërimi islam është ende një qytetërim i gjallë nga një përlllogaritje përkatëse e Matthew Melko, i cili ka plotësuar gjithsej dymbëdhjetë qytetërimet botërore në histori: “shtatë prej të cilave janë zhdukur (Mesopotamia, Egjipti, Kreta, Klasiket, Bizantinët, Amerika

1. Ese dhënë *Graeme Wood* për *The Atlantic*, në shkurt 2015.

e Mesme dhe Andet) dhe pesë prej të cilave mbeten ende (kineze, japoneze, indiane, islame, perëndimore)”. Dhe, siç citon Niall Ferguson, “Shmuel Eisenstadt numëronte gjashtë, duke shtuar qytetërimin hebre në grup”. Për më tepër, Fergusoni vuri në dukje se: “Ndërveprimi i këtyre pak qytetërimeve me njëri-tjetrin, po aq sa edhe me mjediset e tyre, ka qenë ndër nxitësit më të rëndësishëm të ndryshimeve historike. Gjëja mahnitëse për këto ndërveprime është se qytetërimet autentike duket të mbeten origjinale në veten e tyre për periudha shumë të gjata, pavarësisht nga ndikimet e jashtme. Siç tha Fernand Braudel: Civilizimi është në fakt historia më e gjatë e të gjithëve... Një qytetërim... mund të vazhdojë përmes një sërë ekonomish ose shoqërish”.

Ne si myslimanë jemi, me të vërtetë, pjesë përbërëse e të jetuarit në një botë të madhe globale, në krijimin e së cilës kemi marrë pjesë edhe ne. Kështu, ne, jemi të dy pjesët, pjesë e problemit dhe një pjesë e zgjidhjes së kësaj bote globale. Është detyra jonë që të zgjedhim se cila prej këtyre dy pjesëve jemi, problemi apo zgjidhja. Unë besoj se shumica botërore e myslimanëve duan të jenë pjesë kyçe e zgjidhjes dhe aspak e problemit. Pra, kur Žižek thotë se e vetmja pyetje e vërtetë është kjo: a e mbështesim pranimin mbizotërues të kapitalizmit si një fakt i natyrës (njerëzore), apo kapitalizmi i sotëm

global përmban antagonizma mjaft të forta për të parandaluar riprodhimin e saj të pacaktuar? - Ndjem se edhe unë, si mysliman, jam, gjithashtu, pjesë e kësaj pyetjeje. Dhe unë jam pjesë e katër antagonizmave të tij si:

(1) të përbashkëtat e kulturës në kuptimin më të gjerë, të kapitalit “jomaterial”: forma e menjëhershme e socializuar e kapitalit “njohës”, kryesisht gjuha, mjetet tona të komunikimit dhe edukimit, për të mos përmendur sferën financiare me pasojat absurde të qarkullimit virtual të pakontrolluar të parave;

(2) të përbashkëtat e natyrës së jashtme, të kërcënuara nga ndotja njerëzore: të gjitha rreziqet e veçanta - ngrohja globale, vdekja e oqeaneve etj., janë aspekte të një derdhjeje të të gjithë sistemit të riprodhimit të jetës në tokë;

(3) të përbashkëtat e natyrës së brendshme (trashëgimia biogjenetike e njerëzimit): me teknologjinë e re biogjenetike, krijimi i një “Njeriu të Ri” në kuptimin literal të ndryshimit të natyrës njerëzore bëhet një perspektivë realiste;

(4) të përbashkëtat e vetë njerëzimit, e hapësirës së përbashkët politike shoqërore: sa më shumë kapitalizmi merr përhapje globale, aq më shumë mure të reja dhe aparteide po dalin, duke ndarë ata që janë brenda nga ata që janë jashtë.

Me këtë citim dua të theksoj dy grupe sfidash që kanë të bëjnë me aspekte të jashtme ose globale

dhe të brendshme. Me fjalë të tjera, shoqëritë myslimane janë sot në mes të një “IN” ose një “OUT” të kornizës qytetëruese, si një avantazh historik dhe bashkëkohor i mbajtësit të një titulli prestigjioz të një qytetërimi të gjallë midis qytetërimeve të tjera të gjalla të sotme, sidomos qytetërimi perëndimor si ata të dy, qytetërimet islamike dhe perëndimore, qëndrojnë, sipas të gjitha gjasave, si binjakë siamezë. Në të vërtetë, këto dy civilizime janë të pandashme dhe të patjetërsueshme nga njëri-tjetri, pavarësisht se disa njerëz nga të dy kampet dëshirojnë t’i ndajnë ose t’i largojnë nga njëri-tjetri. Këto dy qytetërimi gjenden te katër të përbashkëtat e Zizekut: kultura si një kapital jomaterial, kërcënime të ndotjes së mjedisit, ndryshim biogjenetik të natyrës njerëzore dhe hapësirë shoqërore politike. Secila nga këto katër të përbashkëta është e rëndësishme, por e përbashkëta e hapësirës s shoqërore politike, është ajo e cila mua më duket se është më sfiduesja e të gjithëve.

Megjithës e, çështjet e jashtme ose globale dhe të brendshme në shoqëritë myslimane po konvergojnë fuqishëm dhe pavarësisht faktit se nuk është gjithmonë i dallueshëm se cili prej tyre ka më shumë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm politik të myslimanëve, unë do të thosha se punët e brendshme janë më sfiduese për shpirtin dhe mendjen myslimane sot se sa të jashtmit ose ato globale.

Dhe, në kundërshtim me një perceptim të përbashkët se mungesa e një uniteti të fortë mysliman është pengesa më e madhe për një stabilitet dhe prosperitet të përgjithshëm mysliman, megjithatë do të thosha se mungesa e nocionit të qartë të diversitetit në mendimin teologjik dhe politik mysliman është çelësi që shkakton një trazirë dhe madje edhe dhunë të përgjakshme në shoqëritë myslimane. Deri tani besimi islam dhe besimtarët myslimanë janë më të bashkuar në besimet e tyre themelore sesa çdo grup tjetër fetar në botë. Në të vërtetë, pa përjashtim të gjithë myslimanët në mbarë botën kanë të njëjtin besim në origjinën hyjnore të Kur'anit, në origjinalitetin dhe përshtatshmërinë e Profetit të fundit Muhamed, paqja qoftë mbi të, në drejtimin e duhur në lutjet myslimane drejt Kibles, në të djathtën dhe të njëjtën ditë të Arafatit të pelegrinazhit të haxhit etj. Pra, këtu nuk ka asnjë çështje mospërputhje të myslimanëve për sa i përket pjesëve të tyre themelore të besimit. Prandaj, myslimanët duhet të kursejnë kohë duke u marrë me unitetin që padyshim ekziston. Në vend të kësaj, myslimanët duhet të fillojnë të flasin për faktin e diversitetit të tyre, që padyshim ekziston gjithashtu, por që nuk njihet siç duhet në kuptimin e një mënyre kreative dhe pasuruese siç duhet dhe siç ka qenë gjithmonë. Prandaj, sfida më e madhe e shoqërive myslimane

sot, siç e shoh, është të mësojmë se si të jetojmë unitetin në diversitetet e përkatësisë etnike, nacionale, raciale, kulturore dhe politike, në të vërtetë, potencialet e tyre krijuese. Shkurtimisht, shoqëritë myslimane sot duhet të mësojnë se si të respektojnë dallimet e njëri-tjetrit po aq shumë sa e duan njëri-tjetrin për hir të së njëjtit besim të Islamit. Kjo, me të vërtetë, është më sfiduese se çdo gjë tjetër, pra është më sfiduese sot të vlerësojmë diversitetin mysliman se sa të këmbëngulim për unitetin mysliman si një propagandë boshë që na çon në një populizëm dhe demagogji të lirë. Më lejoni të them, pra, që nëse myslimanët do të respektonin jetën, besimin, lirinë, pronën dhe dinjitetin e njëri-tjetrit aq shumë sa e duan njëri-tjetrin për shkak të besimit të tyre të përbashkët në Zot, në engjëjt e Zotit, në Librat e Zotit, në Profetët e Zotit, në Ditën e Fundit të Gjykimit dhe në dekretin përfundimtar të Zotit për fatin e tyre përfundimtar, shoqëritë e tyre do të ishin shumë më të mira në aspektin e jetës politike dhe shoqërore, të cilën ata e ndajnë edhe me të tjerët dhe do të ishte shumë më mirë në vetëmjaftueshmërinë e tyre të zhvillimit kulturor, politik dhe civilizues.

Dhe sfida e dytë që është në mendjen myslimane sot është disa një fenomen i ri, por një model i vjetër i një interpretimi të qëllimshëm të gabuar dhe keq-prezantimit të Islamit dhe myslimanëve në botë.

Prandaj, ky fenomen mori edhe një emër të ri -Islamofobia-. Nuk është krejtësisht e qartë se çfarë do të thotë Islamofobia, por padyshim që ka për qëllim të turpërojë Islamin dhe myslimanët anembanë botës në çfarëdo mënyre të mundshme. Është e ngjashme me antisemitizmin, por nuk është e njëjtë. Nuk është racial, por ka diçka për të; nuk është kulturore, por ka diçka për të. Është sikur fanatizmi, por nuk është fashist. Ajo është thjesht antagoniste ndaj pranisë së Islamit në vende të caktuara në botë. Në të vërtetë, islamofobia është një frikë e panjohur, e cila njihet si Islami dhe që është emërtuar si islamik, islamist, xhihadist, selefist, vahabist, terrorist etj.

Përsëri, në kundërshtim me një perceptim të përbashkët që islamofobia ka për qëllim të frikësojë, ose terrorizojë, ose madje edhe të konvertoje jo-myslimanët në mbarë botën, veçanërisht në Perëndim, do të thosha se islamofobia kryesisht ka për qëllim të frikësojë dhe të shkaktojë një lloj dhimbjeje të shpirtit dhe mendjes së myslimanëve anembanë botës. Jo myslimanët, veçanërisht hebrenjtë dhe të krishterët në Perëndim, nuk kanë arsye të frikësohen as nga Islami, si një besim i pastër, apo nga myslimanët, si njerëz të vërtetë besnikë. Këto tre religjione monoteiste, fetë e librave të Perëndisë, e kanë strehuar njëri-tjetrin përmes përvojave të ëmbla dhe të hidhura gjatë gjithë historisë së gjatë, njohin potencialet e njëri-tjetrit dhe kështu ata janë të vetëdijshëm për faktin se nuk ka alternativa ndaj bashkëjetesës

së tyre të përbashkët nga një respekt i pashmangshëm i ndërsjellë që të ketë dhe të mbajë përpara, në të mirë o në të keqe, në pasurit dhe në varfëri, për sëmundjet dhe shëndetin, të punojnë së bashku për paqe dhe të duan njëri-tjetrin për të mirën e të gjithëve, derisa vdekja ti ndajë ato. Të gjitha këto tri fe kanë mësuar deri tani se trashëgimtarët e tokës nuk do të jenë as zemërbutë, as agresivë, por bashkëpunues.

Në të vërtetë, e vërteta nuk ka nevojë të jetë me zë të lartë sepse është e vërteta. Gënjeshtra ka nevojë të mbizotërojë për të heshtur të vërtetën. Islami është e vërteta, paqja dhe toleranca. Prandaj, nuk ka nevojë të mbizotërojë që të irritojë të tjerët ose t'i terrorizojë ato në çfarëdo mënyre.

Përfundimisht, do të doja të them se shoqëritë myslimane sot kanë dy sfida më të mëdha për të gjithë: njëri është uniteti në diversitet dhe tjetri islamofobia që synon t'i largojë ata nga Islami si besim dhe kulturë. Në të vërtetë, e shoh këtë sfidë të fundit, islamofobinë, si një vetë-tjetërsim mysliman si sfida më e ngutshme e të gjithëve. Nuk është për shkak se ka diçka të gabuar në Islam ose në myslimanë, por sepse jetojmë në botën e sotme, e cila është si "bota e mbrapshtë" siç ishte në kohën e Hegelit, i cili deklaroi në një prej fragmenteve të tij më të çuditshme Fenomenologjia, se kjo botë është bota e mbrapshtë, ku e ëmbla bëhet e thartë, e bardha bëhet e zezë dhe veriu bëhet jug. Kundërshtimet mbulojnë ligjet morale, si dhe ato natyrore: nderi bëhet përbuzje dhe dënimi bëhet falje.

Etika e punës në këndvështrimin Islam

Dr. Naser Ramadani

Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup

Abstrakt

Islami i nxit njerëzit në përgjithësi dhe besimtarët në veçanti për punë dhe kërkim të furnizimit. Në Kur'an thuhet: "Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Tij..." Po ashtu thotë: "Ai ju ka bërë tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë që ju ka dhënë". Ndërsa Muhamedi a.s. ka thënë: "Askush nuk mund të hajë ushqim më të mirë sesa atë që e ha nga dora e tij".

Puna është e ndërlidhur me një vlerë tjetër etike – me shfrytëzimin e kohës. Besimtari njëmend përpiqet që në maksimum ta shfrytëzojë kohën e tij, ngase koha përfshin jetën e tij. Nëse lejon që të humbë kohë pa ndonjë punë të dobishme, ai me këtë ka bërë "vetëvrasje". Besimtari dubet të bëj llogari për kohën që kalon. Ai e di mirë se koha është kapitali i tij më i shtrenjtë dhe se do të pyetet për jetën e tij, në veçanti për rininë. Omer bin Abdulazizi thoshte: "Dita dhe nata po punojnë në ty, edhe ti puno në to". Besimtari dubet të ketë frikë që ditët mos t'i kalojnë pa vepruar ose pa prodhuar asgjë. Ai nuk dubet, në asnjë mënyrë, që punën e sotme ta lërë për nesër, sepse dita e nesërme është e ngarkuar me punë të tjera.

Islami e nxit besimtarin që të jetë punëtor i zellsbëm, ta kryejë rolin e tij në shoqëri dhe të zbatojë urdhrin e Allahut në përparimin e jetës në tokë, ku thotë: "Ai ju krijoi nga toka, ju vuri të jetoni në të dhe ta rindërtoni atë".

Hyrje

Nëse bëjmë një krahasim mes botës islame dhe asaj perëndimore për nga aspekti i zhvillimit ekonomik dhe i punës, në të shumtën e rasteve

do të vërehet një dallim i madh në favor të asaj perëndimore. Andaj, një ndër sfidat bashkëkohore të botës islame është edhe papunësia dhe jo serioziteti gjatë kryerjes së punës. Në botën islame, papunësia është

më e madhe, kualiteti i punës është më i vogël dhe, në përgjithësi, shtetet islame janë më shumë importuese sesa eksportuese. Me siguri që për këtë gjendje të ulët ekonomike kanë ndikuar faktorë të shumtë. Por, pyetja e cila duhet parashtruar është se: a ka ndikuar Islami si sistem në këtë gjendje, apo ndoshta kjo gjendje është pikërisht për shkak të largimit nga parimet dhe dispozitat islame? Ky studim modest do të merret me shqyrtimin e kësaj problematike për të ofruar qëndrimin e Islamit dhe etikën e punës nga këndvështrimi i tij.

Qëllimi i studimit:

Qëllimi i këtij studimi është përshkrimi i etikës së punës në këndvështrimin islam. Përderisa kryerja e punës kërkon punëdhënës, punëtor dhe punë e cila realizohet përmes një kontrate të punës, atëherë ky studim ka për qëllim që të tregojë etikën e secilit prej këtyre faktorëve gjatë procesit të punës. Fokusi kryesor i këtij studimi është sjellja e etikës së secilit prej punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Rëndësia e studimit:

Ky studim është i një rëndësie të veçantë nga fakti se nga puna varet përparimi ekonomik dhe shoqëror. Po ashtu puna e ngrit cilësinë e prodhimeve dhe rregullimin e jetës.

Që të jetë puna e tillë, patjetër duhet të ekzistojnë disa rregulla etike, që i rregullojnë obligimet dhe të drejtat e secilit prej punëdhënësit dhe punëtorit. Andaj në këtë studim do të theksohen rregullat etike që i sistemojnë këto obligime dhe të drejta.

Metodat e studimit:

Në këtë studim është përdorur metoda përshkuese dhe analitike, që ka për qëllim përshkrimin dhe analizimin e etikës së punës nga këndvështrimi islam.

Pyetjet e studimit:

Studimi në fjalë është i ndërlidhur me pyetjet në vijim:

- Çfarë rëndësie ka puna në Islam?
- Çfarë llojesh të punës lejon dhe ndalon Islami?
- Cilat janë rregullat etike të punëtorit në këndvështrimin islam?
- Cilat janë rregullat etike të punëdhënësit në këndvështrimin islam?
- Çfarë mund të arrihet, nëse myslimanët iu përmbahen rregullave etike islame?

Etika luan një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut, sepse ka ndikim të madh në sjelljen dhe veprat e tij. Ekziston një lidhshmëri e madhe, nga njëra anë, mes sjelljes dhe veprave të mira të njeriut dhe, nga ana tjetër, përgatitjes së tij etike.

Etika llogaritet si bazament themelor në jetën individuale dhe kolektive të njeriut dhe domosdoshmëri njerëzore për ngritjen e shoqërive. Pa etikë, njeriu do të shndërrohet në egërsirë ndaj vëllait të tij njeri, gjë që pengon ngritjen e shoqërive të shëndosha.

Islami në përgjithësi përbëhet prej tri çështjeve: besimit, etikës dhe dispozitave praktike. Ai etikës i ka kushtuar një kujdes të veçantë, sepse atë e llogarit si substanca e Islamit. Islami ka ofruar një sistem etik të kompletuar, që e rregullon jetën e njeriut në të gjitha sferat dhe fushat e veprimit të tij.

Bazuar në atë se puna ka një rol të rëndësishëm në përparimin e njeriut, qoftë në aspektin individual apo shoqëror, vërejmë se shtetet, në përgjithësi, përkujdesen për rregullimin e saj. Shtetet përparimtare kanë arritur një nivel të lartë të rregullimit të çështjeve të punës, duke përfshirë këtu obligimet dhe të drejtat e secilit prej punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe rregullat e punës dhe çështjet që ndërliken me të.

Në këtë studim do të paraqesim kujdesin e Islamit ndaj etikës së punës, me qëllim që të shohim se çfarë sistemi ofron ai? Sa i ruan të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit? Si duhet t'i kryejë obligimet secili prej tyre? Si duhet të kryhet puna në formën më të mirë?, etj.

Kur flasim për etikën e punës në Islam, kemi për qëllim një sërë parimesh dhe vlerash për të cilat Islami ka nxitur gjatë kryerjes së punës.

Rëndësia e punës në Islam

Puna në Islam ka një pozitë të rëndësishme. Ajo vlerësohet shumë dhe është shkak për përparimin në këtë botë dhe për fitimin e shpërblimeve të Allahut në botën tjetër. Mbi shtatëdhjetë ajete Kur'anore dhe shumë hadithe pejgamberike flasin për rëndësinë e punës dhe vlerën e saj në Islam, duke i treguar qartë besimtarit qëllimin e tij në jetë dhe duke e nxitur atë për punë në mënyrë të prerë.¹ Nga këto ajete do të veçojmë vetëm disa prej tyre. Allahu i Lartmadhëruar thotë: **“Thuaj: punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj”**.² Po ashtu thotë: **“...disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij (për jetesë) dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në rrugën e Tij...”**³ Siç vërehet nga ajetet Kur'anore, punës i jepet përparësi para luftës në rrugë të Allahut. Pothuajse në të gjitha ajetet Kur'anore, puna që kërkohet të veprohet cilësohet me “salihat” të

1. Muhamed El-Gazali, Akidetul Muslim, f. 135.

2. Kur'an, Et-Teube, 105.

3. El-Muzzemmil, 20.

mira, fjalë e cila përfshin çdo gjë që e rregullon jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër, jetën individuale dhe kolektive, si dhe jetën shpirtërore dhe materiale.⁴

Në anën tjetër, Muhamedi a.s., lodhjen dhe mundin gjatë kryerjes së punës e ka llogaritur si shlyerës të mëkateve dhe ka thënë: *“Kush kalon ditën duke fituar nga dora e tij, ai do të jetë i falur nga mëkate”*.⁵

Nëse i hedhim një vështrim jetës së të gjithë peygamberëve dhe ndihmësve (shoqëruesve) të tyre më të afërt, do të vërejmë se që të gjithë kanë punuar dhe janë ushqyer si rezultat i mundit dhe punës që kanë bërë. Disa prej tyre janë marrë me bujqësi, disa të tjerë me blegtori e të tjerë me ndërtimtari e zejtari.⁶

Islami i nxit njerëzit në përgjithësi dhe besimtarët në veçanti për punë dhe kërkim të furnizimit. Në Kur’an thuhet: **“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Tij...”**⁷ Po ashtu thotë: **“Ai ju ka bërë tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë që ju ka dhënë”**.⁸ Ndërsa Muhamedi a.s. ka thënë: *“Askush nuk mund të hajë ushqim më të mirë sesa atë që e ha nga dora e tij”*.⁹

4. Jusuf El-Kardai, El Imanu uel Hajatu, f. 254.

5. Transmeton Taberaniu në “El Eusatu” me nr. 7520.

6. Abdurrahman Hasan Habanneke, El-Ehlakul-Islamjetu ue Ususuha, vëll. 2, f. 519.

7. Kur’an, El-Xhumuah, 10.

8. Kur’an, El-Mulk, 15.

9. Transmeton Buhariu në “Sahih” me nr.

Lidhshmëria mes punës dhe etikës në këndvështrimin islam është shumë e madhe, sepse vlerat morale dhe etika islame janë ato që orientojnë punën në drejtimin e duhur. Thënë ndryshe, puna e besimtarit është rezultat i besimit të tij, sepse ai është i bindur se suksesi e lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër janë të ndërlidhur ngushtë me punën. Allahu ka caktuar rregulla në këtë botë. Ndër ta është edhe rregulli që citon se, njeriu punëtor arrin suksese më të mëdha në këtë botë, pa marrë parasysh fenë dhe besimin e tij.

Puna është e ndërlidhur me një vlerë tjetër etike – me shfrytëzimin e kohës. Besimtari njëmend përpiqet që në maksimum ta shfrytëzojë kohën e tij, ngase koha përfshin jetën e tij. Nëse lejon që të humbë kohë pa ndonjë punë të dobishme, ai me këtë ka bërë “vetëvrasje”.¹⁰ Besimtari duhet të bëjë llogari për kohën që kalon. Ai e di mirë se koha është kapitali i tij më i shtrenjtë dhe se do të pyetet për jetën e tij, në veçanti për rininë. Omer bin Abdulazizi thoshte: “Dita dhe nata po punojnë në ty, edhe ti puno në to”. Besimtari duhet të ketë frikë që ditët mos t’i kalojnë pa vepruar ose pa prodhuar asgjë. Ai nuk duhet, në asnjë mënyrë, që punën e sotme ta lërë për nesër, sepse dita e nesërme është e ngarkuar me punë të tjera.¹¹

2072.

10. Muhamed El-Gazali, Hulukul Muslimi, f. 224.

11. Jusuf El-Kardai, El-Imanu uel-Hajatu,

Islami e nxit besimtarin që të jetë punëtor i zellshëm, ta kryejë rolin e tij në shoqëri dhe të zbatojë urdhrin e Allahut në përparimin e jetës në tokë, ku thotë: “**Ai ju krijoi nga toka, ju vuri të jetoni në të dhe ta rindërtoni atë**”.¹²

Të gjitha parimet dhe vlerat morale që ndërlidhen me etikën e punës, mund të ndahen në tri grupe: natyra e punës, punëtori dhe punëdhënësi.¹³

1. Etika islame në vetë natyrën e punës

Nëse shfletojmë burimet islame dhe literaturën e gjerë, që është shkruar në lidhje me natyrën e punës, do të vërejmë se Islami ka ofruar një sërë vlerash etike, që duhen zbatuar gjatë punës. Ndër çështjet më të rëndësishme janë: legjitimiteti i punës sipas këndvështrimit islam, kontrata e punës, angazhimi me punë i personit adekuat për të dhe kryerja e obligimeve para kërkimit të të drejtave.

Sa i përket çështjes se puna që kryhet duhet të jetë **legjitime**, me këtë nënkuptojmë çdo punë, fizike apo intelektuale, që i mundëson njeriut të jetojë me dinjitet, punë e cila garanton përparim dhe krenari. Andaj Islami e ka lejuar njeriun që të

punojë çdo punë e cila është hallall-legjitime, ndërsa e ka ndaluar që të punojë punë harame - jolegjitime, të cilat sjellin dëme individuale dhe shoqërore.

Sa i përket **kontratës** së punës vërejmë se Islami e ka lejuar lidhjen e kontratës në bazë të së cilës theksohen të gjitha obligimet dhe të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Në kontratë përfshihet lloji dhe sasia e punës, koha e caktuar për punë dhe paga.

Një ndër çështjet, etike që ndërlidhet me punën, është edhe ajo që me punë të caktuar të angazhohet **personi adekuat**, i cili posedon përgatitjet e duhura për kryerjen e kësaj pune. Argument për këtë kemi rastin kur sahabiu i nderuar, Ebu Dherri r.a., kërkoi nga Muhamedi a.s. që ta angazhojë si udhëheqës në një vend. Muhamedi a.s. i ra në kraharor dhe i tha: “*O Ebu Dherri! Ti je i dobët, ndërsa udhëheqja është amanet.*

Ajo në ditën e gjyqimit është poshtërim dhe pendim, me përjashtim nëse e merr me meritë dhe i kryen obligimet me përgjegjësi”.¹⁴ Përzgjedhja e njerëzve adekuat në punët e caktuara është çështje mjaft e rëndësishme që siguron përparim dhe sukses, sepse secili person e kryen punën e tij me përgjegjësinë më të lartë. Në këtë rast nuk mund të bëhet angazhimi në bazë të afërsisë familjare, ose interesave personale të përgjegjësve. Angazhimi i personave joadekuat në punë të rëndësishme

14. Transmeton Muslimi në “Sahih”.

f. 258.

12. Kur'an, Hud, 61.

13. Mufrih bin Sulejman El-Kusij, Ahlakul ameli fil-islami, f. 4.

dhe mbetja e të tjerëve anash, duke poseduar aftësi për të, shkakton çrregullime shoqërore dhe pengesa serioze në përparimin ekonomik e shoqëror.

Në anën tjetër, çështje tjetër me rëndësi shumë të madhe etike është edhe **kryerja e obligimeve para kërkimit të të drejtave**. Zbatimi i këtij parimi etik eviton çdo mosmarrëveshje mes palëve kontraktuese dhe e shton bashkëpunimin, gjë e cila do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në prodhim.

2. Etika islame dhe punëtori

Islami ka caktuar një sërë rregullash etike, të cilave duhet t'u përmbahet punëtori gjatë kryerjes së punës, pa marrë parasysh se çfarë pune punon.

Prej këtyre rregullave, shumë e rëndësishme është përgatitja psikike dhe fizike e punëtorit. Varësisht prej punës që kryen, punëtori duhet të ketë përgatitjen e duhur. Një përgatitje e tillë ia mundëson punëtorit që ta kryejë punën e tij në formën më të mirë dhe të arrijë sukseset e duhura.

Rregull tjetër etik me rëndësi është edhe kryerja e punës me përgjegjësi dhe besnikëri. Kjo është cilësia më e rëndësishme etike e punëtorit. Në Kur'an, çështja e përgjegjësise, që ndërlidhet me punëtorin, është potencuar disa herë.

Në suren El-Kasas thuhet: **“O babai im, -tha njëra nga ato dyja- merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim”**.¹⁵ Po ashtu në suren En-Nisa' thuhet: **“Allahu ju urdhëron që amanetet t'jua ktheni atyre që u përkasin”**.¹⁶ Duke llogaritur se shprehja “amanet” është një shprehje që në brendinë e saj përshin kuptime shumë të gjera, ku të gjitha ndërlidhen me ndjenjën e personit me përgjegjësinë e punës që i ofrohet, atëherë edhe kryerja e punës me përgjegjësi është një ndër amanetet më të mëdha, gjë të cilën e përfshin edhe ky ajet Kur'anor.

Besnikëria në punë përfshin forma të shumta:

- Përkujdesja e punëtorit për shfrytëzimin e kohës dhe kryerjes së obligimeve, pa marrë parasysh vendin e punës së tij dhe mos humbja e kohës me gjëra që nuk ndërlidhen fare me punën e tij, qoftë brenda vendit të punës apo jashtë.

- Gjatë punës duhet të largohet nga të gjitha format e mashtrimit. Në lidhje me këtë, Muhamedi a.s. thotë: *“Ai që mashtron, nuk është prej nesh”*.¹⁷

- Mos ta keqpërdorë pozicionin që ka në punën e tij për përfitime personale ose familjare, duke marrë gjëra nga vendi i punës, ose të pranojë rryshfete apo dhurata që

15. Kur'an, El Kasas: 26.

16. Kur'an, En Nisa': 58

17. Transmeton Muslimi në “Sahih”.

luajnë rolin e ryshfetit etj. Në lidhje me këtë çështje, Muhamedi a.s. thotë: *“Personin që e caktojme në një vend pune dhe ia caktojme pagën, çdo gjë që merr jashtë saj është keqpërdorim”*.¹⁸ Transmeton Buhariu nga Ebu Humejd Es-Saidiju se ka thënë: “Muhamedi a.s. angazhoi një person nga fisi Beni Esed me emrin Ibnul-Etebije për grumbullimin e zekatit. Kur u kthye tha: “Kjo është për ju e kjo për mua.” Muhamedi a.s. u ngrit në minber, e falënderoi dhe e madhëroi Allahun dhe më pas tha: *“Ç’është puna me punëtorin?! Ne e dërgojmë në punë e ai vjen dhe thotë: kjo është për ju e kjo për mua?! Sikur të ulej në shtëpinë e babait apo nënës së tij dhe të shihje se a po i dhurohet atij apo jo?! Pasha Atë, në duart e të Cilit është shpirti im, çdo gjë që merr, në ditën e kiametit do ta bartë në qafën e tij, qoftë deve, lopë apo dele’*. Më pas i ngriti duart derisa i pamë nënsqetullat e tij dhe tha: *“Unë kumtova”* tri herë.¹⁹ Transmetohet nga Abdullah ibn Amri se ka thënë: “Muhamedi a.s. e mallkoi ryshfethënësin dhe ryshfetmarrësin”.²⁰

- Përkujdesja për mjetet dhe pajisjet e punës, duke mos i përdorur për interesa personale ose për dikë tjetër, sepse këto pajisje janë amanet në duart e tij për të cilat do të japë llogari.

- Ruajtja e sekreteve të punës është prej vetive etike shumë të rëndësishme dhe është prej shkaqeve më të fuqishme që sjell sukses në punë. Me siguri që një çështje e tillë kërkon një durim shumë të madh dhe bindje, duke pasur parasysh se është në kontrollin e vazhdueshëm të Allahut.

Rregull tjetër etik, shumë i rëndësishëm gjatë punës, është edhe kryerja e punës me **përsosmërinë** më të lartë. Islami nxit në kryerjen e punës me përgjegjësinë më të madhe, duke e llogaritur atë amanet që duhet të kryhet me përgjegjësi. Nuk kërkohet vetëm kryerja e punës, sidoqoftë ajo, por duhet bërë përpjekja maksimale për ta realizuar në formën më të mirë. Nëse njeriu ka përgatitje adekuate për punën që kryen dhe synon kënaqësinë e Allahut, ajo punë, me siguri, do të jetë e suksesshme. Kryerja e punës me përsosmëri sjell kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut. Muhamedi a.s. ka thënë: *“Allahu dëshiron që kur dikush prej jush të kryejë ndonjë punë, ta kryejë me përsosmëri”*.²¹ Kryerja e punës me përsosmëri nënkupton që punëtori të ndjehet përgjegjës ndaj punës, ta kryejë në formën më të mirë, të përshejtojë sa të mundet në realizimin e saj, të përpiqet në maksimum për të shmangur gabimet, pa marrë parasysh se puna kryhet në sektorin publik, privat apo për punën e tij personale. Zgjedhja

18. Transmeton Ebu Davudi në “Sunen” me nr. 2943.

19. Sahihul-Buhari me Fethul Bari, nr. 7174.

20. Transmeton Hakimi në “Mustedrek” me nr. 7066.

21. Transmeton Bejhëkiu me nr. 5312.

e punës adekuatë, që përshtatet me aftësitë e tij profesionale dhe psikofizike, mundëson kryerjen e punës me përpikëri të plotë. Një punë e tillë me sinqeritet e shton prodhimin, e rrit ekonominë dhe sjell dobi, si për punëtorin e punëdhënësin, po ashtu edhe për mbarë shoqërinë.

Sinqeriteti dhe besnikëria në punë janë shumë të rëndësishme, sepse pa sinqeritet dhe besnikëri nuk mund të kryhet puna në formën më të mirë. Sinqeriteti dhe besnikëria janë shtytësit kryesorë që e nxisin punëtorin për kryerjen e punës me përsosmërinë më të lartë.²² Sinqeriteti e bën punëtorin që ta japë mundin e tij në maksimum për realizimin e punës si dhe tejkalimin e lodhjeve. Sinqeriteti e bën punëtorin që të ketë një vetëkontroll në punën e tij, sepse ka bindje se Allahu e sheh dhe është nën mbikëqyrjen e Tij, kudo që gjendet. Allahu në Kur'an thotë: **“Allahu është mbikëqyrës për çdo gjë”**.²³ Besimtari i denjë gjatë punës së tij duhet të ketë parasysh arritjen e kënaqësisë së Allahut, më pas edhe interesin e vendit e shoqërisë, ku me siguri aty ngërthehet edhe interesi personal. Nëse bëhet një vështrim i thukët i dështimit të projekteve të ndryshme, mbylljes së fabrikave dhe uzinave, humbjes së mjeteve të punës dhe rënies së prodhimit, do të vërehet qartë se ajo është si rezultat i humbjes së sinqeritetit dhe i besnikërisë në punë.

22. Jusuf El-Karadavi, El-Imanu vel-Hajatu, f. 256.

23. Kur'an, El-Ahzab, 52.

Rregull tjetër etik gjatë punës është edhe zbatimi i rregullave të punës të caktuara nga punëdhënësi. Në këtë çështje përfshihet zbatimi i orarit të punës, respektimi i urdhrave të eprorëve të tij, respektivisht i personave para të cilëve jep përgjegjësi dhe bashkëpunimi me të gjithë faktorët që ndikojnë në kryerjen e punës në formën më të mirë.

3. Etika islame dhe punëdhënësi

Ashtu sikurse Islami ka caktuar një sërë rregullash etike për punëtorin, ai ka caktuar edhe një sërë rregullash për punëdhënësin, pa marrë parasysh nëse punëdhënësi është individ, institucion nga sektori privat, apo publik, ose diçka tjetër.

Prej këtyre rregullave etike mund të veçohen:

- Dhënia e pagës punëtorit.

Theksuam më parë se obligimet dhe të drejtat shkojnë paralel njëra me tjetrën dhe se nuk duhet kërkuar e drejta pa i kryer obligimet. Nëse punëtori e kryen punën e tij me nder dhe me përsosmëri të plotë, atëherë është e drejtë e tij që të marrë pagën, për të cilën palët kanë rënë dakord më parë. Punëdhënësi obligohet që punëtorit t'ia japë pagën pa hequr prej saj asgjë. Islami kërkon prej punëdhënësve që punëtorit t'i jepet paga menjëherë, sipas marrëveshjes paraprake, qoftë ditore, javore, mujore, sasi e caktuar apo forma të tjera. Në

lidhje me këtë çështje, Muhamedi a.s. ka thënë: *“Punëtorit jepjani pagën para se t’i thahen djerësë”*.²⁴ Mosdhënia e pagës punëtorit shkakton zemërimin e Allahut. Në hadith kudsij thuhet: *“Tri grupe njerëzish do t’i armiqësoj në ditën e gjykimit: ... dhe një njeri që merr një punëtor, kërkon prej tij ta kryejë punën plotësisht dhe nuk ia jep pagën”*.²⁵ Në momentin kur punëtori e kryen punën e tij, atëherë paga bëhet borxh i punëdhënësit sipas marrëveshjes në kontratë. Allahu në Kur’an thotë: **“O besimtarë! Plotësoni detyrimet!”**²⁶

- Drejtësi dhe bamirësi.

Drejtësia dhe bamirësia janë ndër parimet më të rëndësishme në Islam. Çdo punë që nuk ngrihet mbi bazën e drejtësisë është e lëkundur, sado i fortë të jetë organizimi. Allahu ka urdhëruar drejtësi në çdo segment të jetës, përfshirë edhe punën. Në Kur’an thuhet: **“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit”**.²⁷

Çështja e drejtësisë dhe e mirësisë nga ana e punëdhënësit, mund të realizohet në forma të ndryshme: barazi mes punëtorëve me sjellje të mirë pa bërë dallime mes tyre. Përderisa janë të barabartë në punë, duhet të jenë të barabartë edhe në respekt nga ana e punëdhënësit. Po

që se ka dallime në punë, atëherë duhet lavdëruar punëtori i mirë dhe duhet qortuar punëtori i keq, si dhe nuk duhet të jenë të barabartë në përfitime, por secili duhet të marrë atë që meriton. Barazi mes punëtorëve në angazhime, duke marrë parasysh dallimet individuale, aftësitë dhe shkathtësitë e tyre. Përshtatshmëria mes punës dhe pagës së punëtorit. Në lidhje me këtë, në Kur’an thuhet: **“...mos u hani hakun njerëzve...”**²⁸ Mosngarkimi i punëtorit më shumë se sa kanë rënë dakord gjatë kontratës. Dhënia e pushimeve që i takojnë me ligj etj.

Sjellja korrekte me drejtësi dhe mirësi e punëdhënësit, forcon te punëtorët besimin ndaj tyre, vullnetin për punë dhe përpjekjen maksimale për kryerjen e punës me përsosmëri të plotë.

- Modestia dhe respektimi i punëtorit, duke vlerësuar dinjitetin e tij.

Punëdhënësi duhet të jetë modest ndaj nëpunësve të tij. Kjo mund të realizohet me anë të bashkëpunimit me punëtorët, duke qëndruar me ta, duke biseduar, duke u kujdesur për kërkesat dhe nevojat e tyre. Mendjemadhësia nga ana e udhëheqësve është anomali morale para se të jetë anomali në punë. Mendjemadhësia në të shumtën e rasteve shkakton urrejtje mes tyre dhe punëtorëve, gjë që ndikon edhe në rrjedhën e punës.

28. Kur’an, El-Araf, 85.

24. Transmeton Ibn Maxheh në “Sunen” me nr. 2443.

25. Transmeton Buhariu në “Sahih” me nr. 2270.

26. Kur’an, El-Maide, 1.

27. Kur’an, En-Nahl, 90.

Punëdhënësi duhet ta respektojë punëtorin, sido që të jetë niveli i tij arsimor, ekonomik e shoqëror. Ai është faktor i rëndësishëm në shoqëri. Punëdhënësi duhet të sillet butë me punëtorin, duke e respektuar dinjitetin e tij njerëzor. Asnjëherë nuk duhet ta nënçmojë apo ofendojë atë. Punëdhënësi dhe punëtori, duke respektuar njëri-tjetrin, ndikojnë fuqishëm në përmirësimin dhe përparimin e shoqërisë në të gjitha sferat. Në lidhje me sjelljen morale, Muhamedi a.s. thotë: *“Besimtari me besim më të plotë është ai që ka moral më të mirë”*.²⁹

Sjellja morale e punëdhënësit dhe respektimi i punëtorit e shton vullnetin për punë, i cili do të rezultojë në kryerjen e punës sa më mirë që është e mundur dhe do të bëjë punëtorët më të dëgjueshëm ndaj tyre.

- Garantimi i sigurimit shëndetësor dhe ruajtja nga rreziqet e punës.

Punëdhënësit duhet t’jua garantojnë punëtorëve sigurimin shëndetësor dhe kontrollin e rregullt mjekësor. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e duhura për mbrojtje nga gjitha rreziqet që mund t’i shkaktojnë dëme punëtorit, si p.sh. sigurimi i hapësirave të mjaftueshme, ndriçimit, ruajtja nga i ftohti dhe dielli i fortë, sigurimi i mjeteve të nevojshme, veshmbathjeve si doreza,

29. Transmeton Ebu Davudi në “Sunen” me nr. 4682.

helmeta etj., si dhe largimin i çdo gjëje që rrezikon shëndetin e tyre.

Këto ishin disa nga rregullat etike të përgjithshme sipas këndvështrimit islam. Nga ajo që u tha më lartë mund të kuptohet se Islami, me dispozitat, etikën dhe moralin e tij, ka caktuar rregulla që i ruajnë të drejtat e gjithë punëdhënësve dhe punëmarrësve. Jo vetëm të drejta juridike, por ka nxitur te të gjithë ndjenjën e përgjegjësisë, drejtësisë dhe bamirësisë.

Nëse shikojmë në realitetin tonë, vërejmë se sa larg këtyre vlerave etike jemi. Në përditshmërinë tonë as punëdhënësit e as punëmarrësit nuk u përmbahet këtyre rregullave të larta etike. Andaj gjendja në të cilën gjendemi, nuk është asgjë tjetër veçse pasojë e mosrespektimit të këtyre parimeve e rregullave.

Me siguri që për të arritur deri në këtë gjendje në të cilën jemi kanë ndikuar faktorë të shumtë, mes të cilëve mund të theksojmë: moskujdesi i përgjegjësve politikë për marrjen e masave të duhura për zhvillimin e tregut të punës; përhapja e korrupsionit në mesin e përgjegjësve; angazhimi i njerëzve joadekuat në vende të rëndësishme të punës, etj.

Nëse ne, si komunitete myslimane nuk kemi mundësi të ndryshojmë gjendjen e shoqërisë – edhe pse duhet bërë përpjekje – së paku duhet të marrim masa urgjente për zbatimin e këtyre parimeve etike brenda komuniteteve myslimane.

Çdo përgjegjës dhe çdo punëtor duhet të jetë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë. Duhet kuptuar se çështja ndërlidhet me hallall dhe haram dhe mbi të gjitha me pajtimin apo hidhërimin e Allahut. Duhet bërë çmos që të zbatohet parimin “njeriu i duhur në vendin e duhur”, parim i cili përputhet plotësisht me të gjitha mësimet islame.

Pas gjithë kësaj, duhet kuptuar se gjendja jonë nuk do të ndryshojë për të mirë, përderisa ne nuk ndryshojmë në sjelljen tonë dhe përderisa secili prej nesh nuk e kryen punën e tij me përgjegjësinë më të lartë. Allahu në Kur'an thotë: **“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete”**.³⁰

Përfundim dhe rekomandime

Në bazë të asaj që u tha më lart, mund të përfundojmë me sa vijon:

30. Kur'an, Er-Ra'd, 11.

- Islami e ka çmuar lart punën dhe e ka bërë atë shkak për përparim dhe sukses në këtë botë si dhe kënaqësi dhe shpëtim në botën tjetër;

- Islami ka ofruar një sërë rregullash etike, që ndërlidhen me punën, si p.sh.: puna të jetë legjitime, përcaktim i qartë i llojit të punës, i afatit dhe pagës gjatë kontratës mes punëdhënësit e punëtorit, dhënia e pagës së plotë punëtorit dhe sjellja e mirë ndaj tij;

- largimi nga të gjitha sjelljet negative gjatë kryerjes së punës, si vjedhja, mashtrimi, korrupsioni, hipokrizia, keqpërdorimi i vendit të punës etj.

- angazhimi i përgjegjësve në komunitetet myslimane për zbatimin e rregullave etike islame të punës brenda institucioneve, në të cilat veprojnë;

- nevoja e përfshirjes së etikës islame në institucionet edukative-arsimore, mes të cilave edhe etika e punës sipas këndvështrimit islam.

Burimet dhe literatura

- **KUR'ANI** i madhërishëm. Përkthimet e tij në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Botimi i tretë, 2015.
- El-Askalani, Ibn Haxher, **Fet'hul Bari bisherhi Sahihil Buhari**, Rijad: Riasetu Idaratil Buhuthil Ilmijeti.
- El Bejhekij, Ahmed bin El Husejn, **Shuabul Iman**, Bejrut: Darul Kutubil Ilmijeti.
- Et Taberani, Sulejman bin Ahmed, **El Mu'xhemul Eusatu**, Kajro: Darul Hadith, 1996.
- El Kazvini, Muhamed bin Jezid, **Sunenu Ibn Maxheh**, Rijad: Mektebetul Mearif.
- El Kushajri, Muslim bin Haxhaxh, **Sahihu Muslim bisherhi Jahja ibn Sheref En Neueui**, Kajro: Darul Bejan.
- Es Sexhestani, Sulejmani bin Esh'ath, **Sunenu ibn Davud**, Bejrut: Daru Ihjait turathil Arabiji.
- Hakim Nisaburi, Muhamed bin Abdullah, **El Mustedrek ala Sahihajn**, Bejrut: Darul Kutubil Ilmijeti, 1990.
- El Kardau, Jusuf, **El Imanu uel Hajatu**, Bejrut: Muessesetur Risaleti, 1993.
- El Gazali, Muhamed, **Akidetul muslimi**, Damask: Darul Kalem, 1987.
- El Gazali, Muhamed, **Hulukul Muslimi**, Damask: Darul Kalem, 1985.
- Habenneke, Abdurrahman Hasan, **El Ahlakul Islamijetu ue Ususuha**, Damask: Darul Kalem, 1996.
- <http://www.alukah.net/social/0/32647/#ixzz59RAhdnWz>

Shtatë llojet e këndimit të Kur'anit

Adnan Merja, SHBA

Abstrakt

Njeriu merr vlerë falë asaj që njeh, fiton virtyte aq sa arsyetohet dhe fisnikërohet me atë që shogëron. Meqenëse Kur'ani është libri më i madh i zbritur, atëherë njeriu që i është zbritur ai libër është Profeti më i nderuar ndër të dërguarit, bashkësia e tij është më e mira ndër tërë bashkësitë, bartësit e këtij libri janë më fisnikët e saj, si dhe lexuesit dhe mësuesit e tij janë njerëzit më me vlerë të këtij populli.

Shkenca e Kiraetit është më e veçanta ndër disipinat fetare. Në të nuk ka ndërhyrë munda, apo dora e njeriut, sepse është shpallur nga Zoti i Gjithësisë dhe është ruajtur nga po vetë Ai. Tematikë e këtij shkrimi do të jenë çështjet si: shtatë shkronjat e Kur'anit, shkaku i zbritjes, objektivi, kuptimi dhe disa specifika rreth tyre.

a) Shkaku i Zbritjes

Shkaku i zbritjes së Kur'anit në shtatë shkronja është që të jetë lehtësim për bashkësinë e tij si shenjë fleksibiliteti, mëshire dhe veçorie për vlerat, që ato bartin. Krahas këtij shkaku mund të aludohet edhe si dhënie përgjigje ndaj lutjes së Profetit a.s në kohën kur i erdhi engjëlli i shpalljes¹ dhe i tha:

1. Ibnu'l Xhezeri, *En'Neshr Fil' Kirâati'l Ashr* 22/1; Zurkânî, *Menâbilul' Irfân Fî 'Ulâmi'l Kur'an* 137/1, 142, 145, 152.

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكَ أَنْ تَقْرَأَ أُمَّتَكَ الْقُرْآنَ عَلَى حَرْفٍ، فَقَالَ: أَسْأَلُ اللَّهَ مُعَافَاتَهُ وَمَغْفِرَتَهُ، وَإِنَّ أُمَّتِي لَا تُطِيقُ ذَلِكَ، ثُمَّ أَتَاهُ الثَّانِيَّةُ، فَقَالَ: إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكَ أَنْ تَقْرَأَ أُمَّتَكَ الْقُرْآنَ عَلَى حَرْفَيْنِ، فَقَالَ: أَسْأَلُ اللَّهَ مُعَافَاتَهُ وَمَغْفِرَتَهُ، وَإِنَّ أُمَّتِي لَا تُطِيقُ ذَلِكَ، ثُمَّ جَاءَهُ الثَّالِثَةُ، فَقَالَ: إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكَ أَنْ تَقْرَأَ أُمَّتَكَ الْقُرْآنَ عَلَى ثَلَاثَةِ أَحْرُفٍ، فَقَالَ: أَسْأَلُ اللَّهَ مُعَافَاتَهُ وَمَغْفِرَتَهُ، وَإِنَّ أُمَّتِي لَا تُطِيقُ ذَلِكَ، ثُمَّ جَاءَهُ الرَّابِعَةُ، فَقَالَ: إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكَ أَنْ تَقْرَأَ أُمَّتَكَ الْقُرْآنَ عَلَى سَبْعَةِ أَحْرُفٍ، فَأَيُّمَا حَرْفٍ قَرَأُوا عَلَيْهِ فَقَدْ أَصَابُوا.

“Allahu të ka urdhëruar ty që t’ia lexosh Kur’anin bashkësisë tënde sipas një shkronje. Ai a.s. tha: Kërkoj faljen e Zotit për atë që nuk di dhe ndihmën e Tij për atë që kërkoj, bashkësia ime nuk mundet ta

përballojë dot këtë.” ... Vazhdoi edhe më tej ta përsërisë të njëjtën gjë derisa arriti në shtatë shkronja.”²

Kur’ani u zbrit në gjuhën arabe, e cila përmban dialekte dhe thekse të ndryshme. Për këtë arsye, disave u vështirësohej përdorimi i fjalëve, duke kaluar nga një dialekt në tjetrin, apo nga një shkronjë në tjetrën. Veçanërisht të moshuarit, gratë dhe ata që nuk dinin të lexonin nuk mundeshin të bënin kalime të tilla qoftë edhe nëpërmjet metodës së nxënies. Nëse do t’u kushtëzohej të braktisnin dialektin dhe theksin e tyre, kjo do të ishte një peshë që s’do ta përballonin dot.

a) Kuptimi i fjalës “ahruf”, “shkronjat”

Gjuhësisht fjala harf ka kuptimin anë, aspekt, brinjë, kufi, zonë dhe pjesë. Shkronja gjithashtu është pjesë e rrokjeve në kontekstin e të qenët pjesë e fjalës.³

“Ebu Amr ed’Dani thotë se kuptimi i shkronjave të aluduara nga Profeti a.s. mund të shpjegohet në dy pika: 1- Kur’ani u zbrit në shtatë dialekte të gjuhës arabe. Fjala “ahruf” është shumësi i fjalës “harf” dhe prej saj nënkuptohet fjala “formë ose mënyrë” bazuar te ajeti *يَعْبُدُ اللَّهَ عَلَى حَرْفٍ* i cili në thelb përmban mënyrën e

2. Buhâri, *Husûmât* 3, *Bed’ul balk* 6, *Fedâilul Kur’ân* 5, 27, *Istitâbetul Murteddîn* 9, *Teuhûd* 53; Muslim, *Salâtu’l Musâfirîn* 270-274.

3. Ibn Mandhûr, *Lisânu’l Arab* 9/41; Zebîdî, *Tâxhu’l Arûs Min Xbeuâhiri’l Kâmûs* 128/23; Komisioni i Gjuhës Arabe në Kajro, *El’Mu’xhemu’l Uasît* 167/1.

adhurimit ndaj mirësisë së shëndetit dhe përgjigjes së lutjes. Andaj, edhe Resulullahi i quajti dialektet e ndryshme të kiraetit “shkronja” në kuptimin se për çdo dialekt ndodhet një formë ose mënyrë leximi. 2- Resulullahi i ka emërtuar “shkronja”, si një shenjë fleksibiliteti, sepse edhe arabët e kishin për zakon t’i emërtonin sendet me një emër të ngjashëm apo të përafërt me emrin e vetë sendit. Arsyeja e emërtimit dhe e lidhjes në këtë formë është një shembull se si ata e emërtonin fjalinë me emrin e disa pjesëve të saj. Prandaj, Resulullahi e quajti kiraetin “shkronjë”, edhe nëse kjo është fjali e gjatë për faktin se në të ndodhen shkronja të cilave mund t’u ndryshojë radha, zanorja, forma, ose mund të lexohet me imale⁴, mund

4. Fjala الإمالة, el-imale është një fjale arabe e formuar prej rrënjës ميل - mejl dhe kjo e fundit prej foljes يميل - مال. Kur folja يميل - مال vendoset në formën zgjedhuese إفعال - if’al merr kuptimin “t’i japësh prirje, ta drejtosh poshtë, ta përkulësh poshtë, ta përkulësh me drejtim poshtë dhe t’i ndryshosh drejtimin diçkaje”. Në terminologjinë e shkencës së kiraeteve fjala imale merr kuptimin “të shqiptuarit e shkronjës ا – elif”, duke e drejtuar nga shkronja ي - je ose të shqiptuarit e zanores fet’ha (e), duke e drejtuar atë kah zanorja kesre (i). Gjatë artikulimit të zanores “e, fet’ha” pjesa e mjekrës drejtohet për lart, ndërsa kur aplikojmë rregullin e imale-s e drejtojmë për poshtë. Kemi dy lloje imale: 1. Imale-ja e madhe (الإمالة الكبرى). Këtu bëhet fjalë për artikulum të imales në mes dy zanoreve, përkatësisht zanoreve fet’ha “e” dhe kesra “i”, por që anon më tepër drejt zanores kesra “i”. P.sh: كبرى , Kubrî. 2. Imale-ja e vogël (الإمالة الصغرى). Kjo lloj imale-je artikullohet në mes dy zanoreve,

t'i shtohet apo t'i pakësohet një shkronjë bazuar në llojshmërinë e kiraeteve. Kjo ishte arsyeja që Profeti ynë a.s. e quajti kiraetin "shkronjë" sipas zakonit të arabëve dhe si shenjë mirëbesimi ndaj përdorimit të kësaj fjale prej tyre."⁵

b) Çfarë synohet me këto shtatë shkronja?

Ndonëse dijetarët kanë mendime të ndryshme për sa i përket synimit të tyre, ata kanë rënë në konsensus për dy konkluzione:

1) Qëllimi prej këtyre shtatë shkronjave nuk është që njëra prej tyre të lexohet në shtatë dialekte, sepse kjo veçori është e kufizuar vetëm me disa fjalë të thjeshta si **أَفٌّ**, **هَيْتٌ**, **أَرْجَةٌ**, **جَبْرِيلُ**.

2) Nuk lejohet të synohen prej këtyre shkronjave shtatë imamët e shquar të kiraetit, në kundërshtim me atë që mendon një pjesë e njerëzve. Shtatë imamët e shquar kanë jetuar shumë kohë më vonë, pasi është zbritur Kur'ani.

Ndaj, shumica e dijetarëve janë të mendimit se ato janë dialekte. Natyrisht që edhe në këtë temë ka opinione të ndryshme. Ebû 'Ubejd thotë se këto dialekte janë dialekti: kurejsh, hudhejl, thekîf, heuâzin, kenâne, temîm dhe jemen. Një tjetër thotë se ato janë pesë dialekte

përkatësisht zanores fet'ha "e" dhe zanores kesra "i", por që anon më tepër drejt zanores fet'ha "e". P.sh: **صغرى**, **Sugrê**. Imale-ja e vogël emërtohet ndryshe "bejne ue bejne, bejne dhe taklîl" (**بين ديين و بين**).

5. Ibnu'l Xhezerî, *En'Nesbr Fil Kirââti'l Ashr* 1/26.

të krahinës heuâzin: sa'd, thekîf, kenâne, temîm dhe jemen, si dhe dy dialekte të përbashkëta në të gjitha dialektet arabe. Ebû 'Ubejd Ahmed b. Muhammed b. Muhammed el'Herauî thotë se këto shtatë dialekte janë nga dialektet e gjuhës arabe dhe janë të shpërndara në Kur'an, duke u shprehur se një pjesë e tij është në dialektin kurejsh, një pjesë në dialektin hudhejl, një pjesë në dialektin heuâzin dhe një pjesë në dialektin jemen. Ibnu'l Xhezerî thotë se të gjitha këto opinione janë të sakta. Edhe pse Hz. Omeri dhe Hishâm b. Hakîm r.a. ishin të dy kurejshitë, nga i njëjti fis dhe flisnin të njëjtin dialekt, ata ndryshonin në çështjen e leximit të sures "El'furkân".

Ka dijetarë, që thonë se prej shtatë shkronjave synohen kuptimet e gjykimeve, si hallall, haram, muhkem, muteshâbih, etj. Sipas Ibnu'l Xhezerî ky mendim është i pasaktë, sepse sahabet nuk patën kontradikta në komentin dhe gjykimet e Kur'anit, por në leximin e germave të tij.⁶

c) Përse numri shtatë?

Mendime të ndryshme gjithashtu janë paraqitur edhe në lidhje me temën se përse nuk janë më shumë apo më pak, por janë shtatë shkronja. Shumica e dijetarëve mbështesin mendimin se rrënjët e fiseve arabe përfundonin në numrin shtatë, ose dialektet e pastra janë shtatë, mirëpo të dyja këto nuk janë tjetër vetëm se pretendime. Një

6. Ibnu'l Xhezerî, *En'Nesbr Fil Kirââti'l Ashr* 1/25.

tjetër mendim thotë se nuk synohet numri i vërtetë prej shtatës me idenë e shtimit, apo pakësimit, por qëllimi është fleksibiliteti dhe lehtësimi; dialektet arabe nuk përbëjnë pengesë në leximin e kiraetit për arsyen se Allahu ua ka lejuar atyre. Arabët e përdorin fjalën “shtatë” edhe në vend të shtatëdhjetës, apo shtatëqindës dhe nuk kanë për qëllim numrin e saktë, por synojnë sasinë e shumtë dhe hiperbolën pa ndonjë limit. Imami Ibnu’l Xhezeri bën një përmbledhje rreth pikave ku dallojnë dhe ndryshojnë të shtatë aspektet në këtë formë:

1) Varieteti në zanore pa ndryshuar kuptimin dhe pamjen e fjalës, si p.sh.: الْبُحْلُ – që mund të lexohet në katër mënyra- dhe يَحْسَبُ – që mund të lexohet në dy mënyra.

2) Ndryshimi vetëm i kuptimit, si p.sh.: وَأَذْكَرَ بَعْدَ فَتَلَقَىٰ آدَمَ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ وَ أُمَّةٌ، وَ (أُمِّي)

3) Ndryshimi i shkronjës, që ndikon në kuptim, mirëpo nuk ndryshon pamjen e fjalës, si p.sh.: تَبَلُّوْا (تُنَجِّبِكُ بِيَدَيْكَ لِمَنْ خَلْفَكَ) dhe تَبَلُّوْا (تُنَجِّبِكُ بِيَدَيْكَ)

4) E kundërta e pikës së tretë, si p.sh.: الصِّرَاطُ dhe الصِّرَاطُ، بَصِطَةً dhe بَسِطَةً.

5) Ndryshimi i të dyjave, i kuptimit dhe i formës, si p.sh.: مِنْكُمْ أَشَدُّ dhe مِنْهُمْ أَشَدُّ apo يَأْتَلُّ dhe يَتَأَلُّ، si dhe فَاْمُضُوا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ

6) Takdîm (avancim para) dhe te’hîr (tërheqje prapa), si p.sh.: فَيَقْتُلُونَ وَجَاءَتْ سَكْرَتُ الْحَقِّ بِالْمُؤْمِنِ وَيَقْتُلُونَ

7) Shtimi dhe pakësimi i shkronjës, si p.sh.: وَصَىٰ dhe أَوْصَىٰ

Këto janë shtatë aspekte prej të cilave kanë lindur variacionet. Ndërsa opinionet e ndryshme rreth rregullave të texhvidit⁷, si idh’hâr (الإِظْهَارُ), idgâm (الإِدْغَامُ), roum (الرَّوْمُ) ishâmâm (الإِسْمَامُ), tefkhîm (التَّفْخِيمُ), terkîk (التَّرْكِيقُ), medd (الْمَدُّ), kasr (الْقَصْرُ), imâle (الإِمَالَةُ), febh (الْفَتْحُ), tahkîk (التَّحْقِيقُ), tes’hîl (التَّسْهِيلُ), ibdâl (الإِبْدَالُ), (nakl) (النَّكْلُ)⁸, të cilat cilësohen, si baza (usul) apo metoda, nuk përbëjnë shkak dallimi ose ndryshimi në fjalë dhe kuptimin e saj, sepse këto janë cilësi të ndryshme, që dalin në pah gjatë zbatimit⁹.

Shumëllojshmëria e këtyre shtatë shkronjave u referohet aspekteve dhe mënyrave të pandikuara nga ndryshimi apo dallueshmëria. Ndër vetitë, që mund të përmendet, është se kjo larmi shërben për të qartësuar gjykimin e unifikuar, si p.sh:

a. Kiraeti i Sa’d b. Ebî Uakkâsît (وَلَهُ أُخٌ أَوْ أُخْتٌ مِنْ أُمَّ). Ky kiraet tregon se këtu synohet vëllazëria nga ana e nënës dhe për këtë është rënë dakord nga dijetarët.

b. Një veti tjetër është çështja se cili gjykim do jetë më i preferuar për të shlyer betimin e thyer te kiraeti (أَوْ تَحْرِيرِ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ). Mendimi i Imam Shafi’ut dhe i disa të tjerëve është që ky lirim të kushtëzohet me qenien e skllavit besimtar, ndërsa sipas Ebu Hanifes nuk është kusht të jetë besimtar.

7. Shpjegimi i tyre, me lejen e Allahut, do të trajtohet në një artikull të veçantë.

8. Zerkeshî, *El’Burbân Fî ‘Ulûmi’l Kur’ân* 1/226-227.

9. Ibnu’l Xhezeri, *En’Nesbr Fî’l Kirââti’l Asbr* 1/27-28; Zerkeshî, *El’Burbân Fî ‘Ulûmi’l Kur’ân* 1/217-218.

c. Gjithashtu, një tjetër veçori është edhe kombinimi në mes dy gjykimeve të ndryshme, si p.sh. kiraeti me “shedde” **يَطْهَرُونَ** dhe pa “shedde” **يَطْهَرُونَ**. Gjykimi është se burri nuk duhet t’i afrohet gruas së tij me menstruacione derisa periudha të ndërpritet dhe derisa gruaja të pastrohet, duke u larë.

d. Antagonizmi i dy gjykimeve fetare i lindur prej dy kiraeteve të ndryshme. Fjala **أَرْجُلِكُمْ** e lexuar me zanoren i - kesra, pra “**erxhulikum**” nxjerr përfundimin e domosdoshmërisë së dhënies “mes’**h**” këmbëve. Ndërsa fjala **أَرْجُلِكُمْ** me zanoren e - fet’ha, “**erxhulekum**” nxjerr përfundimin e domosdoshmërisë së larjes së këmbës. Profeti a.s. e ka sqaruar këtë duke thënë se mes’**h** është për personin, që ka veshur mes’**h** dhe larja e këmbës për personin që nuk ka veshur mes’**h**.

e. Shpjegimi i gjykimit të përfutur nga pamja e jashtme, i cili jep si rezultat gjykimin e kundërt me atë që synohet, p.sh.: kiraeti **فَأْمُضُوا إِلَيَّ** ذَكِّرَ اللَّهُ

Pamja e jashtme e kiraetit **ذَكِّرَ اللَّهُ إِلَيَّ** të lë të kuptosh nxitimin. Mirëpo kjo gjë nuk është kështu dhe kiraeti tjetër **فَأْمُضُوا إِلَيَّ ذَكِّرَ اللَّهُ** e shpjegon më së miri gjykimin, prej të cilit derivohet kuptimi i të ecurit me qetësi. Madje sipas Hasan El-Basriut besimtari duhet të shkojë në xhami ditën e xhuma duke ecur me zemër, qëllim (nijet) dhe dëshirë për të përkujtuar Allahun xh.xh.¹⁰

Kuptimi i shtatë shkronjave

10. Fahu’d-dîn er’Râzî, *Mefâtihul Gajb* 30/542.

lidhet me realizimin, përsëritjen e të qenët shâhdh¹¹, ose të saktë të tyre dhe konsolidohet për nga ana e sasisë.

d) Vendndodhja e shtatë shkronjave

Këto shtatë shkronja janë në vende të ndryshme të Kur’anit. Për këtë nuk ka asnjë dyshim, madje ato ndodhen te çdo transmetim dhe kiraet në nocionin, që pohuam në lidhje me të qenët shtatë shkronja dhe se ato nuk janë të kufizuara me leximin nga fillimi deri në fund të një kiraeti, apo këndimin e një rivajeti. Ai që lexon Kur’anin me një kiraet të caktuar, konsiderohet, se e ka lexuar atë me një nga shkronjat e përmendura, por nuk mund të thuhet se ai e ka lexuar me të shtata shkronjat.

e) Një tjetër çështje e rëndësishme është edhe gjithëpërfshirja, që mus’hafet¹²

11. Fjala shâhdh (شَآءٌ) ka kuptimin i pazakontë, i çuditshëm, i parregullt, jokarakteristik, jo tipik, i braktisur, që nuk ka palë, ekscentrik etj. Është një term shumë i njohur në fushën e metodologjisë së hadithit. Përdoret në kontekstin e klasifikimit të gradës së vërtetësisë së transmetuesit. Specifikisht, grada shâhdh është grada më e ulët e transmetimit në aspektin e cilësive dhe vërtetësisë së transmetuesit për shkak të tipareve goditëse (الْمَطَاعِنُ الْعَدْرَةُ) të marra nga njerëzit kompetentë të fushës së hadithit. Rrjedhimisht edhe përkufizimi është i tillë: shâhdh quhet ai hadith të cilin një transmetues i besueshëm e përçon në kundërshtim me hadithin e përçar nga një transmetues më i besueshëm se ai.

12. Me fjalën mus’haf nënkutohet Kur’ani

osmanije¹³ u bëjnë shtatë shkronjave. Edhe në këtë temë dijetarët kanë shprehur mendime të ndryshme.

Një grup prej tyre janë të mendimit se mus'hafet osmanije i përfshijnë të shtatë shkronjat. Në

Kerim. Si term ka kuptimin: tubimi i fletushkave në mes dy kapakëve të librit.

13. Emërtohen mus'hafet osmanije (المصاحف العثمانية) sepse u shkruajtën dhe u shumëfishuan në vitin 30-të hixhri gjatë kohës së hilafetit të Hz. Osmanit r.a. Shkaku që Hz. Osmani r.a. mori një vendim të tillë ishte ekspedita e myslimanëve për ngadhënjimin e Armenisë dhe Azerbajxhanit në të cilën ranë dëshmorë shumë hafizë të Kur'anit. Për më tepër, Hz. Hudhejfe b. El-Jemân r.a. vuri re se njerëzit filluan të bënin polemika rreth mënyrës së leximit të Kur'anit, ku njëri thoshte leximi im është më i saktë dhe tjetri thoshte po të njëjtën gjë. Ky fenomen e frikësoi Hz. Hudhejfen, i cili erdhi te Hz. Osmani r.a. dhe i tha: "Nxito para se ymetin ta kaplojë mosmarrëveshja e mûseu'Ve (hebrenjve) dhe e îseu'Ve (të krishterëve)!" Halifeja Osman r.a. menjëherë lajmëroi, gruan e Profetit Hafsan r.a., që t'i dërgonte mus'hafin imam (bazë, themelor) të tubuar e mbledhur në kohën e halifit të parë Hz. Ebu Bekrit r.a., në mënyrë që ta shumëfishonin. Kështu që u ngrit një komision për verifikimin dhe kontrollimin, deri në imtësitë më të vogla të fjalëve, zanoreve dhe radhitjes së ajeteve, apo sureve, me në krye Zejd b. Thâbitin r.a., që pasohej nga Abdullâh b. Ez'Zubejr, Sa'd b. El'Âs dhe Abdurrahmân b. El'Hârith r.a. Në fund, mus'hafet u dërguan në qendrat kryesore si Mekke, Medine, Kufe, Sham, Basra, Jemen dhe Bahrej, të cilat kishin nga një imam, që kishte zgjedhur një lloj leximi të kiracteve dhe atë ua mësonte edhe njerëzve. Banorët e vendeve përkatëse filluan të lexonin sipas asaj që ndodhej në mus'hafin e tyre. Në këtë mënyrë, edhe mosmarrëveshja u largua, edhe Kur'ani u mbrojt nga çfarëdolloj shtrembërimesh.

bazë të këtij përfundimi ata thonë se nuk lejohet neglizhimi në transmetim qoftë edhe i një diçkaje të vogël në lidhje me shtatë shkronjat. Ata gjithashtu janë në konsensus për braktisjen e çdo gjëje tjetër përveç shtatë shkronjave, duke thënë: nuk lejohet ndalimi i leximit me disa prej shtatë shkronjave dhe nuk lejohet braktisja e diçkaje, që është prej Kur'anit.

Ndërsa shumica e dijetarëve të parë, të mëvonshëm dhe e imamëve të tjerë janë të mendimit se mus'hafet osmanije përfshijnë vetëm atë që përmban pamja, resmja, fotoja e tyre prej shtatë shkronjave. Nisur nga prezantimi ballë për ballë¹⁴ dhe i fundit i Kur'anit ndërmjet Profetit dhe engjëllit të shpalljes, mus'hafet osmanije janë përmbledhëse dhe përfshirëse të të shtatë shkronjave pa çuar dëm as edhe një germë. Në ndryshim nga herët e tjera, Profeti a.s. në vitin që shtegtoi në botën e përtejme, e këndoi Kur'anin me Xhibrilin a.s., engjëllin e shpalljes, dy herë, pra një herë këndonte Profeti dhe dëgjonte Xhibrili, pastaj këndonte engjëlli, Xhibrili a.s. dhe dëgjonte Profeti, dhe herën e dytë këndonte Profeti e dëgjonte engjëlli, më pas këndonte engjëlli dhe dëgjonte Profeti. Në total, vitin e fundit Kur'ani është kënduar katër herë me nga dy seanca.¹⁵ Ibnu'l Xhezerî e mbështet këtë mendim

14. Mukabele. Kjo është një nga format e foljes në gjuhën arabe, që nënkupton një veprim të kryer në mes dy a më shumë personave.

15. Muhammed Zâhid El'Keutherî, *Makâlâtul'Keutherî* f.5.

dhe thotë se hadithet e sakta të transmetuara dhe veprat e famshme janë argumentuese të këtij mendimi.

Leximi sipas shtatë shkronjave nuk është vaxhib por është i lejuar, si lehtësi për ymetin. Secili është i lirë të lexojë me cilën shkronjë ka lexuar më parë. Një mendim është se lejimi rreth shtatë shkronjave ishte i posaçëm për kohët e para të Islamit në mënyrë, që të ruhej në një shkronjë të vetme, sepse njerëzit vështirësoheshin në leximin me të shtatë shkronjat. Në kohën që gjuhët u mësuan me artikulin e tyre arritën në unanimitetin e leximit me një shkronjë të vetme, si një shenjë lehtësimi për njerëzit. Ky është mendimi më i përshtatshëm. Në fund ata ranë në konsensusin e leximit sipas shkronjës me të cilën u lexua në prezantimin e fundit të Kur'anit.

Ka pasur kontestime të ndryshme për sa u përket kiraeteve, të cilat, përbri tyre, kanë pastur të shënuara edhe disa pjesë komentuese. Abdullah b. Mes'udi nuk e pëlqente një gjë të tillë dhe madje thonte: “Veçojeni Kur'anin dhe mos e përzieni atë me gjëra që nuk janë nga Kur'anit!”¹⁶ Sahabet e nderuar i shkruan këto mus'hafë në bazë të verifikimeve, memorizimeve dhe në bazë të asaj, që u konsolidua gjatë prezantimit ballë për ballë me leximin e fundit të Kur'anit. Nëse këto përputheshin me njëra-tjetrën, ato regjistroheshin në mus'hafet

osmanije. Më pas, sahabet e nderuar mus'hafet i shkruan pa pika dhe forma, që mënyra argumentuese e të dyja fjalëve të transmetuara, të dëgjua dhe të kënduara të jetë e ngjashme me mënyrën argumentuese të një fjale të vetme sipas të dyja kuptimeve, arsytetimeve dhe koncepteve. Shkenca që merret me çështjen e pikave, zanoreve dhe formës së shkronjës quhet ‘ilmu resmi’l mus’hafi ue dabtuh (رِسْمٌ عِلْمٌ الْمُصْحَفِ وَ ضَبْطُهُ).

f) A janë kiraetet që lexohen në ditët e sotme përfshirëse të të gjitha shtatë shkronjave apo të një pjese të tyre?

Një pjesë e mirë e njerëzve mendojnë se shtatë shkronjat e përmendura në hadith janë shtatë kiraetet. Për këtë arsye, shumica e dijetarëve nuk e kanë pëlqyer shkurtimin e bërë nga Ibn Muxhahidi në shtatë imamë. Dijetari Ibn Tejmije thotë se “shtatë shkronjat e përmendura në hadith nuk janë shtatë kiraetet, apo shtatë imamët.” Hadithi i Profetit a.s. kurrsesi nuk duhet të mendohet i kufizuar në shtatë kiraete. Thelbi është se kiraeti merret nga një imam i besueshëm fjalë për fjalë, derisa zinxhiri i transmetimit të arrijë te Profeti a.s.

Në fakt, kiraetet nuk kanë kontradiktë, apo mospërputhje me njëra-tjetrën. Ato dallojnë për nga variacioni dhe larmia e llojeve të leximit. Nuk mund të mendohet që mospërputhja të jetë veçoria e kiraeteve, sepse Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë thotë:

16. El'Hâkim En'Nejsâbûrî, *El'Mustedrak Ala's-Sahîhajn* 1/183; Ahmed b. Hanbel, *Musned* 1/132; Et'Tahâûi, *Sherhu Mushkili'l Aîbâr*15/316 .

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ
لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا

“A nuk përsiatin ata për Kuranin!
Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të
gjenin në të shumë kundërthënie.”¹⁷

Çdo gjë e transmetuar në mënyrë të saktë nga Profeti a.s. është obligim të pranohet. Nuk mund të pranohet refuzimi i tij dhe automatikisht kërkohet t’i besohet atij transmetimi, sepse ai është zbritur prej Allahut xh.xh. Pozita e çdo kiraeti në krahasim me kiraetin tjetër është e ngjashme me pozitën e ajeteve me njëra-tjetrën, ku është obligim besimi ndaj tyre dhe ndjekja e thelbit si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ajo e vënies në praktikë. Nuk lejohet braktisja e njërit prej tyre me idenë se në mes tyre mund të ketë ndryshime. Sahabiu i nderuar Abdullah b. Mes’udi shprehet tekstualisht:

“Mos u konfliktoni dhe mos bëni polemikë në çështjen e Kur’anit, sepse në të nuk ka ndonjë gjë për konflikt, apo për t’u ngatërruar. A nuk e shikoni që ligji i Islamit, kufijtë e vendosur nga ai, leximi i tij (ligjit të Islamit) dhe urdhëresat e Allahut janë të njëjta, pra nuk ndryshojnë? Nëse njëra nga shkronjat e zbritura të Kur’anit do të urdhëronte për diçka, e shkronja tjetër do të ishte penguese për të, atëherë këtij mund t’i thuhet kontradiktë. Mirëpo Kur’ani i përfshin të gjitha llojet e leximeve. Ai që lexon sipas një kiraeti të mos e braktisë atë me idenë se kiraeti tjetër është më i mirë. Ai që mohon njërën nga shtatë shkronjat ka mohuar të

tërë Kur’anin.”¹⁸

Larmia që bie në sy në mes lexuesve të kiraeteve është e ndryshme nga ajo në mes juristëve. Llojshmëria e lexuesve të kiraeteve është e saktë dhe e drejtë, sepse Kur’ani ka zbritur prej Allahut, është fjalë e Tij dhe në këto dy pika nuk ka kurrfarë dyshimi. Ndërsa ajo në mes juristëve është dallim dhe ndryshim ixhtihadi.

Çdo shkollë juridike në krahasim me tjetrën është e saktë, mirëpo nuk përjashtohet mundësia e gabimit. Ndërsa çdo kiraet, që plotëson kushtet e pranimit në krahasim me tjetrin është edhe i drejtë, edhe i saktë dhe besimi jonë është në këtë vijë. Gjithashtu ne besojmë se bashkëngjitja e çdo shkronje prej shkronjave të larmisë të sahabet është sepse ata e memorizuan, lexuan, u kapën fort pas tij dhe u orientuan drejt tij më mirë dhe më shumë se të tjerët. Po kështu edhe bashkëngjitja e shkronjave dhe e kiraeteve të imamët dhe transmetuesit e kiraetit. Çdo lexues, apo imam zgjedh një kiraet me një mënyrë leximi në një dialekt në bazë të kiraetit që lexon, e përthith, e vazhdon atë lloj leximi, kapet fort pas tij, derisa bëhet i famshëm me mënyrën e leximit dhe shndërrohet në referencë për të tjerë, që vijnë dhe marrin mësim prej tij. Kjo lloj bashkëngjitjeje lidhet me zgjedhjen, vazhdimësinë dhe domosdoshmërinë e jo me mendimin apo ixhtihadin.

18. Ibnu’l Xhezerî, *En’Nesbr Fi’l Kirââtîl Asbr* 1/51; Zurkânî, *Menâbilul ‘Irfân Fî ‘Ulûmi’l Kur’ân* 1/186.

17. Kur’an, En’Nisâ 4/82.

g) Cilat janë dobitë e llojeve të ndryshme të kiraeteve dhe variacioneve të tyre?

1) Pika më e lartë e elokuencës, perfeksionimi i i'xhazit¹⁹, maja e koncizitetit bashkë me ekzaktësinë dhe bukuria e lakonizmit. Secili kiraet ka pozitën e ajetit. Nëse dallimet ndërmjet fjalëve vendosen në vend të ajeteve dhe nëse bëhet shënjimi i çdo fjale si ajet, sipas madhësisë së tij, atëherë do ishte i pashmangshëm zgjatimi.

2) Ndër argumentet e mëdha dhe evidente është se, ndonëse ka kaq shumë variante dhe llojshmëri në kiraete, ata nuk bien në kundërshti dhe kontradiktë me njëri-tjetrin. Përkundrazi, ata vërtetojnë, shpjegojnë dhe dëshmojnë për njëri-tjetrin sipas një metode dhe stili të njëjtë.

19. Megjithëse në gjuhën shqipe përkthehet “mrekulli”, ky nuk është ekuivalenti i plotë i fjalës i'xhâz. Mbase përshtatja në formën “pamundësia dhe dobësia për të bërë një ajet, sure apo libër të ngjashëm me Kur'ânin, si dhe dalja i mposhtur nga kjo tentativë” do të jepte një ide disi më të përafërt me kuptimin e kësaj fjale.

3) Lehtësia e memorizimit dhe e transmetimit të bashkësia.

4) Shpërblimi i madh për bashkësinë. Ata shpenzojnë energji në mënyrë që të arrijnë objektivin e tyre në kërkimin e kuptimeve, apo në deduktimin e urtësive dhe gjykimeve nisur nga aludimi i çdo fjale.

5) Virtyti dhe vlera e kësaj bashkësie në krahasim me bashkësitë e tjera për sa i përket pranimit, orientimit kah libri, kërkimit fjalë për fjalë, zbulimit shprehje për shprehje, kumtimit të saktësisë dhe korrektësisë së tij, perfeksionimit të rregullave të texhvidit. Ruajtja nga deformimet dhe shtrembërimet, mosneglizhenca qoftë edhe e një zanoreje, apo sukuni, një tefkhîmi, apo terkîki derisa konsoliduan kohën e zgjatjes së meddeve, dallimet ndërmjet imaleve dhe bënë ndarjen në mes shkronjave dhe cilësive të tyre.

6) Ndër karakteristikat e tjera dalluese është edhe lartësimi i gradës së personit tek Allahu, si pasojë e transmetimit me saktësi të çdo shkronje të Kur'anit, duke mos lënë hapësira dyshimi. Nëse nuk do të shquheshin tiparet e tjera, kjo karakteristike do të mjaftonte si një veçori e vetme.

Referenca:

Buhâri, *Husûmât* 3, *Bed'u'l halk* 6, *Fedâilu'l Kur'an* 5, 27, *Istitâbetu'l Murteddîn* 9, *Teuhîd* 53; Muslim, *Salâtu'l Musâfirîn*.

El'Hâkim En'Nejsâbûrî, *El'Mustedrak Ala's-Sahîbjân* 1/183; Ahmed b. Hanbel, *Musned* 1/132; Et'Tahâûi, *Sherhu Mushkili'l Âthâr*.

Fahru'd-dîn Er'Râzî, *Mefâtîhu'l Gajb*.

Ibn Mandhûr, *Lisânu'l Arab* 9/41; Zebîdî, *Tâxhu'l Arûs Min Xbeuâhiri'l Kâmûs* 128/23 ; Komisioni i Gjuhës Arabe në Kajro, *El'Mu'xbemu'l Uasît*.

Ibnu'l Xhezerî, *En'Nesbr Fil Kirââti'l Asbr*.

Kur'an, përkthim i Hasan Nahit, botim “Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam”, viti 2006.

Muhammed Zâhid El'Keutherî, *Makâlâtu'l Keutherî*, shtëpia botuese “Râtib Hakîmî”.

Zerkeshî, *El'Burhân Fî 'Ulûmi'l Kur'an*.

Zurkânî, *Menâhîlu'l 'Irfân Fî 'Ulûmi'l Kur'an*.

Globalizmi, dialogu, feja dhe metafizika

Dr. Genti Kruja
Kryeredaktor i Revistës Shkencore “Zani i Naltë”

Abstrakt

Sipas studiuësve të shkencave sociale, vlerat bazë të shekullit XXI janë modernizmi, pluralizmi, individualizmi dhe feja. Disa pretendojnë që modernizmi i ka bërë njësh jetën vetjake dhe shoqërore, duke krijuar forma të reja të jetës fetare, kulturore dhe pluralizmit politik. Megjithëse trajtohet me pikëpamje të ndryshme, modernizmi ka krijuar dy nënfenomene ideologjike: zhvillimin dhe globalizmin. Shumë teoricienë e kanë përshkruar modernizmin prej perspektivës së shtimit të sovranitetit njerëzor përtej kufirit të tij dhe përparimit të shkencës. Kjo lidhje e drejtpërdrejtë e vendosur midis shkencës, nga njëra anë, dhe aftësive e sovranitetit, nga ana tjetër, ka treguar mundësinë, që u jepet shteteve të fuqishme për të sjellë forma të reja të dominimit të vendeve dhe popujve të tjerë.

Meqë globalizmi ka një kuptim të tillë ideologjik, shumë e shohin të jetë thjesht një imperializëm klasik nën një emër tjetër. Ideologjik ose jo, globalizmi ka shkaktuar një ndryshim themelor në të gjitha fushat, nga ato ekonomike dhe të shkencave shoqërore, në marrëdhëniet e politikës, në fushën e ligjeve, në historinë dhe gjeografinë e administrimit të shtetit. Në fakt, globalizmi ka vulgarizuar pasurinë, teknologjinë, pluralizmin demokratik, prodhimin dhe konsumin. Dhe pas kësaj, përsëri, ka ndihmuar të shpalosen të gjitha llojet e përdhosjes: njerëzore, mjedisore, ose politike. Varfëria, ndotja ekologjike, armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi dhe dhuna janë globalizuar jo pak.

1. Globalizmi

Globalizimi i dijeve, pushteteve dhe teknologjive është

pasuar prej teorisë së një konflikti të mundshëm midis kulturave dhe qytetërimeve. Për pasojë, të gjitha këto, që janë rezultat i modernizmit apo globalizmit, kanë vendosur

një numër të madh konceptesh në rend të ditës. Shumë koncepte janë përcaktuar ose ripërcaktuar brenda kontekstit të modernizmit, demokracisë dhe pluralizmit: të qenët njerëzor, individualizmi, liria e të menduarit, feja, politika, shoqëria dhe toleranca kulturore, konflikti me konkurrencën, dialogu me konfliktet, etj.

Nuk ka dyshim se bota sot ka nevojë, me shumë urgjencë, për dialog ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve më tepër se kurrë më parë. Shkenca dhe teknologjia e armatimeve - mbase jo krejtësisht, por në një masë domethënëse - mund të jetë e shqetësuar prej shpërdorimit të saj për manipulime ideologjike. Ky lloj i manipulimit ideologjik të shkencës dhe teknologjisë, përhap dhe përgjithëson kërcënimet fetare, kulturore, shoqërore si dhe dallimet krahinore e etnike. Reagimet më të mëdha kundër globalizmit vijnë nga vendet në zhvillim. Ky reagim nuk mund të shihet si një kundërpërgjigje ndaj modernizmit. Dimensionet ideologjike të modernizmit janë perceptuar, në një sens të gjerë, si një kërcënim ndaj feve, kombësive, historisë, kulturës dhe identitetit. Atëherë një situatë e tillë mund të shkaktojë grindje të reja në konfliktet e ngjallura.

Nga njëra anë, për pothuajse një çerek shekulli, platformat e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë dëshmuar një proces me diskutime

të ashpra, të rëndësishme dhe me një rrezik të madh, të tillë si një përplasje qytetërimesh. Me ngjyrimet e tyre politike dhe ideologjike, këto janë teza që kanë ardhur nga shekuj të trazuar. Tezat e Hantingtonit për konfliktin e qytetërimeve kanë qenë në qendër të vëmendjes ndërkombëtare dhe kanë fituar një vend të gjerë dhe shumë fundamental në diskutimet globale të tre dekadave të fundit. Jehona dhe efektet e kësaj teorie në marrëdhëniet ndërkombëtare vazhdojnë akoma.

Kështu, urrejtja ushqehet nga ndjenja si, frika, pasiguria, pakënaqësia e padrejtësia. Kësaj i shtohet edhe prirja që kanë njerëzit për të besuar në një fajësi kolektive me të gjitha pasojat negative që tërheq pas vetes. Po kështu, shpesh, justifikohen aktet terroriste, duke i bërë thirrje fajësisë dhe përgjegjësisë kolektive. Sigurisht, urrejtja fetare nuk është e vetmja formë e urrejtjes, por, meqë pranohet se feja duhet të ketë pronë të saj dashurinë dhe tolerancën, urrejtja fetare është tepër revoltuese.

Krahas këtyre ka gjithashtu edhe një instrumentalizim të fesë për qëllime politike. Luftërat e viteve '90, në ish-Jugosllavi, janë një ilustrim tragjik, se si mund të përdoret feja në një konflikt për interesa etno-politike.

Por, përveç këtyre dy tipave të dhunës kemi edhe një përmasë të tretë të saj; dhuna kulturore. Këtu kemi të bëjmë me disa aspekte të

kulturës, që kanë të bëjnë me sferën simbolike të ekzistencës sonë, që shprehet nga feja dhe ideologjia, gjuha dhe arti etj., që mund të përdoren për të legjitimuar dhunën direkte ose strukturore.¹

Atëherë, a nuk kemi mundësi të lexojmë brenda këtij konteksti, si dhe atij të modernizmit dhe globalizmit një synim të shëndoshë? A mundet që modernizmi dhe globalizmi të mos realizojnë më shumë konstruktivitet? A mundet që ata të mos përqendrohen më shumë te vlerat njerëzore dhe etike? Ata që mendojnë t'u përgjigjen këtyre pyetjeve, përpiqen t'i minimizojnë ato ose t'i shohin thjesht si një problem për t'u perceptuar. A janë modernizmi dhe globalizmi, në fakt, fenomene kaq të thjeshta që ta minimizojnë problemin thjesht për t'u perceptuar dhe për t'u kuptuar? Globalizmi dhe modernizmi, në terma ideologjike, janë kuptuar nga popujt, kombet dhe qytetërimet e ndryshme, si mundësi për përplasje kulturash. Në këtë mënyrë, këto teza janë të njëjta me ato të Hantingtonit (Huntington) dhe Fukujamas (Fukuyama), që deri diku parashikimet e tyre, duken sikur marrin jetë në skaje të ndryshme të globit.

Në anën tjetër, bashkë me problemet kronike të qytetërimit

1. Sinani, Prof. Dr. Gjergj, "Dialogu ndërfaqetarak e ndërkulturore si vlera integrale", Prizmi, Tiranë, 2008:60-61.

modern, të tilla si përhapja e terrorizmit global, dhuna dhe armët e shkatërrimit në masë, të cilat shkojnë në mbështetje të tezave të konflikteve, ka edhe përpjekje serioze, që vënë në dukje përputhjet midis shoqërive me kultura dhe qytetërimeve të ndryshme, që arrihen përmes demokracisë, tolerancës, dashurisë dhe dialogut. Këto kanë spikatur më tepër në çerekun e fundit të shekullit XX. Këto përpjekje nuk kanë shkaktuar, direkt ose indirekt, ndonjë konflikt të brendshëm me modernizmin ose globalizmin. Ato kanë prodhuar më shumë vlera etike universale dhe themelore njerëzore, si edhe dinamizëm për të kapërcyer aspektet negative të modernizmit dhe globalizmit. Fatmirësisht iniciativa të tilla për dialog midis qytetërimeve dhe kulturave kanë qenë miratuar gjithmonë prej shumicës, kurse për disa kanë qenë gjithmonë vetëm zhurmë mediatike dhe asgjë tjetër.

Por një pjesë e medias ndërkombëtare, duke mos iu përmbajtur etikës dhe vlerave njerëzore, ka popullarizuar pa mëshirë dhe pa maturi vetëm terrorizëm, dhunë, shkatërrim vlerash e rezultatesh dhe në këtë mënyrë, fatkeqësisht, ka zmadhuar numrin e këtyre mbështetësve. Reagimin e ashpër kundër tezave të Hantingtonit, në fakt, e shfaqti nevoja e zjarrtë për konkurrencë dhe dialog, ndonëse veprimet konkrete, që janë marrë në drejtëm të vënies

së themeleve për konkurrencën dhe dialogun, janë fare pak për t'u përmendur, ose përpjekje të tilla nuk kanë pasur efekt global. Arsyet e këtij qëndrimi të përgjithshëm të heshtur dhe indiferent duhen kërkuar në efektet e transformimeve moderniste të njerëzimit dhe shoqëria.

Modernizmi ka nxitur individualitetin, materializmin dhe instinktvet vetjake të njerëzve në kundërshtim me shoqërinë, i ka larguar njerëzimit nga gjëra, që ata mbajnë të shenjta, humane dhe etike. Kur vështrojmë degradimin e shoqërisë, ajo që kuptohet është se për çfarëdolloj arsye, gjithçka përfundon te problemi i njeriut. Kur njerëzimit janë destruktivë, të dëmshëm, armiqësorë dhe agresivë, atëherë ata skllavërojnë bashkësinë shoqërore dhe njerëzore në të cilën bëjnë pjesë edhe vetë. Rruga për të shpëtuar qytetërimin bashkëkohor prej shkatërrimit të shpejtë është të riedukohen qeniet njerëzore në bazë të dashurisë, tolerancës dhe dialogut, duke qenë të bashkuar.

Sipas Tokëvilit, "Njerëzimit nuk ndryshojnë shumë në Amerikë dhe në Evropë dhe ata kanë të njëjtat pasione, që janë karakteristike për gjendjen sociale demokratike; padurimi për fatin e tyre, shqetësimi për t'u dukur, dëshira për të arritur ata që janë më lart. Këtë gjendje shpirtërore amerikanët e kanë bërë natyrë të shoqërisë së tyre dhe motorin e saj, por merita e tyre është

se ata i kanë kanalizuar këto përmes së drejtës, fesë, institucioneve dhe zakoneve."²

Materializmi, mediokriteti, individualizmi dhe izolimi, që lindin, e marrin forcën nga barazia e kushteve dhe përbëjnë thelbin e mësimit të Tokëvilit mbi demokracinë. Një regjim, në të cilin këto pasoja nuk zbuten, në një mënyrë ose një tjetër, një regjim në të cilin nuk inkurajohen aftësitë më të larta, në të cilin shoqëria do të ndalej dhe virtytet publike të shkonin drejt shuarjes, një regjim i tillë mund ta vinte në dyshim mundësinë, që i ka dhënë vetë Providenca që e krijoi.³

2. Dialogu filozofik gjatë historisë

*"Një civilizim nuk guxojmë ta çmojmë sipas pushtetit që ka krijuar, po në bazë të asaj se sa dashuri ndaj njeriut ka shprehur në ligjet dhe arritjet e veta"*⁴, thotë Tagore.

Bota ka kaluar në faza dhe periudha të ndryshme historie, ku paqja ka pasur si kundërshtare luftën, si dhe dialogu përplasjen. Këto kanë bërë që duke filluar që nga individi dhe më tej shoqëria, shtetet, kulturat dhe qytetërimet, domosdoshmërisht kanë pasur marrëdhënie njëra me tjetrën.

2. Sinani, Prof. Dr. Gjergj, "Alexis de Tocqueville: 200 vjet pas", f. 212-213.

3. Po aty, f. 222.

4. Abazoviç, Dritan, "Kultura kozmopolite dhe drejtësia globale", Qendra për Kulturë, Ulqin, 2009:11.

Ndërsa sot kemi ardhur në kohën e globalizimit dhe të globalizimit, ku marrëdhëniet ndërkombëtare dhe dialogu ndërkulturor, ndëretnik dhe ndërftetar, ka marrë një rëndësi të përmasave të pazakonta.

Debati mbi kulturën kozmopolite fillon pa dyshim nga sqarimi i nocionit të kozmopolitizmit në kornizat e veta historike. Origjina e shprehjes *kozmpolitizëm* dhe *kozmpolite* në Evropë rrjedh prej grekëve, sidomos nga shkolla e stoikëve dhe idealet e tyre për qenien njerëzore me të drejta universale, të cilat i ka si qytetar i “*kozmpolisit*”. Ky term ka filluar të përdoret së pari në Evropën paraindustriale në punimet e elitave intelektuale evropiane dhe ka pasur të bëjë me universalizmin politik dhe kulturor që ka kontestuar partikularizmin e kombeve dhe shteteve, në një anë, dhe pretendimet e universalizmit fetar, në anën tjetër. Kozmopolitizmi vjen nga fjala *kosmos*-botë, gjithësi, univers; dhe fjala *polis*-qytet, shtet.

Kultura globale nga të gjitha anët e botës, kontribut për të cilën kanë dhënë të gjithë njerëzit gjatë mijëra viteve, përmes librave, pikturave, muzikës, fesë, ndërtimeve, zbulimeve, filozofisë, letërsisë, etj., në të vërtetë i jep legjitimitet mendimit kozmopolit.

Mirëpo që të arrijmë në dialogun e kulturave dhe bashkëjetesën e tyre, një vend të rëndësishëm duhet të luajë edhe drejtësia. Drejtësia është një koncept filozofik, që kërkon qasje filozofike. Xhon Rols në librin e tij “Teoria e

drejtësisë” sqaron se, “Drejtësia është virtyti i parë i institucioneve shoqërore, siç është e vërteta virtyti i parë i sistemit të menduarit. Një teori sado elegante dhe ekonomike që të jetë, duhet të hidhet poshtë ose të ndryshohet, nëse është e pavërtetë, po ashtu ligjet dhe institucionet, sado efikase dhe të rregulluara që të jenë, duhet të hiqen nëse janë të padrejta.”⁵

Drejtësia globale nuk është e mundur pa vetëdijen shoqërore. Ajo arrihet me nxitjen e shkencës, arsimit dhe diturisë për të krijuar shoqëri progresive. Gjithashtu, e rëndësishme është që të përtërihen edhe disa dije tradicionale dhe të lidhen me arritjet bashkëkohore. Drejtësia globale nënkupton krijimin e shoqërisë së jodhunës, përkrahjes dhe diversitetit. Për më tepër nënkupton kulturën e tolerancës, bashkëpunimit, si dhe bashkëjetesën e kulturave tradicionale dhe të reja, stileve të jetës dhe mentalitetit.⁶

Kozmopolitizmi është pikësëpari nocion filozofik, që, pa një analizë të thellë dhe të bazuar, nuk mund të zërë vend. Kultura kozmopolite dhe drejtësia globale edhe pse në vetvete mund të quhen ide utopiste, në fakt praktikimi i metodave që të çojnë në dialogun dhe bashkëjetesën e kulturave dhe diversiteteve, tregon se çdo gjë është e arritshme.

5. Rols, Xhon, “Teoria e drejtësisë”, 1998:21.

6. Abazović, Dritan, “Kultura kozmopolite dhe drejtësia globale”, Qendra për Kulturë, Ulqin, 2009:157.

Filozofi gjerman Ode Marqurad thotë: “Filozofi është kur mendohet pa marrë parasysh.”⁷ Po kështu kjo mund të thuhet edhe për kulturën kozmopolite, pjesë e së cilës është edhe filozofia, të mendosh pa marrë parasysh kufizimet, të mendosh pozitivisht dhe të mendosh kthjellët. As drejtësia globale nuk është prodhim i pamundur i të menduarit të tillë!

3. Një vështrim mbi pozitivizmin dhe progresin

Revolucionet shkencore, që ndodhën në Perëndim gjatë shekujve XVI-XVII, e çuan mendimin perëndimor dalëngadalë drejt një bashkimi me qëndrimet pozitiviste të shekullit të XIX, që përbënin ideologjinë në rritje të asaj periudhe. Pikëpamjet mekanike të hedhura nga Galileu, Kepler, Koperniku, Njutoni dhe Bojli, ishin të modeluara në përputhje me pikëpamjet solide materialiste dhe pozitiviste të ndihmuara edhe nga racionalizmi. Që nga shekulli i XIX, pozitivizmi u shndërrua në ideologjinë kryesore formuese të mendimit shkencor perëndimor.

Pozitivizmi, që përfaqëson një sistem empirik të filozofisë së shkencës, bazohet në përdorimin e vëzhgimit dhe të eksperimentit për të interpretuar dhe shpjeguar ekzistencën. Ai merr në konsideratë

7. Po aty, 182.

vetëm dijet pozitive dhe e kufizon dijen brenda perceptimit nga shqisat njerëzore. Ai hedh poshtë çdo rrugë tjetër dijeje, duke theksuar se dija mund të fitohet dhe të shpjegohet vetëm nga pikëpamja empirike.⁸

Ky këndvështrim mekanik i shkencës, shpjegon strukturat, veprimet dhe lidhjet që ekzistojnë në ligjet e natyrës. Pozitivistët deklarojnë se rregulli i brendshëm i ekzistencës përcaktohet nga ligjet e natyrës dhe se ekzistenca nuk ka brenda vetes fuqi metafizike, shpirtërore apo të mbinatyrshme. Prandaj këto ligje të brendshme mund të zbulohen vetëm nëpërmjet përdorimit të shkencave pozitive dhe empirike. Pozitivizmi, nuk i bën thirrje arsyes njerëzore për të kërkuar rrugë të tjera shpjegimi përveç atyre të përvojës empirike.

Pozitivizmi është aplikuar në fushat e sociologjisë, filozofisë dhe shkencave politike nga mendimtarë perëndimorë si Seint Simon, Komte, Mach, etj. Me daljen në skenë të Rilindjes dhe Teorisë së Evolucionit, gjatë shekullit XIX, ideologjia e progresivizmit, u ngrit lart. Konceptet dhe teoritë e ekzistencës, të qenies njerëzore, të natyrës dhe shoqërisë, u riorganizuan në përputhje me ideologjinë e evolucionit. Çdo zbulim i ri solli tok me të, zgjidhje të reja dhe hapi fusha të reja kërkimi, duke i kushtuar

8. Ergene, Enes, “Një analizë e Lëvizjes Gylen, Dëshmia e traditës moderne”, Prizmi, Tiranë 2009:69.

kështu vëmendje të madhe dijeve shkencore. Botëkuptimi perëndimor erdhi në përfundimin që natyra gjithashtu kishte një histori progresi. Ky besim, krahas idealeve pozitiviste të Rilindjes Evropiane, e përforcoi idenë e “progresit” dhe shpalli se njerëzit dhe shoqëritë njerëzore që ishin pjesë e natyrës kishin gjithashtu progres. Ky progres kishte ligje që mund të përcaktoheshin shkencërisht dhe se këto ligje mund të specifikoheshin nëpërmjet dijes empirike dhe eksperimentale.

Në vepërën e tij “*Struktura e Revolucioneve Shkencore*”, T. S. Kuhn argumenton se shkencëria përmban një strukturë ideologjike në të njëjtën mënyrë si revolucionet politike. Sipas Kuhn, shkencëtarët, filozofët dhe historianët kanë deklaruar gjithmonë se sipas mendimit të tyre, shkencëria përbën pikën më të lartë që mund të arrijë njerëzimi. Ekziston një qëndrim i përhapur gjerësisht se nga pikëpamja ideologjike, rezultatet që sjell shkencëria përbëjnë pozicionin e vetëm të mundshëm që mund të arrijë një person. Po, a ishte në të vërtetë kështu? A ka ndjekur shkencëria dhe dija një linjë të drejtë dhe konstante? A nuk kishte opsione apo metoda të tjera alternative që kontribuuan në këtë progres? Në vitet ‘60, Thomas Kuhn i shtroi këto pyetje dhe goditi frymën e mbretërimit të progresivizmit dhe të mendimit shkencor.⁹

9. Po aty, 69.

Historia e shkencës provon se sipërmarrjet shkencore nuk kanë buruar si rezultat i një grumbullimi të pandërprerë dhe të vazhdueshëm; nganjëherë ka pasur pauza të mëdha transformimesh revolucionare. Ekzistojnë teza të pafundme shkencore, teori dhe ide që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Sipas Kuhn, shkencëria moderne është rezultat i ndërveprimeve dhe i konflikteve, që kanë ndodhur ndërmjet ideve të ndryshme. Në këtë pikëpamje, “progresi” në fushën e shkencës nuk mund të matet nëpërmjet një tradite, apo metode të veçantë. Përveç dijes së fituar nga metodat shkencore, shoqëria duhet të marrë parasysh edhe kushtet historike apo shoqërore, ndjenjat fetare dhe morale, si dhe gjykimet e ndryshme të vlerave dhe të preferencave.

Shumë dijetarë dhe mendimtarë si Popper, Lakatos, Althusser, Uittgenstein, Feyerabend, Durheim dhe Kuhn kanë vënë në pikëpyetje rrugën evropiane të shkencës, secili prej tyre me argumentet e veta. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ka qenë aq i mirëpritur sa Kuhn. Askush nuk mund të specifikojë qartë qëndrimin evropian rreth shkencës pa specifikuar marrëdhëniet ndërmjet dijes dhe pushtetit.

4. Feja dhe metafizika

Shkencëtarët e shquar si Keppleri, Galileu, Njutoni, Bojli, Dekarti, Paracelsus e madje edhe Bekoni, e perceptonin universin si një libër që buronte nga vullneti dhe Fuqia e Zotit.

Filozofia natyraliste e Aristotelit u kristianizua në kulturën e skolasticizmit. Institucionet e katolicizmit përvetësuan fusha tradicionale të shkencës, dijeve natyrore dhe kozmologjisë, që lidheshin me emrat e shkencëtarëve të tillë si Aristoteli, Galen, Ptolemeu, Anselm dhe Thoma Akuini, aq shumë sa, në Evropë, këto pikëpamje u pranuan si autoriteti i vetëm deri në shekujt XV-XVI. Sistemi gjeocentrik i Ptolemeut, ishte i njohur zyrtarisht nga krishterimi deri në momentin kur doli në skenë sistemi heliocentrik i Kopernikut dhe i Galileut. Vëzhgimet e Galileut dhe thëniet e tij se Toka rrotullohej rreth Diellit, kundërshtuan doktrinën themelore të Krishterimit që thoshte se Dielli rrotullohej rreth Tokës.

Sipas studuesit Ergene, Galileu nuk synonte të luftonte fenë, por të paraqiste pikëpamjen se natyra që buron nga vullneti i Zotit, i ngjan Biblës në kuptimin se ajo është një libër që duhet lexuar. Ai mbështet idenë se referencat biblike në lidhje me palëvizshmërinë e tokës dhe rrotullimin e Diellit rreth saj nuk duheshin marrë në konsideratë fjalë për fjalë, por në kuptimin metaforik.

Kur pikëpamjet mekanike ishin duke u përhapur, hyri në përdorim edhe koncepti i “Librit të Natyrës.” Mjeku rilindës zviceran, Paracelsus (shek. XVI), ka qenë i pari, ndoshta që nga koha e Shën Agustinit, që i bënte thirrje njerëzve “të lexonin Librin e Natyrës”. Për të, filozofia reale ishte e shkruar në një libër të madh, universin, i cili është i hapur vazhdimisht ndaj hulumtimit të njerëzve. Ky libër është i shkruar në gjuhën e matematikës dhe shkronjat e tij janë trekëndëshat, rrathët dhe figurat e tjera gjeometrike, pa të cilat është e pamundur të kuptohet edhe një fjalë e vetme e këtij libri.

Detyrat e imamëve dhe thirrësve drejt myslimanëve dhe të tjerëve

Dr. Xhemal Seferti
Departamenti i Shkencave Islame
Kolegji Universitar Bedër

Abstrakt

Modeli i udhëbeqjes së profetit Muhamed a.s. është shembull. Ishte ai, i cili e mbarti mbi supe (kerabë) rëndësinë e thirrjes dhe ai e filloi këtë me shokët e tij fisnikë, që t'ua komunikojnë mesazhin e mirësisë dhe dashurisë me rrugën e udhëzimit, dritës e mëshirës dhe ky Profet fisnik e filloi thirrjen e tij të mbështetur në dy shtylla themelore:

Shtylla ku mbështetet është bashkëpunimi me popullin, të cilët janë të kënaqur me pasimin e tij dhe besimin në mesazhin e tij të ngritur mbi fjalën e Zotit xh.sh. "S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër," dhe "e sikur të ishte i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje".

Nga këtu shohim, kuptojmë se nuk i lejohet asnjë imami, thirrësi, dijetari, mendimtari, kërkuesi, studiuesi, gjykatësi, të gjykuari (dënuari), të bëjë diçka në kundërshtim me atë që ka vendosur, përcaktuar Imami i parë, Muhamedi a.s., dhe ta shpjegojë, komentojë traditën e tij të ndërtuar mbi themelet e drejtësisë, mëshirës dhe dashurisë mes njerëzve, ashtu siç dubet dhe siç mendon ai se ajo është e drejtë dhe saktë.

Vërtet Imami dhe thirrësi ka gradat më të larta, pozitat më të larta dhe misionin (detyrën, punën) madhështor për ngritjen e popullit për përhapjen e mirësisë dhe të dobishmes mes njerëzimit mbarë.

Imam dhe thirrës i suksesshëm është ai, i cili e merr për model dhe shembull Profetin Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Të.), dhe kjo u takon të gjithë të sinqertëve dhe besnikëve në bartjen e mesazhit islam, sepse ai ishte imami i parë i

kësaj thirrjeje të ndershme, i cili e pranoi këtë mesazh, e çoi në vend (e kreu) ashtu si duhet dhe e shpërndau dritën e thirrjes, të mirësisë e dashurisë nën flamurin “Dhe Ne nuk të dërguam Ty veçse mëshirë për të gjitha botët.”¹

Nëse imami dhe thirrësi niset me këtë metodë madhështore të Profetit a.s., nën hijen e këtij flamuri të ndershëm, me emër të Zotit do të jetë i suksesshëm dhe atij do t'i afrohen, hapen shumë zemra, mendje, shtëpi, rrugë dhe çdo vend, e cila kishte si model dhe udhëheqës të saj zotërinë tonë Muhamedin a.s., imamin dhe prijësin e kësaj thirrjeje madhështore.

Modeli i udhëheqjes së profetit Muhamed a.s. është shembull. Ishte ai, i cili e mbarti mbi supe (krahë) rëndësinë e thirrjes dhe ai e filloi këtë me shokët e tij fisnikë, që t'ua komunikojnë mesazhin e mirësisë dhe dashurisë me rrugën e udhëzimit, dritës e mëshirës dhe ky Profet fisnik e filloi thirrjen e tij të mbështetur në dy shtylla themelore:

Shtylla ku mbështetet është bashkëpunimi me popullin, të cilët janë të kënaqur me pasimin e tij dhe besimin në mesazhin e tij të ngritur mbi fjalën e Zotit xh.sh. “Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër,”² dhe “Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”.³

1. Kur'an, Enbija; 21:107.

2. Kur'an, Huxhurat; 49:10.

3. Kur'an, Al Imran; 3:159.

Shtylla e dytë mbi të cilën mbështetet Profeti a.s. ishte bashkëpunimi me ata të cilët e pranuan Islamin më vonë, si dhe me ata që nuk e pranuan Islamin dhe mbetën në fenë e tyre, ashtu siç deshën ata vetë. Ajo shtyllë ishte: “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”⁴ dhe “S'ka detyrim në fe.”⁵

Me këto dy shtylla madhështore Zoti xh.sh. ia mundësoi të hapë zemrat dhe mendjet e njerëzve.

Po ashtu, u mundësoi, u ofroi prijësve dhe thirrësve dyer të hapura krahë më krahë duke u mundësuar atyre të hyjnë nëpërmjet saj në rrugën për t'i shërbyer njerëzimit dhe të përhapnin mëshirën dhe dashurinë njerëzore... nëse veprojnë kështu ata dëshmojnë përkatësinë e tyre të shkollës së profetit të vet, udhëheqësit, liderit të tyre dhe ndjekës të rrugës, mësimëve dhe metodës së Tij.

Nga këtu shohim, kuptojmë se nuk i lejohet asnjë imami, thirrësi, dijetari, mendimtari, kërkuesi, studiuesi, gjykatësi, të gjykuari (dënuari), të bëjë diçka në kundërshtim me atë që ka vendosur, përcaktuar Imami i parë, Muhamedi a.s., dhe ta shpjegojë, komentojë traditën e tij të ndërtuar mbi themelet

4. Kur'an, Sebe; 34:28.

5. Kur'an, Bekare; 2:256.

e drejtësisë, mëshirës dhe dashurisë mes njerëzve, ashtu siç duhet dhe siç mendon ai se ajo është e drejtë dhe saktë.

Rrugë, thirrje e dukshme, e lartë dhe e qartë që e vendosi Profeti Muhamed a.s. mes nesh duke u mbështetur në këto dy shtylla të rëndësishme dhe ku nëpërmjet tyre duhet të fillojmë të lëvizim dhe të ruajmë situatat e ndryshme për gjendjet, kohët, vendet, me kusht që të mos zëvendësojmë mëshirën me egërsi (ashpërsi), vëllazërinë me armiqësi.

Kështu që, o imam të xhamive, mesxhideve..., o ju thirrës..., o kandila ndriçues në errësirën më të madhe, o dritë që shpërndahet, largon errësirën e zemrave dhe shpirtrave, kujtojeni gjithmonë Profetin tuaj, imamin tuaj të parë, Profetin Muhamed a.s. Kujtojeni shtyllën kryesore të tij në bashkëpunim me myslimanin: “Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër,”⁶ dhe siç e dini për këtë ajet (verset) ka shumë dispozita (shumë ligje), tek të cilat ndaluan ata që ishin para nesh dhe ata që jetojnë në kohën tonë dhe ndoshta për t’i numëruar dhe kufizuar këto nuk do të mjaftonte koha.

Kujtojeni fjalën e Zotit xh.sh. “... Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”⁷, kujtojeni këtë fjalim madhështor

6. Kur’an, Huxhurat; 49:10.

7. Kur’an, Ali Imran; 3:159.

dhe të lartë, sepse ai është një fjalim me qëllimin më të lartë nga aspekti i saktësisë, përpikërisë dhe ndjeshmërisë fjalim, mesazh për kë? Për Profetin a.s.?

Po, për Profetin a.s., i drejtohet atij me këtë mesazh, që ta mësojë çdo imam, thirrës e predikues, sepse rezultati (përfundimi) është i vështirë dhe i rrezikshëm ... “... ata do të largoheshin prej teje,”⁸. Cilët janë ata? Ata janë Hz. Ebu Bekri, Hz. Omeri, Hz. Othmani, Hz. Aliu dhe bashkëkohësit (sahabet) e tjerë.

Pra, thuajse ky mesazh kaq madhështor nga i Gjithëurti është për çdo thirrës, imam e predikues, për çdo kohë dhe vend. Nëse shokët e Profetit a.s., shokë të gjeneratës së artë, atyre u ngushtohet kraharori nga ata që bartnin neverinë, vrazhdësinë e fjalëve dhe ashpërsinë në metodë, atëherë si do jetë gjendja, çështja me ju?

Atëherë, ti, o imam, nuk je Profet dhe i informuari, ai komunikues dëgjuesi nuk është pasuesi (shok i Profetit), kujtojeni thënien e Profetit a.s.:

“Myslmani është vëlla i myslimanit, ai nuk i bën padrejtësi, nuk e tradhton, nuk e gënjen, nuk e ofendon, nuk e nënçmon.”

Po ashtu thotë Profeti a.s.:

“Çdo mysliman e ka të ndaluar gjakun, pasurinë dhe nderin e myslimanit tjetër.”

8. Kur’an, Ali Imran; 3:159.

Hadithi i Usame bin Zejd, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, Hadith të cilin e dini të gjithë:

- Na dërgoi i dërguari i Zotit te populli, fisi i Xhuhejnes, ku shkova te njëri prej tyre që ta godas (vras), sepse ai njëri tha: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut.” Dhe unë e godita (e vrava) e më pas shkova te Profeti a.s., ku e lajmërova për atë çfarë kisha bërë.

Profeti a.s. më tha:

- A e ke vvarë, ndërsa ai dëshmonte se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut?”

I thashë:

- O i dërguari i Allahut, ai e bëri këtë nga gënjeshtria, frika.

Ndërsa Profeti a.s. më pyeti:

- A ia ke zbuluar zemrën, a e di se çfarë kishte në zemër?

Ndërsa sipas një transmetimi tjetër, Ai ka thënë:

- E vrave pasi ai dëshmoi se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut?

Profeti a.s. aq shumë e përsëriste sa dëshirova që unë të mos isha bërë mysliman para asaj dite.

Ndërsa në një transmetim tjetër pyetet:

- Çfarë do të bësh kur të të dalë ditën e Kijametit, përpara, dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut?!

Kështu që, të dashur dhe nderuar vëllezër thirrës, ... mos i llogarisni, gjykoni njerëzit për të fshehtën që kanë në zemrat e tyre, që nuk e di askush përveç Allahut. Konsiderojini me madhështinë e

fjalës iman (besim), e cila shqiptohet nga gjuhët e tyre... i orientoni ata, i mësoni dhe i këshilloni ata... dhe mos u kërkoni llogari, tregohuni të durueshëm ndaj tyre, buzëqeshuni atyre, tregohuni të vendosur për t'i këshilluar dhe drejtuar vazhdimisht dhe mos i humbni shpresat nga ata.

Mos i humbni shpresat nga vonimi i përgjigjes prej tyre, prej pranimet të tyre dhe përfaqësimit të tyre të dobët. Zoti i Lartmadhëruar iu drejtua Profetit të Tij të nderuar dhe të gjithëve ne duke na thënë: “Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues!”, “dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!”⁹

Shpërblimet e thirrjes dhe kumtimit, me emër të Zotit nuk të shkojnë kot, nuk humbin, pa marrë parasysh se përgjigjet i ftuari apo nuk përgjigjet, pranon apo jo. Ty të takon t'u drejtohesh me rikujtim dhe kumtim, duke i këshilluar me atë që është më e mirë, ndërsa çështja e udhëzimit është në dorë të Allahut.

Kjo pjesë e përgjegjesisë së madhe që e mbart imami, këshilluesi dhe shumë detyra të tjera të thirrjes, ju bën përgjegjës dhe jo dikë tjetër nga njerëzit e zakonshëm. Ju jeni të detyruar të përhapni në shoqëritë tuaja bazat e nderit, dinjitetit, mëshirën profetike, mirësjelljen me njerëzit, qofshin ata myslimanë apo jomyslimanë në përshtatshmëri me mësimet e Kur'anit Famëlartë dhe traditës, rrugës së Profetit a.s.

9. Kur'an, Gashijeh; 88:21, 22.

Të gjithëve na takon ta rinovojmë besimin fetar sipas porosive të Profetit a.s., në rrugën e thirrjes dhe të mos devijojmë nga rruga, sjellja dhe vepra e Profetit a.s., sepse ai neve na e lehtësoi këtë, pastaj e mbështeti dhe e veçoi në dy çështje madhështore e të përgjithshme nga Krijuesi i tij i Lartmadhëruar; kështu që edhe neve na takon t'i përfaqësojmë këto dy çështje, duke iu përgjigjur me sjellje, përkushtim e veprim:

1. “dhe njerëzve u thoni fjalë të mira.”¹⁰. Këtu thotë “njerëzve” dhe nuk thotë myslimanëve.

2. “dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!”¹¹ Këtu, nëse fjala është “me kundërshtarët” pra jo me jomyslimanët, të polemizohet me atë që është më e mirë, atëherë si duhet të polemizojmë, diskutojmë me myslimanët?!

Kështu që, o ju të nderuar:

“Vërtet emanetin të cilin e mbart imami apo thirrësi, i takon që të jetë njeri që përgëzon e jo që largon (afrues dhe jo largues), dashurues e jo urryes, tolerant e jo i vrazhdë, i butë e jo i egër, i sjellshëm, i qeshur e jo i vrazhdë, thirrës e jo gjykatës, udhëheqës e jo sundues.”

Në paraqitjen dhe shpjegimin e rregullave kur'anore dijetari Omer El-Mukbil thotë:

“Prej zbatimit të praktikave të këtyre rregullave, dispozitave kur'anore, është ajo që Zoti xh.sh. i

10. Kur'an, Bekare; 2:83.

11. Kur'an, Nahl; 16:125.

lavdëroi robërit e Tij me fjalën e Tij:

“e kur atyre u drejtohen me fjalë injorantët, ata thonë: “Paqe!”

Po ashtu Ibn Xherir, Allahu e mëshiroftë, në lidhje me kuptimin e këtij verseti thotë:

“E kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata që nuk e besojnë dhe nuk e njohin Zotin, me fjalë fyese, urrejtje, ata u përgjigjen, ua kthejnë me fjalët më të mira, më të drejta, më të sakta.”

Në historinë tuaj të nderuar e të mirë, ka tregime, histori, ngjarje, rrëfenja dhe mësim të ndritshme, të dobishme, të cilat i mbushi dhe i plotësoi urtësia, toleranca, nderi dhe mëshira, t'i përcillni, transmetoni te njerëzit mbarë, t'i mësoni njerëzit dhe edukoni me këtë moral.

Imami është mësues, këshillues, rregullues, edukon mendje, ndërton shpirtira, kultivon mbjell vlera dhe moral të zgjedhur, kështu që puna, detyra e tij nuk është e kufizuar dhe për t'i drejtuar a udhëhequr njerëzit vetëm për namaz... Mirëpo ai është kontribuuesi, ndërtuesi i bashkimit dhe suksesit mes myslimanëve dhe asnjëherë nuk i lejohet imamit të drejtë, të singertë, të devotshëm dhe të pastër të qëndrojë para njerëzve, duke i konsideruar, etiketuar disa grupe të myslimanëve si jobesimtarë dhe duke i quajtur të tjerët si të prishur e dëmtues, ndërsa të tjerët duke i quajtur si tradhtarë, thuajse ai u përket bashkëkohësve të tij (shokëve të Profetit a.s.), ndërsa të tjerët janë të dalë nga feja.

Nuk i lejohet imamit në xhaminë, mesxhidin e tij, këshilluesit në predikimin e tij, për myftiun në detyrën e tij, që të jetë për ndjekësit e tij rrënues dhe shkatërrues. Pra imami është përfaqësues i profetit Muhamed a.s. Sikur të ishte prezent gjallë Profeti Muhamed a.s. askush nuk do të kishte guximin të qëndronte në minberin (foltoren) e tij apo në mihrabin e tij, asnjëherë!

Kështu që imami është për të gjithë, i pranor të gjithë me zemrën e tij, kur iu drejtohet me këshilla, urtësi dhe qetësi, pa asnjë të keqë dhe pa asnjë lëndim.

Profeti a.s. thotë:

“I tërë populli im është i falur”.

Ne jemi bashkësi e përgëzimit, e shpresës sepse nuk jemi bashkësi e dëshpërimit dhe pesimizmit, ... Të dashur, o ju që bartni flamurin e thirrjes, o ju që bartni dritën dhe ndriçimin, o imamë të xhamive, mesxhideve, o këshillues të njerëzimit dhe thirrjes, njerëzit janë amanet mbi supet tuaja, i afroni dhe mos i largoni, përgëzoni dhe mos i qortoni, drejtohuni nga njerëzit dhe mos ua ktheni shpinën, mos i braktisni, hapuani atyre zemrat dhe kraharorët, bëhuni rob të Zotit, që zemrat t'i nënshtrohen, përkulen Zotit të gjithësisë, që është Një, prej Tij kërkoni mirësinë dhe mëshirën... mos vendosni vetvetet tuaja tek ajo që nuk ndjeni, mos vendosni vetvetet tuaja në vend të Zotit që t'i gjykoni njerëzit me largim-dalje nga

feja, mosbesim, prishje e tradhti.

Kujtojeni dhe mos e harroni këtë Hadith... memorizojeni, mësojeni përmendësh dhe shkruajeni në fletoret, planet tuaja, në muret e shtëpive tuaja, shkruajeni në xhamitë tuaja.

Kujtojeni Hadithin e Kartës, Hadithin e identitetit, se ky është Hadith Sahih i vërtetë, nga Hadithi i Abdullah bin Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, se Profeti a.s. ka thënë: “Vërtet Allahu xh.sh. do ta shpëtojë, çlirojë një njeri nga bashkësia ime Ditën e Kijametit sipas drejtuesve të krijesave dhe atij do t'i shpërndahen e vijnë 99 regjistra (me vepra) dhe çdo regjistër është i gjatë aq sa sheh syri, ndërsa i thotë:

- A mos të kanë bërë padrejtësi engjëjt shkrues? Atëherë robi thotë:

- Jo, o Zot! I thotë Zoti:

- A ke ndonjë arsye, justifikim? Thotë robi:

- Jo, o Zot! Atëherë i thotë Zoti i madhërisëm:

- Po ti ke tek Ne një të mirë! Do t'i sillet Karta me shkrim e dëshminë: “S’ ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është rob dhe i dërguar i Tij.” Atëherë robi thotë:

- O Zot, çfarë vlere, rëndësie ka kjo Kartë përballë këtyre mëkateve?” I thotë Zoti xh.sh.:

- Më sill peshoren tënde, sepse sot nuk ka padrejtësi ndaj teje!

Vendosen të këqijat, pra vendosen regjistrat, veprat e tij në njëherë anë dhe në anën tjetër të

peshores vendoset Karta, atëherë lehtësohen të këqijat dhe në peshore rëndon, peshon Karta e mirësive, pa dyshim se asgjë nuk mund të peshojë më rëndë se emri i Allahut.

Kjo është një Kartë e vogël, në të nuk ka shumë punë, vepra si: agjërim, namaz, zekat, Haxh apo xhihad, por në kartë është dëshmia e pranimit se “nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”, ajo që e shpëtoi atë nga zjarri i fortë i Xhehenemit. Vërtet kjo është Karta e Imanit, e Njeshmërisë dhe Përkatësisë së Krijuesit Madhështor.

Karta e pohimit “nuk ka Zot tjetër përveç Allahut” e shpëton robin, të cilit nuk i ka mbetur më vend, me një fjalë ka bërë shumë mëkate dhe i kanë mbetur mangësi, karta “nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”, kush e thotë këtë në këtë botë është nën kujdesje, mbrojtje gjaku i tij, pasuria e tij dhe nderi i tij te Zoti dhe ne nuk pyesim si e tha, as pse e tha dhe kur e ka thënë, në çfarë kohe, momenti e ka thënë. Ne

vetëm e kujtojmë mësuësin tonë, imamin, prijësin tonë Muhamed a.s. kur thotë:

“A ja ke zbuluar zemrën, a ja ke lexuar zemrën se çfarë ka në të?”

Pra Karta “nuk ka Zot tjetër përveç Allahut” e shpëton robin nga zjarri më i fortë i Xhehenemit.

Mëshirojini të gjithë njerëzit, silluni me ta me mirësi sipas mësimëve, urdhrave të *Kur'anit Famëlartë* dhe mëshirës, traditës së Profetit tuaj nën sloganin: “Dhe Ne nuk të dërguam veçse mëshirë për të gjitha botët.”¹²

Duajini ata, bëhuni modestë me ta, silluni me modesti e thjeshtësi me ata që thonë:

“s’ka Zot tjetër përveç Allahut.” dhe mëshirojini e nderojini ata.

Përshtati nga arabishtja në shqip: **Veton N. TULLA**

12. Kur'an, Enbija; 21:107.

Garancitë Juridiko-Kushtetuese të të Drejtave të Bashkësive Fetare në Shqipëri

Dr. Saimir Shatku,
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Përpyekja për të hedhur dritë, mbi rrugëtimin e deritanishëm, disavjeçar, të të drejtave të bashkësive fetare, raporteve e marrëdhënieve midis shtetit dhe fesë e institucioneve të saj, në fushën e lirive dhe të drejtave të saj publike e private, është një angazhim modest, që të mundëson të shohësh përmes retrospektivës horizontin e ri të së ardhmes së tyre, mbi fitimin, gëzimin, dhe përdorimin e këtyre të mirave private.

Dokumentet historike argumentojnë faktin se, që në aktet e para kushtetuese të pavarësisë shqiptare, është afirmuar parimi i ndarjes së fesë nga shteti, i lirisë së ndërgjegjes dhe besimit, si dhe të drejtës së ushtrimit të saj, duke përfshirë dhe të drejtat reale që Komunitetet fetare gëzojnë, të sanksionuara këto në “Statutin Organik të Shqipërisë”. Gjatë harkut kohor të viteve 1920-1939, politika e shtetit shqiptar, synoi vendosjen e parimeve të reja juridiko-private me karakter kombëtar për veprimtarinë e institucioneve fetare, ajo kishte për qëllim shpëputjen e lidhjeve të vartësisë dhe të influencës së huaj ndaj tyre, duke mbështetur në këtë mënyrë interesat e unitetit kombëtar dhe mënjannuar përçarjen fetare.

Raporti i lirive dhe të drejtave të besimit, gjatë regjimit komunist, është një histori e politikës ateiste, persekutuese, denigruese dhe mohuese ndaj fesë, klerit dhe institucioneve fetare. Kushtetuta e vitit 1976 sanksionoi përfundimisht parimin e ateizmit/mosbesimit, duke e shpallur Shqipërinë të vetmin shtet ateist në botë. Kësisoj nuk mund të flitej për të drejta pronësie dhe përfitime të tjera reale për llogari të institucioneve fetare.

Zhvillimet demokratike në vend rivendosën lirinë e fesë dhe të drejtën e besimit, duke ridimensionuar raportin e marrëdhënieve midis shtetit dhe fesë, në kontekstin e parimeve të

shtetit të së drejtës. Përgjatë këtij rrugëtimi disa veçorë edhe e drejta e pronësisë, mënyrat e fitimit të saj, transferimi i këtyre të drejtave ka ardhur duke u zgjeruar juridikisht, por dhe duke rritur juridikisht raportin midis shtetit dhe fesë (Kujtojmë këtu marrëveshjet ndërfitetare të realizuara mes Shtetit Shqiptar dhe 4 Bashkësive fetare tradicionale në Shqipëri, në shkurt të 2007). Gjatë kësaj periudhe tranzicioni, institucionet fetare janë riorganizuar, liria e ndërgjegjes dhe e besimit është riafirmuar sipas standardeve ndërkombëtare në kushtetutën e vitit 1998, por edhe sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Shqipëria, vendi i tolerancës, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfitetare (sibih neni 3 i Kushtetutës së Shqipërisë) është një vend që i ka njohur, por edhe po i harmonizon akoma më gjerë, në bashkëpunimin në të mirë të komunitetit njerëzor, këto raporte në fushën e pronësisë dhe iniciativës së lirë ekonomike.

Fjale kyçe: tranzicion; të drejta reale të bashkësive fetare; raporte juridiko-private, konkordate; statute; ligje organike; marrëveshje shtet-religjion.

PERIUDHA 1912 - 1920 Shpallja e pavarësisë dhe uniteti rreth çështjes kombëtare

Akti i shpalljes së pavarësisë dhe krijimi i shtetit të ri shqiptar, shënoi edhe krijimin e një sistemi të ri politik të mbështetur në programet e rilindësve kombëtarë, të ideologëve, diplomatëve, shkrimtarëve, si dhe në kontributet e klerikëve të besimeve të ndryshme, të cilët ishin të bashkuar me zërin e kombit dhe të shqiptarit për përmbushjen e idealeve të tyre¹.

Kuvendi i Vlorës zë një vend të një rëndësie të veçantë në memorien historike të kombit shqiptar, sepse, sipas studiuesit A. Luarasi, ai

“përfaqësonte efektivisht vullnetin e gjithë kombit dhe u bë organi më i lartë i shtetit shqiptar, mbajtësi dhe shprehësi i sovranitetit shtetëror. Prandaj vendimet e tij kishin vlerën e ligjeve kushtetuese...”² Ai mori vendime të rëndësishme, që sanksionuan vullnetin e popullit shqiptar për shkëputje nga perandoria osmane, krijoi strukturat dhe institucionet e para, të cilat për nga mënyra e formimit, kompetencat dhe aktiviteti, hodhën bazat e institucioneve politike e kushtetuese të shtetit të ri. Gjatë periudhës pas vitit 1912 klerikët atdhetarë, me aktivitetin patriotik që kryen, e radhitën veten midis personaliteteve politike e shoqërore dhe luftëtarëve të lëvizjes kombëtare.

Siç pritej, komunitetet fetare do të kishin një peshë të rëndësishme,

1. Bartel, Peter, “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)”, Dituria, Tiranë 2006.

2. Luarasi, Aleks, “Çështje të historisë dhe të shtetit të së drejtës”, Tiranë 1999.

në periudhën e shpalljes së Pavarësisë. Në aktet e krijimit të shtetit të ri morën pjesë një sërë personalitetesh të tre besimeve fetare. Secili komunitet u përfaqësua edhe në qeveri e senat. Ndër këto vendime të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, ishin edhe zgjedhja e senatit, kryetar i të cilit u zgjodh kryemyftiu i Shqipërisë, Vehbi Dibra (nënshkrues i dokumentit të pavarësisë) dhe zëvendës i tij një ortodoks. Formimi i qeverisë, gjithashtu, mbi bazën e përfaqësimit krahinor dhe fetar do të reflektonte një ndarje të barabartë midis ministrave; myslimanë dhe atyre të krishterë³. Në përmbushje të këtij kriteri zv/ kryeministër i qeverisë së drejtuar nga Ismail Qemali u zgjodh përfaqësuesi i komunitetit katolik Nikollë Kaçorri (nënshkrues i dokumentit të pavarësisë).

Këto raporte u reflektuan edhe në delegacionet ndërkombëtare dhe në nivele të tjera të përfaqësimit shtetëror.

Legjislacioni i ri i shtetit shqiptar

Qeveria e Vlorës, u angazhua shumë për hartimin e legjislacionit të ri të shtetit shqiptar: ajo hartoi ligje, për krijimin e bërthamës së sistemit të ri të drejtësisë dhe të administrimit. Ligjet më të rëndësishme, të qeverisë së Vlorës, ishin: “Kanuni i Zhurisë” (5 maj 1913) dhe “Kanuni

i Përshtatshëm i Administratës Civile” (22 nëntor 1913), dy ligje që përbëjnë aktet e para në organizimin e sistemit gjyqësor dhe organizimin administrativ të shtetit të ri shqiptar .

“**Kanuni i Zhurisë**” ishte vendimi i parë i rëndësishëm i Qeverisë së Vlorës, në drejtim të organizimit të sistemit gjyqësor përmes të cilit urdhërohej bashkimi i çështjeve civile me ato penale, “*suprimimi i kadillarëvet dhe shikimin e padiravet fetare nga ana e myftilerëve; emërimin e një myftiu në çdo nënprefekturë me rrogë 1200 grosh e ndër prefektura me nga 1800 grosh...*” Sipas këtij urdhri, “*vendimet e gjyqeve të Sherisë të shkruben në gjubën arabe. Myftitë do të viben në provim prej hirësisë së Tij Vehbi Efendiut, Shebulislam të Shqipërisë dhe funksionimi i tyre do të dekretohet prej tij.*”⁴

Në këtë mënyrë del në pah se, Vehbi Dibra, i cilësuar si “Shehislami i Shqipërisë”, autoriteti me i lartë fetar i Shqipërisë, ishte i ngarkuar për të ndërmarrë këtë reformë strukturore në sistemin gjyqësor. Ky akt do të shënonte, nga njëra anë një arritje të madhe në krijimin e pushtetit gjyqësor, pasi në dallim nga modeli osman, ai sanksiononte ngritjen e gjykatave të pavarura, duke ua hequr organeve administrative të drejtën e dhënies së drejtësisë. Dhe, nga ana tjetër, do të shënonte vendosjen e gurit themeltar, të nismës për shkëputjen e Bashkësisë Islame të

3. Nosi, Lef, “Dokumente historike 1912-1920”, Tiranë 2008.

4. Grup autorësh “Historia e shtetit të së drejtës në Shqipëri”, Tiranë 2006.

Shqipërisë, ende të pathemeluar, nga Khalifati i Stambollit dhe Shehislami i tij, ky fakt publikohet edhe në një lajm të botuar në gazetën “Dielli” organ i Shoqërisë “Vatra” të Amerikës në numrin e saj 247, datë 23 shtator 1913, e në një korrespondencë të saj nga Vlora bënte fjale për ndryshimet që ishin bërë në qeveri ku ndër të tjera njoftohet se “Vehbi Dibra, i cili ishte president i Senatit, u bë kryetar i Muhamedanëve (myslimanëve) dhe vendin e tij e zuri z. Ekrem Vlora”⁵. Dihet se postin e Kryemyftiut të Përgjithshëm ai e kishte edhe në kohën kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë, por tani ai lirohet nga detyra e presidentit të Senatit për t’iu kushtuar tërësisht organizimit administrativ të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, një akt ky që do të finalizohet 10 vjet më vonë.

“Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile” ishte një tjetër akt me karakter kushtetues, i ndërmarrë nga Qeveria e Vlorës. Qëllimi i tij ishte të rregullojë administrimin lokal, të bëjë ndarjen e re administrative, dhe të përcaktojë kompetencat e autoriteteve vendore.

Mbi bazën e tij, vendi do të ndahej në prefektura, nënprefektura, krahina dhe fshatra, me një rol të rëndësishëm mbikëqyrës dhe drejtues të Ministrisë së Punëve të brendshme. Prefekti do të kishte një peshë të

veçantë në vendimmarrje, ndërsa në nivel nënprefekturash, do të drejtonte nënprefekti dhe një këshill i veçantë edhe me përfaqësues të komuniteteve fetare.

Gjithashtu, ky kanun konsiderohet dokumenti i vetëm zyrtar, mbi nocionet e proceseve zgjedhore i trashëguar nga Qeveria e Vlorës. Në një kapitull të veçantë mbi zgjedhjet, paraqiten detajet e organizimit të procesit zgjedhor në prefektura dhe krahina, të drejtat për të votuar, për të kandiduar dhe për t’u zgjedhur. Në nenin 68 përcaktohen të drejtat civile e politike, ku përmendet se “të drejtë votimi të veçantë kanë fetarët, mësuesit, mjekët, gjykatësit, nëpunësit e administratës, etj.”. Kështu, ndër të tjera, ky kanun përbënte një bazë të mirëfilltë ligjore, për garantimin e funksionimit të një sistemi zgjedhor⁶.

Periudha e Princ Widit

Sistemi politik, i vendosur në dhjetor 1912 në Shqipëri, do të ndryshonte 8 muaj më pas, më 29 korrik 1913, kur përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, morën vendimin e rëndësishëm të njohjes së të drejtës së shqiptarëve, për të pasur shtet të paanshëm dhe neutral. Sipas këtij vendimi, Shqipëria do të shpallej principatë, me një formë regjimi

5. Basha, Ali, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”, Tiranë 2000, f. 76-78.

6. Krasniqi, A., “Sistemet politike në Shqipëri (1912-2008)” Tiranë 2009, f. 28- 30.

monarki kushtetuese, dhe në krye të saj të emërohet një princ evropian. Forma e re e shtetit do të përcaktohej “nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha”⁷. Patriotët shqiptarë u pajtuan plotësisht me propozimin e Fuqive të Mëdha, për një princ të huaj, princ Vidin, të cilin e propozoi Austro-Hungaria dhe Italia. Të dëshpëruar nga anarkia që kishte mbuluar vendin dhe të shqetësuar për fatin e atdheut, ata mendonin se princi do ta bashkonte Shqipërinë, do ta shpëtonte atë nga rreziku i copëtimit.

Asambleja Kombëtare ishte organi i dytë më i rëndësishëm i krijuar nga Konferenca e Londrës dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ajo zëvendësoi modelin e Kuvendit Kombëtar të krijuar më 1912-ën, ndërkohë që sistemi i ri politik nuk përfshiu ngritjen dhe funksionimin e Senatit. Kompetencat kryesore të Asamblesë Kombëtare, rregullat e zgjedhjes dhe të funksionimit, u përcaktuan me “Statusin Organik të Shqipërisë” të hartuar nga KNK-ja dhe të miratuar me 10 prill 1914. Sipas tij Asambleja Kombëtare ishte organi ligjvënës i Principatës. Ajo përbëhej nga 36 anëtarë të ndarë për shkak të detyrës: 21 anëtarë zgjedhur me votim indirekt dhe 10 anëtarë të emëruar nga Princi. Anëtarë për shkak të detyrës ishin 4 përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe komisar i lartë shqiptar pranë Bankës Kombëtare⁸.

Statusi Organik i Shqipërisë, liritë dhe të drejtat e besimit dhe pozita e komuniteteve fetare (1914).

“Statusi Organik” përbën kushtetutën e Monarkisë së Parë Shqiptare i formuluar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ai përbëhej nga 216 nene të ndarë në kapituj. **Feja trajtohet në nenet 170-177.** Për shkak të nevojës për forcimin e natyrës harmonike midis komuniteteve fetare në Shqipëri, hartuesit e tij i kushtuan fesë dhe raporteve me shtetin, një rëndësi të veçantë. Kështu, “Statuti Organik” sanksiononte se “*Shqipëria-nuk ka fe shtetërore. Liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t’i vibet asnjëriu si shkak për të përjashtuar ose për të cilësuar si të paafte për sa i përket gëzimit të së drejtave civile e politike, pranimin në punë shtetërore, në funksione dhe ndere ose për sa i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme*”⁹.

Në këtë dispozitë, mund të dallojmë se liria e fesë, si liri themelore e shtetasve, jo vetëm shihet e lidhur ngushtë me parimin e asnjësisë së shtetit ndaj saj, por formulohet në të njëjtën dispozitë kushtetuese, si një e tërë me të. Kështu, për herë të parë, statuti sanksionoi me ligj lirinë fetare dhe mohimin e një feje

7. Po aty, 37- 39.

8. Po aty, 54- 56.

9. Della Roka, Roberto Maroco, “Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 – 1944”, 1999, f. 32.

shtetërore, duke eliminuar mundësinë e konflikteve fetare midis shqiptarëve; dhe pa dyshim që ka qenë arritja më e madhe në drejtëm të paqes sociale midis shqiptarëve të pa mësuar në një bashkësi politike më vete.

Statuti i njëjtte të drejtën komuniteteve fetare të ruajnë pasuritë e tyre (neni 170) “Komunitetet fetare në Shqipëri ruajnë pronat e tyre”; (neni 171) të vazhdojnë të marrin, nën mbrojtjen e autoriteteve, të ardhurat e konsakruara nga zakoni; (neni 172) të përjashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për vepra bamirësie; (neni 174) në raste të formimit të komuniteteve të reja fetare, Shteti rezervon të drejtën e njohjes dhe të përcaktimit të të drejtave të tyre. Megjithëse ligji detyronte mësimin shqip në shkolla, në rastin e shkollave fetare lejohej mësimi në gjuhën e kultit. Neni 175 i njeh Princit të drejtën të japë miratimin për klerikët dhe parinë e të gjitha komuniteteve fetare të njohura prej shtetit “Hirësit dhe dinjitozët e të gjithë komuniteteve fetare të njohura nga Shteti, do të marrin veshjen me autoritet të madhërisë së tij Princit”.

Ndërkohë, Statuti theksonte se rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të bëhej me marrëveshjeve të posaçme midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve (neni 176). Një element i rëndësishëm i rolit aktiv të shtetit në promovimin e trashëgimisë

dhe identitetit të komuniteteve fetare ishte detyrimi i shtetit për të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura si dhe të klerit, duke caktuar për këtë qëllim shumën, që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror. (neni 177) “I përket Shtetit të ndërmarrë masat për mirëmbajtjen e të gjithë kulteve të njohura nga ai si edhe të fiksojë një shumë, që gjykohet e nevojshme, në buxhetin e përgjithshëm të Shtetit, i cili do të marrë parasysh pronat aktuale të paluajtshme, që u përkasin këtyre kulteve”

PERIUDHA 1920- 1939

“Zgjerimi i Statusit të Lushnjës (1922) - Dokument kushtetues”

Një nga vendimet më të rëndësishme të parlamentit të ri, ishte hartimi dhe miratimi i “Zgjerimi i Statusit të Lushnjës”(1922), dokument me vlera të veçanta historike dhe kushtetuese. Për vlerat e tij, ai njihet gjerësisht si “Statusi i shtetit shqiptar”. Statusi dominohej nga fryma evropiane dhe demokratike e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit, e natyrës parlamentare dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut. Në të riafirmohej forma monarkiste e qeverisjes, edhe Këshilli i Naltë vijonte të ishte me katër anëtarë nga secili besim fetar, me mandat dyvjeçar dhe zgjedhje nga parlamenti.

Statusi parashikonte të drejta civile dhe politike për qytetarët, si dhe deklarimin se në “Shqipëri nuk njihet fe zyrtare”¹⁰. Në tërësi ndryshimet kushtetuese të vitit 1922 shënuan një ngjarje të rëndësishme në organizimin dhe modernizimin e shtetit të ri shqiptar. Ndërkohë që sistemi zgjedhor mbeti i njëjtë me atë të vitit 1921, në ligjin për organizimin e zgjedhjeve, ndër të tjera, theksohej se në shpalljen e deputetëve merrej parasysh edhe raporti fetar.

Kodi penal dhe Kodi civil

Studiues të huaj vërejnë se mbreti Zog arriti të vinte ligjin dhe rregullin në një vend që nuk i kishte njohur fare ato. Më 8 janar 1928 hyri në fuqi Kodi Penal i hartuar sipas modelit të Kodit Penal Italian të vitit 1889. Reforma legjislative u thellua me hyrjen në fuqi të Kodit Civil më 1 prill 1929. Ky kod u bazua në modelet perëndimore të kodit francez, italian, zviceran, gjerman, bashkë me ndonjë normë të marrë nga zakonet juridike shqiptare dhe nga ligjet egjiptiane në fushën e Vakëfit¹¹. Në përbërjen e këtij komisioni ligj-përgatitës ishin një grup juristësh të përgatitur me kulturë juridike kryesisht në Turqi e në perëndim si: Mehdi bej Frashëri, Thoma Orollogaj, Faik Shatku dhe Agjah Libohova; Këta

10. Luarasi, Aleks, “Çështje të historisë dhe të shtetit të së drejtës”, Tiranë 1999, f. 94-101

11. Della Roka, Roberto Marocco, Tiranë 1994, f. 31.

konsideroheshin si njohësit më të mirë të jurisprudencës bashkëkohore krahasuese dhe të jurisprudencës evropiane në fuqi. Kështu, statusi laik zëvendëson statusin fetar, ku bazohej juridiksioni i kishave si dhe ai i Islamit, në veçanti, në sektorë të gjerë të jetës shoqërore familjare, në përgjithësi.

Një nga pasojat kryesore të këtij Kodi ishte ndarja e fesë nga drejtësia dhe shkrirja e gjykatave fetare të trashëguara nga periudha e Perandorisë Osmane¹².

Në kuadër të këtyre masave, herë-herë ligjore apo nënligjore dhe herë të tjera administrative, mund të përmendim p.sh. futjen e martesës civile, vendosjen e institucionit të gjendjes civile, disiplinën dhe kufizimin ligjor të divorcit, shfuqizimin e kremtimit të festës së ditës së premtë, tentativën dhe inkurajimin që bëhej për kundërvënien apo përcarje ndërmjet besimtarëve myslimanë, duke krijuar në gjirin e tyre komunitete e shoqëri fetare, qoftë edhe kulturore të pavarura, disa nga anëtarët e të cilave, në mënyrë të kamufluar, do të ishin në opozitë për “çështje të dogmës” me shumicën e popullsisë sunite. Po kështu martesa civile u bë e detyrueshme dhe nuk u njohën efektet juridike të asaj fetare. U ndalua poligamia, megjithëse në kuptimin e vet të mirëfilltë ajo pothuajse nuk kishte hyrë fare në Shqipëri, por ishte e

12. Fischer, Bernd, “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë, 1996.

shfaqur kryesisht si bigami dhe rrallë. U lejua shkurorezimi i bashkëshortëve, duke u njohur e drejtë si për burrin ashtu dhe për gruan¹³.

Por, Kodi Civil do të haste në kundërshtim të fortë, si në planin e brendshëm ashtu edhe në të jashtëm. Vatikani e kundërshtoi me forcë ligjin e ri dhe refuzoi të nënshkruante një konkordat me Shqipërinë, nëse do të sanksionohej me ligj divorci, por Zogu u përgjigj se nuk do të lejonte krijimin e partive opozitare në vend dhe njoftoi arqipeshkvin e Shkodrës se çdo prift, entuziazmi i të cilit për mbrojtjen e vendimit të Vatikanit do t'i kapërcente kufijtë, do të dënohej konform ligjeve në fuqi¹⁴.

Ligji mbi komunitetet fetare

Ky ishte njëri nga ligjet kryesore, që u miratua nga parlamenti më 16 korrik 1929, ndaj të cilit pati reagime të ashpra nga disa komunitete fetare, veçanërisht ai katolik, ndërsa komuniteti ortodoks, megjithëse u prek prej ligjit, nga shkak i ndodhive të turbullta, që po zhvilloheshin në ato kohë brenda kishës së tyre, e pranoi ligjin. Nëpërmjet këtij ligji u shpall liria e ndërgjegjes dhe e fesë si dhe garantimi i saj.

13. Musaj, Fatmira, "Gruaja në Shqipëri 1912-1939", Akademia e shkencave, Tiranë 2002, f. 138.

14. Fischer, Bernd, "Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri", Tiranë 2004, f. 116.

Ministria e Drejtësisë, me projektin e përgatitur, ka ndaluar komunitetet fetare të merren me politikë dhe të ushtrojnë të drejta gjykimi (neni 3), gjë e cila ju është rregulluar me Statutin Themeltar e me ligjet e reja. Statutet e komuniteteve fetare, të hartuara dhe të aprovuara në bazë të këtij projekti, formojnë detyrim ligjor për komunitetin që i përkasin (neni 5).

Kryetarët dhe paria e komuniteteve, duhet të jenë shqiptarë prej race, gjuhe dhe të kenë fituar shtetësinë shqiptare; të mos jenë të njohur si antikombëtarë dhe të kenë mbushë të paktën 25 vjeç (neni 7)¹⁵.

Sipas ligjit, statutet e komuniteteve fetare duhet të miratoheshin, së pari nga qeveria dhe më pas do të dekretoheshin nga sovrani. Po e njëjta procedurë do të ndiqej edhe me titullarët drejtues të komuniteteve, të cilët duhet të ishin me shtetësi shqiptare dhe të njihnin mirë gjuhën shqipe. Buxheti i komuniteteve fetare miratohej, gjithashtu, nga qeveria, e cila kishte të drejtë të kontrollonte gjendjen e pasurive dhe të ardhurave të tyre. Komuniteteve fetare u ndalohej marrja e ndihmave (subvencioneve) nga shtetet e huaja dhe kjo ndihmë mund të lejohej vetëm pasi të vërtetohej se kishte vetëm qëllime filantropike, gjithnjë pasi të miratoheshin nga qeveria¹⁶.

15. AQSH Fondi 155, viti 1931 dosja VIII-136. Dekret ligji është botuar ne gazetën zyrtare nr. 38 e martë 16 korrik 1929.

16. Po aty.

Komunitetet fetare, mund të merrnin leje nga qeveria për të hapur shkolla fetare, me kusht që, në programet e shkollave që do të lejoheshin të hapeshin, të kishte lëndë apo tema mësimore që do t'i shërbenin edukimit atdhetar të besimtarëve. Dhe, së fundi, renditet lejimi i përdorimit të uniformës fetare vetëm për funksionarët zyrtarë të besimit.

Në këtë studim, u morën vetëm disa nga nenet e këtij ligji, i cili, sikurse u evidentua, hapi rrugën për masa të tjera ndaj besimeve fetare, veçanërisht ndaj fesë islame. Sikurse shkruan studiuesi R. Morozzo della Rocca “komuniteti mysliman u prek më rëndë nga ligji dhe ndaj atij komuniteti u tregua kujdes që të adoptohej mirë”¹⁷.

Përfundime dhe konkluzione

Raportet e marrëdhënieve shtetfe, në secilën prej sistemeve politike dhe qeverisëse, kanë zënë një vend të rëndësishëm gjatë gjithë rrjedhës historike, që nga momenti i krijimit të shtetit shqiptar e deri në ditët e sotme. Në dy etapat e para, ato të themelimit dhe forcimit të shtetit shqiptar (1912 dhe 1920-25) raportet fetare patën një rëndësi të veçantë. Kriteri fetar u respektua në zgjedhjen e një sërë institucionesh, përfshirë edhe Senatin, Këshillin e Lartë dhe qeveritë. Një

17. Della Rocca, Roberto Maroco, Tiranë 1994, f. 94.

tjetër karakteristikë e dokumenteve kushtetuese dhe e sistemeve politike, në raport me besimet fetare, ishte përfshirja e dukshme në jetën politike dhe vendimmarrje e figurave fetare. Edhe në zgjedhjen e parlamentit 1921 dhe 1923, u aplikuan forma të ndarjes konsensuale e paraprahe të numrit të mandateve parlamentare mbi bazën e raporteve fetare.

Një nga reformat më të rëndësishme të shtetit të ri ishte edhe sanksionimi i parimit të laicitetit të shtetit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të besimit (periudha 1914-1920). Stadi i dytë, respektivisht në Statutin e vitit 1922 dhe në aktet e tjera të mëvonshme kushtetuese, do të sanksiononte ndalimin e përdorimit të fesë për qëllime politike, ndarjen e komuniteteve fetare nga jeta politike dhe themelimin e institucioneve fetare mbi baza kombëtare shqiptare. Kështu, gjatë harkut kohor të viteve 1921-1923, edhe me mbështetjen shtetërore, u organizuan kongreset e tre komuniteteve fetare, (mysliman, ortodoks dhe bektashi) për mëvetësimin e tyre nga qendrat e huaja jashtë Shqipërisë.

Vihet re, gjithashtu, se legjislacioni i periudhës së monarkistë sanksionoi parimet e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit fetar, laicitetit të shtetit, kontrollit shtetëror mbi komunitetet fetare si garanci e ndalimit të hapësirave për përçarje fetare. Në këtë mënyrë, të gjithë krerët e komuniteteve fetare emëroheshin

me dekret mbretëror, funksionarët e lartë duhet të ishin shtetas shqiptarë, kufizohet marrja e ndihmës së huaj, statutet e komuniteteve fetare duhet të miratoheshin nga qeveria, duke realizuar, për rrjedhojë, edhe ndalimin e ndikimit të jashtëm ndaj tyre.

Politika e ndjekur gjatë regjimit komunist ishte ajo e kontrollit politik, indoktrinimit të gjithanshëm ateist, persekutimit si dhe ajo e fushatës frontale e komplekse të luftës kundër fesë, klerit e institucioneve fetare. Kushtetuta e vitit 1976 do të sanksiononte përfundimisht se *“shteti nuk njeht asnjë fe dhe përkrab e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor”*, duke e shpallur Shqipërinë të vetmin shtet ateist në botë.

Me rënien e sistemit komunist dhe krijimin e sistemit demokratik shumëpartiak, në vitin 1991, shteti njohu legjitimitetin e komuniteteve fetare dhe mbështeti ringritjen e tyre. Në dokumentet themelore të shtetit të ri demokratik, u sanksionua fakti se shteti nuk ka fe zyrtare dhe se liria e besimit dhe e ndërgjegjes është e garantuar dhe e mbrojtur. Kështu dokumenti më i rëndësishëm ligjor ishin *“Dispozitat Kryesore Kushtetuese”* të vitit 1991. Në nenin 7 të tyre theksohej laiciteti i shtetit shqiptar dhe detyrimi që shteti të respektojë *“lirinë e besimit fetar”* dhe të krijojë *“kushte për ushtrimin e tij”*. Komunitetet fetare u ringritën, u ndërtuan objekte të shumta fetare

dhe lindi një marrëdhënie e re midis shtetit e këtyre komuniteteve.

Në dallim nga koha e pavarësisë dhe më pas e forcimit të shtetit, në periudhën e sotme të sistemit demokratik, komunitetet fetare nuk angazhohen në jetën politike.

Në kushtetutën e vitit 1998 iu kushtua një vëmendje e veçantë parimit të laicitetit të fesë dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të besimit, si dhe pozitive të bashkësive fetare për të qenë persona juridikë, si dhe pavarësinë e plotë të tyre në raportin e marrëdhënieve të tyre me shtetin.

Janë ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësive Fetare për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella në vitin 2007. Por në këtë periudhë të tranzicionit të tejzgjatur kanë mbetur ende pa u hedhur hapa të rëndësishëm në respektim të parimeve të shtetit të së drejtës dhe konsolidimit të një tradite vlerash demokratike.

Shqipëria, gjatë kësaj periudhë 100 vjeçare, është karakterizuar nga mungesa e stabilitetit të qëndrueshëm politik, ndryshimi i sistemeve politike e qeverisëse dhe i dokumenteve kushtetuese. Këto janë argumente që tregojnë për brishtësinë e shtetit të së drejtës, mungesën e një tradite të kulturës demokratike. Në këtë kontekst edhe raportet e marrëdhënieve shtet-fe

në çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk kanë qenë konstante dhe të harmonizuara me respektimin e parimeve të laicitetit.

Në shtetin e së drejtës, laiciteti i shtetit, në çështjet e ndërgjegjes dhe të fesë, është dhe mbetet parimi demokratik, që garanton që të ekzistojnë së bashku të gjithë ato komponentë që nuk cenojnë parimin themelor, lirinë e përbashkët. Ndërtimi i tij është një produkt i angazhimit qytetar. Ai nuk përfaqëson vetëm një kontribut të institucioneve shtetërore, por edhe një kontribut të të gjithë aktorëve në vend, duke përfshirë individët, shoqërinë civile dhe komunitetet fetare. Nëse feja nuk e bën ligjin pronë shpirtërore të njerëzve, ligji mund të vazhdojë të ekzistojë, por vetëm si një akt i huaj për ndërgjegjen.

Porositë e fesë përfshijnë respektimin për rregullimin dhe harmoninë në mes njerëzve, ndëshkimin e veseve dhe të mëkateve, ku ndër të tjera hyjnë cenimet e paqes dhe të qetësisë në shoqëri. Feja ka parimet e veta, ka detyrat që ka qytetari ndaj ligjeve, të cilët mund

të aplikohen duke i interpretuar në gjuhën fetare¹⁸.

Por edhe ligji duhet të bëjë për fenë, jo vetëm për të garantuar lirinë e ushtrimit të saj nga çdo individ besimtar, por edhe si institucion. Nuk mund të imagjinohet zbatimi i një ligji, kur bindjet fetare e kanë minuar atë. Shteti është i interesuari i parë për këtë marrëveshje. Komunitetet fetare nuk janë nën shtetin, por krahas tij. Në demokracinë e sotme të gjithë janë nën të drejtën, që është, në radhë të parë, tërësia e të drejtave themelore të individit. Shteti është i së drejtës, ndërsa e drejta s'është vetëm e shtetit, por e të gjithëve.

Shqipëria vendi i tolerancës, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërjetare është ende në provë, në sfidën e saj për të garantuar respektimin, funksionimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe sistemin e vlerave të tij, në fushën e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

18. Traja, Kristaq, "Feja dhe e drejta si komponentë të rendit social" Konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2003.

Literatura e shfrytëzuar

“Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare”, Botime Zyra e Shtypit e Oborrit Mbretëror, Tiranë, 1997.

Shahu, Ajet, “Marrëdhëniet e shtetit komunist me fenë islame në Shqipëri” (1945- 1967).

Anastasi, A., “Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri, 1912-1939”, Tiranë, 1998.

AQSH. Fondi 71. Dosja 71; AQSH. Fondi 482, viti 1923.

Fischer, Bernd J., “Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri”, përktheu Krenar Hajderi, bot. III, Tiranë 2004.

Delvina, Sherif, “Pa pavarësi fetare nuk ka pavarësi kombëtare”, Tiranë 1998.

Jacques, Edwin, “Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme”, Tiranë 1995.

Vlora, Eqrem Bej, “Kujtime 1885-1925”, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë 2003.

Fletorja zyrtare nr 7, 4 shkurt, Tiranë, 2009.

Grup autorësh “Historia e shtetit të së drejtës në Shqipëri”, Tiranë 2006.

Grup autorësh “Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve”, Prizren 2001.

Grup autorësh “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2011.

Naska, Kaliopi, “Këshilli Kombëtar 1920”, Tiranë 2000.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Tiranë, 1946.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1976.

Kushtetuta e Shqipërisë, Tiranë 1998.

Nosi, Lef, “Dokumente historike 1912-1920”, Tiranë 2008.

Musaj, Fatmira, “Gruaja në Shqipëri 1912-1939”, Akademia e shkencave, Tiranë 2002.

Omari, L., Tiranë 1994, f. 32 (Zogu 117)

Puto, A., “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të Mëdha”, Tiranë 1978.

Della Rocca, Roberto M., “Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944”, përktheu Salleo Ferdinando. “Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri”, përktheu Virgjil Muçi, 2003.

Swire, Joseph, “Ngritja e një mbretërie”, përktheu Kujtim Ymeri, Shtëpia botuese Dituria; Tiranë 2005.

Delvina, Sherif, “Mbreti Zog I dhe komunitetet fetare”, Tiranë 2004.

Hysi, Shyqyri, “Historia e komuniteteve fetare në Shqipëri”, Tiranë 2008.

Traja, K., “Feja dhe e drejta si komponentë të rendit social”, Konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor, 2003.

Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909) Syrja bej Vlora

Dr. Hasan Bello

Abstrakt

Libri i Syrja bej Vlorës “Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909)” është një punim enciklopedik me vlera të padiskutueshme për historiografinë shqiptare. Kjo për faktin se: e para, përbën përpjekjen e parë në këtë drejtim, në një kohë kur institucionet tona shkencore nuk ishin themeluar ende, e dyta, informacioni që ofrohet për disa personalitete historike përbën një risi.

Në një shënim të faqes një të dorëshkrimit shqip të këtyre biografive, përkthyesi Jonuz Tafilaj shkruan se ato janë përgatitur si aneks i veprës së Syrja bej Vlorës të përkthyer më parë nga Ali Asllani.¹ Megjithatë, për nga volumi i tyre, këto biografi përbëjnë një libër më vete. Prandaj, duke pasur parasysh se ato nuk janë integruar më parë në asnjë version të librit tashmë të botuar të Syrja bej Vlorës, e sjellim për botim për herë të parë në revistën shkencore “Zani i Naltë”.

Ky dorëshkrim është shkruar në gjuhën osmane dhe, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe, gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit-Tiranë.² Ai ka 78 faqe në osmanisht dhe 120 faqe në gjuhën shqipe, të cilat janë përkthyer nga orientalisti Jonuz Tafilaj. Në inventarin e hartuar nga përgjegjësi i sektorit të dorëshkrimeve osmane në arkivin historik,

1. Këtu bëhet fjalë për librin *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, i cili tashmë është botuar në versionin origjinal i transkriptuar nga osmanishtja në Stamboll në vitin 2009. Në gjuhën shqipe ky libër është botuar në dy versione, me titullin *Kujtime-Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, (përgatiti për botim dhe redaktimi i përkthimit Akad. asoc. Marenglen Verli dhe Dr. Ledia Dushku) Tiranë: ICEBERG, 2013 dhe *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, (përktheu nga turqishtja Rubin Hoxha) Shkup: Logos-A, 2015.

2. *AQSH*, F: S. Vlora, D. 8.

Përgjithësisht cilësia dalluese e këtyne bejlerëvet dhe e pashallarëvet qe me u provue djelmët e denjë të Dheut-nanë dhe me rujtë lidhjet e tyne, me pasuni e famë që gëzojshim me këtë dhe me kombin që jetonte mbi të.

Në këtë kohë bashkatdhetarët tanë orthodoxë lidhën shpresat e tyne ngushtas me Athinën, morën prej aty çdo dritë e ndjesi fetare ma tepër se kombëtare, dhe kështu vonoj edhe për kohë të gjatë independenca e Shqypnisë e bashkë me këtë dhe përparimi i saj.

Shkollat greke në Shqipni qenë jasht çdo kontrolli. Aty u mësohej dhe u shartohej femravet orthodoxe shqiptare çdo ndjesi që dëshrohej. Mësuesat që kishin marrë mbi vedi edukimin e atyne fëmivët u flitshin mbi madhninë e së kaluarës së Greqisë mbi qytetrimin e sotshëm të saj dhe mbi qëllimet që ajo kishte në t'ardhmen si trashëgimtare e Greqisë së Vjetër. Kështu, ata mësues punuen me përhapë greqizmin dhe pëlqyen me qujt nxënset ma parë mongolë e tartarë, e jo shqiptarë.

Sundimi otoman e kundronte si një gjë të natyrshme matjen dhe ardhjen nga Athina të mësuesvet e t'inspektorëvet grekë dhe mbyllte sytë përpara fondevet që çoheshin prej andej dhe paguheshin ditën për diell. Nuk hetonte kurrënjë ai sundim se cilët ishin ata mësues që vijshin nga Athina dhe cili ishte qëndrimi i tyne mbrenda në shkollë; dhe as

shihte mënyrën me hudhë një sy dhe me ba një shqyrtim mbi tekstet në përdorimin prej nxënset.

Shkollat greke në tokat osmane gëzojshin një autonomi të veçantë; valinjtë, prefektat e gjithë nënpunsat tjerë kompetent nuk i inspektojshin as mbrenda as jasht këto shkolla. Kështu, shkollat greke i futshin kazmat sa mujshin sovranitetit osman dhe si pasojë ndryshonin ndjesitë kombëtare shqiptare. E shkollat myslimane, këto ishin sa për emën, ishte e kotë me kërkue prej tyne një përmirsim të gjendjes shoqërore-kulturore të myslimanëve. Drejtimi i këtyne shkollave në nënprefektura u ishte besue disa mësuesvet të pa vlerë, që iu paguhej një rrogë mujore prej dyqind e njëzet e pesë groshësh, dhe mësimi i gjuhës shqipe ndër to ishte i ndaluem. Metoda e mësimi e t'edukimit, të zbatueme ndër këto shkolla, u jepshin këtyne trajtën e një instituti të hapun për me mësue njerzit në plogështi! Ishte e kot me prit prej këtyne shkollarëvet si fryt me ideale të nalta e shërbime patriotike. Nxënësi injorant⁵ hynte e injorant⁶ dilte prej tyne. Dhe ata që ishin të pasun çojshin në Stamboll djelmët e vet me të vetmen shpresë që djali të zente pozitë e të grumbullonte pasuni. Me fjalë ma të qarta, etent e tyne dëshirojshin që djali të lidhej sa më fort me at ambjent ku kishte vendos me

5. I pashkolluar (shënim i redaksisë).

6. I pashkolluar (shënim i redaksisë).

kaluar jetën. E mu për këtë arsye, ata zogj shqiptarësh që mbarojshin shkollat fillore, të mesme e të nalta zhvilloheshin pa kurrfarë ndjesije kombëtare dhe gjithë kujdesi i tyre ishte me rrënue në kurriz të shtetit. Me gjithë këtë, ndër këta pati dhe asish që i shërbyen vërtetë atdheut, që zgjodhi kombin dhe që i dha jetë Shqipnisë. Kurse orthodoxët, pa pas asnjë dobi prej grekësisë, pa gëzue pozita të nalta n'at shtet, begatën Athinën nëpër mes të mendimevet të veta, me shkolla, me universitete e në lloj lloj ngrehinash, prodhimi i të cilavet edhe sot paraqitet me zhdukë ekzistencën t'onë kombëtare dhe me helmatos zemrën e mendjen e shqiptarit me helmin që buron prej andej. Shqiptarët myslimanë të varfën dhe të pasur, të mirë e të keqij, as njeni prej tyre s'dha ndihma për jashta dhe fatin e ardhshëm t'atdheut të vet s'e lidhi me botën e huaj. Duhet t'a pohojmë si një të vërtetë t'hidhte se ortodoksët në një kohë shumë t'afërme filluen me njoftë kombësinë e tyre, me njoftë atdhenë dhe me dëshmue karshi këtij një lidhje të vërtetë. Mirë po, mirë a keq, prap bejlerët e pashallarët, qenë shkaktarët me rujtë ekzistencën e Shqipnisë dhe ma në fund ata mbrijtën me shtjellë flamurin e pavarësisë së saj.

“Shëndet të gjallëve e ndjesë të vdekurvet”

Syrja Vlora, prej Vlore

1. Ahmet Hilmi Pashë Bendo, prej Gjirokastrë, mirmiranë (gradë pashë në hijerarkinë civile). Dervish Pashë Lofça kur ishte Vali në Janinë e mori në zyrë të vet Hilmi Efendinë dhe u rrit nën kujdesin e tij edukativ, u emënue nënprefekt në Vlorë, inspektor i drejtësisë në Manastir, dhe kështu u pasunu me kulturë. Shkruente bukur, fliste egër, dhe në përpjesëtim me kulturë e me zotësi që kishte rëndonte në të ma tepër vesi. I veshun prej gjithfarë vesesh, ishte trim, mizor e shpifës. Dervish Pasha këtë e përdorte si mjet të vetin për t'ia lëshue në shpinë këtij e atij, dhe ai bante keq sa dinte e sa mujte. Në relacione miqësi me familjen e Dinajvet, u ba i pasun; por një furtunë e papritur ia shpartalloj famën e rendësinë dhe s'i ngeli tjetër në jetë veçse kujtimin të të zezavet të tij.

2. Ahmed Hulusi Efendi, janinas, grada, Ula-senefi-Sani (një lloj grade në hijerarkinë civile-J.T.). I ati, Abdullah Efendi, tue qenë çifut u kthye në myslimanizëm. I biri i zgjuet jashtzakonisht e aktiv, zu një pozitë ma të naltë midis parësisë së Janinës, bani pasuni e fitoj nderime dhe përkrahi disa shqiptarë që shkuen në Janinë dhe ua dha dorën nevojtarëvet. Mbrapa ra në disgrac të valiut Tartar Osman Pashës, pa shumë dame prej tij. Por me gjithë këtë nuk iu përul, erdhi në Stamboll dhe në çdo kuvend foli ashpër

kundra tij dhe përmendi kudo veset e mizoritë e tij që i cilësonte si një sadizëm. Dhe ma në fund, me përkrahjen që pati prej meje (Syrja Vlora) mbërrijti me pushue Tartar Osman Pashën dhe vetë me fitue gradën Rutbei-Ula. Punoj shumë në Janinë me përhapë mësimin e gjuhës shqipe ndër myslimanë dhe u përpoq me i shpëtue janinotët nga grekizma. Qe gjuhë-mprehte e guximtar. Njeri me dituni. Vajza e tij mbasi ai vet pat vdekë, u martue me ish-kryeministrin Talat Pashën; por mbas vdekjes së këtij e bija ra në skamje.

3. Ahmed bej Dino, prej Preveze, Ula-Senëfi-Sani (gradë në hijerarkinë civile-J.T.). Lindi në Sinop kur i ati, Vejsel Pasha ndodhej këtu si prefekt, i internum nga Stambolli. Por u rrit në Stamboll, mbaroj këtu drejtësinë dhe u emënue në zyrën e Këshilltarisë së Ministrisë së Drejtësisë. I kulturuem, i sjellshëm, e kuvendar, por i pa fat, mjerimet që iu vërsulën qenë shumë të randa për të. Pat miq, por jo i qëndrueshëm në miqësi.

4. Ahmed Izet Pasha prej familjes fisnike së Nasliçit. Përparoi shpejt ndër zyrë të nalta në kohën e sulltan Abdyl-Hamidit; megjith këtë e konsideronte vehten, se i ishte hangër e drejta, nga ky shkak kishte famë përtej meritimevet të tija. Pas shpalljes së konstitucionit megjithëse

vonë, anoj kah Ittihatçijtë (pjestarët e partis “Bashkim e Përparim”-J.T.) dhe qe ngarkue prej tyne me shkelë Vlorën me katër-pesëqind aventurjera dhe me rrëzue qeverinë indipendente t’Ismail Qemal Beut. Mirë po në këtë kohë Rumelia kishte kalue prej një skaji në tjetrin ndër duer t’anmiqvet, Shqipëria ishte shpall shtet më vehte, kishte kalue administrimi i saj i mbrendshëm ndër duer të komisionit të Kontrollit të Gjashtë Mbretërijëve të mbëdhaja, fati i saj po caktohej prej Konferencës së Londrës dhe ishte edhe nën kërcënim t’ushtivet serbo-greke e bullgaro-malazeze e ma në fund me Mbretëninë Otomane kishte pre çdo relacjon e as mjet komunikimi me të s’i kishte ngel ma. Ky ekspedicion i Ahmed Izet Pashës kundra Vlorës s’ishte tjetër veçse një lodër e rrezikshme, e cila mund të zhdukte e shpartallonte shtetin shqiptar, një përfundim ky jo larg probabilitetit. Por un (Syrja Vlora) pengova ushtarët e tij me zbarkue në tokë, dhe kështu Izet Pasha nga Brindizi u kthye në Stamboll. Ittihatçijt megjithë këtë dështim të tentativës së tij ia njoftën përherë vlerën, dhe e dërguen në Jemen. Izet Pashai këtë vend të gjanë ia lëshoi në dorë Imam Jahjajt, sipas instruksioneve që kishte marrë prej Ittihatçijvet ose tue hecë sipas gjurmëvet të politikës së tij, pa bujë e pa potere. Mbas këtij sukcesi të madh Ittihatçijtë e mbajtën mbi krye Izet Pashën dhe ky për t’u tregue

bir i tyne i denjë vranoi menjëherë në Stamboll kur mori vesht se fuqitë tokësore e detare të Antantës po iu drejtoheshin kryeqytetit të Perandorisë dhe ju siguroj arratisjen Ittihatçijvet të cilët gjatë sundimit të tyne i kishin pi gjakun e marrë shpirtin popullit dhe shembë prej themelvet shtetin. Mbrapa i këndoj “requiem”- in sovranitetit kombëtar otoman me nënshkrimin e protokollit të Mondrosit, i cili u ba mbrapa bazë për traktatin e Sevr-it. Thuhet se sulltani i rrëzuem (Vahdetini-J.T.) nuk ia kishte fort besën, sepse e konsideronte si një regent t’Ittihatçijvet. Prandaj, sulltani e shtrëngoj me dhanë dorëheqjen në kabinetin e kryesumë prej tij, dhe mbas disa ditësh e zgjodhi Ministër të Mbrendëshëm. Në këtë kohë shkoj n’Ankara për t’i mësue Mustafa Kemalit, i cili në këtë kryeqendër t’Anadollit kishte nisë lëvizjen e vet çlirimtare, filozofinë e politikës, dhe për t’i dhanë këshilla se rruga që kishte kapë ai për mprojtje të kombit ishte një rrugë që nuk dilte, tue iu ba kështu vegël e Vahdetinit e frrotës së tij. Në Ankara qëndroi tetë muaj dhe aty panë fitoren kombëtare të Inonusë. Kjo fitore e huttoj dhe e tërhoqi prej vehtes, aq sa u betue me gojë e me shkrim përpara çlirimtarëve turq n’Ankara se nuk do të bashkëpunonte ma me qeverinë e Stambollit. Dhe kjo besë qe garanti për të t’i lirohej rruga për me u kthye në Stamboll. Por sa u kthye këtu

pranoi postin e Ministrisë të Jashtëm dhe u përpoq me ia paraqitë lëvizjen çlirimtare Kemaliste si një fantomë Kabineteveve t’Europës. Kështu, provoji se sukseset e Gaziut (Mustafa Kemalit) atij i ishin halë në sy.

Egoizma e tij s’e la Izet Pashën me njoftë realitetin; kështu mohoj besën e dhanun, dhe iu shmangë një udhe të drejtë që do t’ishte e denjë për një marshall si ç’ishte ai. Meritat e tij personale dhe vlerat ushtarake qenë shumë ma të nalta se gati tanë ushtarakëvet të tjerë që patën zanë shkambin ma të naltë të shtetit si kryeministra. E gabimet e tij qenë tamam këtu sepse ai besonte se mund t’a shihte me qartësi t’ardhmen, dhe egoizma e tij u provua me servilitetin ndaj Ittihatçijve. Fjalët që tha për të Gaziu duhet t’ia kenë pre shpresat për të tashmen dhe do të jenë, për t’ardhmen e tij një dënim i madh i vepraveve që zhvilloi.

5. Adem bej Safijuddin Libohova, prej Libohove. Grada Ula-Eveli. Është djali i madh i Maliq Pashë Libohovës, dhe dhëndrri i Fatime Hanëmit, së bijës së Veli Pashës, të birit të Tepelenliut (Ali Pashë Tepelenës). Trashëgoi si nga i ati ashtu dhe nga vjehrra një shumë të hollash prej ma se njëqindmij lirash; por i prishi këto ndër dëfrime dhe u qiti fundin, aq sa hodhi në skamje e në vuajtje familjen. Por në kohë të fundit ia ngjiti dorën ish-kryeministri Ferit Pashë Vlorës, dhëndrri i tij dhe

e shpëtoi nga vujtja. Nuk dinte as të këndojë as të shkruaj dhe as që i sollë ndonjë shërbim Mbretnisë; por se si e bindi dhëndrrin e vet dhe u emënuar antar i Këshillit të Naltë, në Seksionin e Janinës!, në vend të Teki Beut, vëllaut të vjerrit të vet. Jo me ndreqë financat e shtetit, por s'kishte as ma të voglin zotsi me rregullue punët e veta. Gjithmonë jetën e kaloi në rehati pa u lëkund prej tallazevet të saj dhe vdiq.

6. Adem bej Margëlliçi, Ula-Evveli. Prej një familjes së mesme margalliçjote, në krushqi me të ndjerin Abedin Pashë Dinon. E mbajti Abedin Pasha shpesh afër vedit në Ministri të Regjisë, e naltësoj ndër grada dhe me nderna e të mira që i bani prej afërmënisë që kishte me të. Bani një jetë pa trazime megjithëse gjithmonë afër... (?), me vështirësi fliste gjuhën turke. Ma tepër që i heshtun se sa gojtar, jo gjykimtarë i punëvet të veta, dhe i pa kulturë. Vdiq në Stamboll, mbasi me kohë kishte pre marrëdhëniet me vend-lindjen e vet.

7. Etëhem Efendi "Defterdari", prej Lorosi, grada Bala. Tue qenë një nënpunes i vogël finance mbrijti me u ba defterdar (drejtor finance) me "Rytbei Bala". Në Izmir bleu një çiflik të madh. U ndihmoj bashkatdhetarëvet të vet, por dhe dijte me rujtë interesat e veta. Në Kuvend ishte i gatshëm me u gjegjun,

pse prej natyre ishte i pajisun me një veti perspikaciteti. Ecte ngadalë, që dhe guximtar.

8. Edip Pasha, prej Janine, gjeneral Divizioni. Mbaroi akademinë ushtarake, dhe përparoi për hirë të zotsisë së tij. U ba gjeneral Divizioni dhe si antar i Komisionit Ushtarak t'Inspektimit pati përkrahjen e Sarajit (sulltanit). Në një kohë që Vali e Komandant në Shkodër; shoj një kryengritje greke në ishullin e Siamit. Qe i egër në fjali, por i drejtë në punë. Egoist, desht me ia imponue tjervet vullnetin; ishte dhe i bindun në vrytytet e tija personale. Qe krejt i dizenteruesem për çështje kombëtare, sepse kishte këputë me shqiptarë çdo mardhënie. Me fjalë ma të shkurtë kërkonte me shpërblye të drejtën e bukës që hante.

9. Ismail Pasha. (Në tekst mungon faqja 6. Si mbas përshkrimit që jepet në faqen 7, kuptohet se flitet për një Ismail Pashë, i cili e ka pasë gjysh Ali Pashë Tepelenën). Mbasi u këndue Mevludi dhe u shpërndanë të ftuemet, mue (thotë Syrja Vlora) më ndali atë natë me bijtë në shpi të vet. Më përkëdheli me fjalët e veta t'ambëla, dhe un mora guxim e pyeta mbi ndonjë veçansi të jetes s'Ali Pashës dhe Ibrahim Pashës. Mi jepte të gjegjun me gëzim çdo pyetje dhe më mbushte shpirtin me kënaqsi.

Më foli kështu: Ali Pashë Tepelena qe gjyshi i jem, e Ibrahim Pashë Vlora baba i nanës s'eme e i gjyshes s'ate. I pari u rrethua prej ushtrisë osmane dhe i dyti mbeti i mbyllun në kala të Janinës prej 1225 h deri në 1235 h (1810-1820). Mbaje mend se i kam pa të dy ndër ditët e mbrame të jetës së tyne. Ali Pasha qe injorant, turqishten e fliste me vështirësi e me gabime. Me mue shprehej në shqip. Ibrahim Pasha, përkundrazi, qe i urtë e i dijshtëm, fliste bukur, këndonte e shkruante. Kohët e mjerimit të vet i kalonte herë me të lutuna fetare e herë me lexime, e sidomos me lexime të Divanit të Hafizit, me ndihmën e të cilit donte me zbulue fatin e vet t'ardhmen.

Ali Pasha, i shtym prej ndjesivete shemrake (rivaliteti), që ushqente ndaj tij e burgosi Ibrahim Pashën; me gjithë këtë për personin e dijen e tij kishte nderim dhe besim ndër mendimet e tija t'arsyeshme (logjike). Disa herë Ali Pasha më pat çue mue te Ibrahim Pasha për me marrë vesht se ç'mendonte për të e për politikën e tij. Ibrahim Pasha megjithse i dëshpëruem dhe i urrejshëm ndaj Ali Pashës, nuk vente gojë kundra tij, por dhe rrugë si kallxonte për sa synonte politikën që ndiqte ai (Ali Pasha). Ibrahim Pasha ishte simpatik e burrë i kandëshëm dhe prandaj për të kisha një dashuni të veçantë. Dhe ai më thonte se më donte ma shum se djalin e vet dhe më nxiste me mësue.

Ali Pasha kishte shpresë me shti në dorë, vonë ose herët, Hurshid Pashën dhe kështu me i shpëtue lakut në të cilin kishte ra. E Ibrahim Pasha, përkundrazi, vetë ishte mërzi nga jeta dhe s'mendonte me kthye prap dikur dhe një herë në shkambin e lumtunisë së tij të përparshme dhe ishte mendenbushun për fatin tragjik të bramë t'Ali Pashës!

Por sa preu fjalën e pyeta Ismail Pashën për moshën që kishte atëherë. Qeshi dhe më përkëdheli, e mandej më tha: Moshën që ke ti sot. Mbas këtij hesapi Ismail Pasha duhej të kishte kalue moshën tetëdhjet vjeç në kohën që un pata me të këtë bashkëfjalim. Megjithë këtë arsyetim ishte i qartë dhe i shkathtë në trup, edhe pse i thatë. Mbas katër pesë vjetësh vdiq dhe u varros ndër varrezat e Edirnekapës, aty ku ishin të varrosun dhe krenat e preme t'atit e të gjyshit të tij.

Ismail beu, pa u ba ende pashë atëherë, i cili i dha sihariqin ma i pari Kryeministrit që ishin shpartallue e zhbi Jeniçerët dhe u emënue në roje të rrethet të Dikilitashit, pati disa nëpunësina në Stamboll. Në vitin 1255 h (1839) prej Ministrisë së Tersanes si vali n'Izmir, prej ku mbas një vjeti u emënua Ministër i Karantinës. Në vitin 1262 h (1845) tue iu njoft meritat e tij personale, si një burrë shteti i zoti n'administrim të vendit dhe tue u çmue besnikrija e tij ndaj sulltanit, u dërgue në 1263 h (1846) si prefekt në Tërhallë, po n'atë vjet u emënue prefekt në Viza e me titull Veziri prefekt në Trabzon,

në 1264 h (1847) prefekt n'Edrene; në 1265 h (1848) prefekt në Janinë, prej ku mbërrijti me lirue me intervenimin e tij parësin e Toskërisë që ishte e internueme dhe i dha fund periodës s'errtë të Tanzimatit. Dhe një herë ma vonë qe vali në Janinë, por asnjë herë nuk desht t'a vizitonte varrin e gjyshit të vet në Manastir të Pandelimanit dhe të shihte Tepelenën, vend-lindjen e tij⁷. Sa herë që Ismail Pasha kujtonte vuajtjet e familjes së tij mjerohej dhe mallkonte shkaktarët. Shqipen e fliste shumë qartë, dhe në konak të vet mbante shërbëtorë shqiptarë. Kudo që qe vali punoj me të drejtë dhe në publik u njoft si një vali ndër ma të mirët. Prej natyre qe shumë i butë, i drejtë dhe i prinun me ba mirë. Kur bisedonte i kandej m'e përcjellë gjithmonë me kallxime ngjarjesh dhe me shëmbuj. Fjalët i kishte të lidhuna dhe ishte shumë i qartë ndër shprehje. Ç'quhej për sjelljet e fjalët ma t'amblla e dije fisnike. Qe një vezir inteligjent dhe bamirës ndaj ata që fati i kishte lëshue dorët. Megjithse ndër turq s'ashtë zakoni me përdorë mbiemën familjejet dhe kujtimi i emnit të familjes së tij ngjallte përshtypje të tmerrshme ndër turq, ai nderohej me u qujtë "Tepedelenli-Zade" (Birë

7. Ali Pashë Tepelena trupin e ka të varrosun në Pandelimon, në Janinë, dhe kryet në Edirne Kapë-së në Stamboll. Hurshid Pasha që ishte i ngarkuem me shtrua Ali Pashën dhe me e shti këtë në dorë gjallë a vdek, mbasi e vrau, e çoi kokën e tij në Stamboll. (Sh. i. përk)

i Tepelenasit). Konaku i tij qe një qendër ku u mblihdhshin të pasun e të varfër, dhe kuvendi që bahej n'at konak qe me ia pas zili. Mbas mjerimit që i ngjau t'et, Qeveria ia ktheu pasuninë e konfiskueme, e cila qe mjaft e madhe; por vuajti dhe ai vetë për shkak se i hyni grindja me të birin, Asaf Beun e me të bijën e Shefika Hanëmi. Pjesën ma të shumtën e pasunisë së tij e trashëgoj i biri i vogël Qamil beu. Mbas vdekjes se tij dolën një grumbull trashëgimtarësh në pasuninë që la ky, të gjithë si të afërm të tij dhe pretenduen me gëzue atë mori pasunije, asht një çudi e fatit se ndër këta trashëgimtarë doli edhe një zezak, të cilit si dihej farefisi me një akt-trashëgimi falco në dorë dhe tue pretendue se ishte djali i Mahmud beut të birit të Muftar Pashës mujti me shti në dorë arbitrarisht, mbasi Mahmud beu s'kishte lanë djalë, me gjithë kundërshtimet e pjesmarrësve të familjes. Kurse unë dhe të bijt e dajës së Ismail Pashës kishim të drejtë n'atë pasuni, por ndryshimi i kohëvet dhe i pozitës nuk na la mundësinë me ndjekë këtë padi (dava). "Rahmetull'llahi alejhi rahmeten vasiaten".

10. Ismail Pasha "Mahir"- "Maktule"⁸ prej Konice, gjeneral divizioni. Qe i lidhun ngushtë me Sarajin. U ngarkue me ndjekë Xhon-Turqit në Selanik, dhe këta mandej e vranë mbas shpalljes së konstitucionit, një natë në befasi.

8. Mahir i aftë dhe Maktul i vramë, janë mbiemnat që iu dhanë. (Sh. i. përk)

Dorasi qe një oficer me emën Abdylkadër, që u ba ma mbrapa vali i Ankarasë, dhe i varun mandej prej Mustafa Kemalit, si pjesmarrës në një komplot për vrasjen e tij. Po të gjykojmë me dorë në zemër, dënimi që iu dha prej Xhon-Turqvet nuk qe aspak me vend, për shkak se ai e kishte për detyrë me iu bindë urdhnit t'eporëvet të tij dhe me shkue kundra kryengritësavet. Por dënimi që pësoj ma në fund Abdylkadëri qe një shuplakë e Zotit dhe një hakmarrje e krimin të tij. Në kryengritjen që plasi në Lisam në vjetin 1904 u ndodh në krye t'ushtrisë që shkoj me shtrua kryengritsat dhe këtu ia doli punës me sukses, tue rivendosë kështu n'atë ishull influencën e shtetit. Megjithse jo i shkollës, por ushtarak i karrierës, u dallua i zoti si n'artin ushtarak ashtu dhe si orator, deri sa mbrijti të bahet gjeneral divizioni, adjutant i sultanit dhe anëtar në Komisionin Ushtarak t'Inspektimit. Pati një emën të çquem dhe një famë; u përdor dhe ndër shum funksione private. Ishte i pashëm në trup, imponant me uniformën ushtarake dhe i shkathhtë. Bija e tij e madhe, Fitnet Hanëmi, u martua me Mit'hat bej Selimin, djalin e Salih beut, nga parësi e Delvinës. Pak para luftës së përgjithshme erdhën të dy në Vjenë, burrë e grua, mbasi Mit'hat beu kishte fitue në një loteri nja dymijë lira dhe kishte, dëshrua me pa Europën me gjithë të shoqen.

Mbas pak ditëvet që ndejën në Vjenë shkuen në Semering. Një ditë policia e Vjenës më kërkoi në telefon dhe më lajmëroi se Mit'hat beu ishte zanë me fjalë me të shoqen dhe e kishte vra këtë e mandej dhe vedin. Policia m'u lut të çohet një nëpunës nga Legata për të regjistruet teshat që kishte lanë. Aso kohe ndodhej në Vjenë dhe Faik Konica, i cili ishte daja i gruas së vrame. Policia e Vjenës kreu në këtë rast veprimet e nevojshme. E ngrata grua shkoj pa fajin e vet në moshën pa mbushë edhe njëzet vjeç, viktimë e çmendurisë ose e zemërimit të burrit të vet. Kjo tragjedi e pa pritun i shtoj një tjetër mjerim familjes së saj, e cila zaten ishte në zi nga vrasja e babës së saj (Ismail Pashës).

11. Ismail bej Vlora, prej Vlore, Rytbei-Bala (grada që kishte). Ka lindur në Vlonë në konakun e familjes Vlora në vitin 1255 h (1839). I ati, Mahmud bej Vlora veçse një mjerimi kurrgja të mirë nuk i la trashëgim të birit, dhe e ama e ndershme Hadije Hanëmi, e bija e Tahir Beut të Kapllan Pashës, pari e Gjirokastrës, nuk i prue t'et në shpi kurrfarë pasunie!

12. Abedin Bej Efendiu, pari e Janinës, i cili qe burri i Nekije Hanëmit, së motrës s'Ismail Kemal Beut dhe ... i jem, e mori në shpi të vet Ismail Kemal Beun, e rriti dhe e edukoj, e ma vonë me ngritjen e

Hajredin Pashës, të vëllait t'Abedin Begut mbaroj mësimit e mesme ndër shkolla myslimane dhe ma në fund hyni në shkollën Dhosimea të Janinës, ku mësoi në një mënyrë të përsosun greqishten dhe frëngjishten. Abedin Beu nuk kishte fëmi. Kështu e shoqja e tij, e cila ishte teza e Ismail Kemal Beut, u kujdes për këtë si një nan e vërtetë dhe ndihej e kënaqur kur përpiquej me i sigurue të nipit një jetë të qetë e të lumtun. Kur erdhi së dytit herë si vali në Janinë Ismail Rahmi Pashë Tepelena, me lutjen e Abedin Beut, të cilin e kishte nip, e mori Ismail Begun nën mbrojtje dhe e çoj në Stamboll kur u largue nga Janina. Ismail Kemal Beu qëndroj për një kohë të gjatë në shpi t'Ismail Pashë Tepelenës, i cili e vuni atë në një zyrë në Portë të Naltë. Në këtë kohë ra në Stamboll kolera nga e cila vdisnin në ditë nga njëmijë e pesqind vetë. Gjithkënd e kishte kap tmerrri për jetën e vet. Atëherë Ismail Kemal Begun e mori ungji i tij Mustafa Pashë Vlora që ndodhej në Stamboll dhe e largojë në një skaj të largët të qytetit në një shpi që kishte zanë me qira, për t'u kujdes me ia rujtë jetën. Në vitin 1281 h (1864) Mid'hat Pasha u emënue vali i Tunës (Danubit) e Mustafa Pasha, babai em ndihmës valiut. Mustafa Pasha e mori Ismail Kemalin në Rusçuk dhe aty e vu mymegjis (një lloj K/sekretari që korrigjon shkresat e sekretarëve) në Seksionin e Korrespondencës. Mid'hat Pasha,

Mustafa Pasha e Ismail Kemal begu jetuan së bashku tri vjet. Nip e ungi pranuen propozimin që iu ba Ismail Kemal Beut për me marrë të bijën e Mid'hat Pashës. Por hesapet e banuna në shpi nuk ujdisen me ato të çarshisë. Pse Ismail Kemal Beu kishte zanë dashuni me zonjushën Kleoni, të bijën e Syrmeliut, notable grek, banues në Rusçuk. Dhe kjo e donte Ismail Kemal Begun. Një natë prej netësh grabitë Kleonin prej shpisë së prindvet dhe martohet me të legalisht. Kjo martesë shkakton idhnim në mes t'ungjish e të nipit, në sa një ditë Ismail Kemal Beu shtrëngohet me u largue shpije. Fletorja "Tuna" që botohej aso kohe në Rusçuk tërhiqte urrejtjen e publikut me artikujt e saj që ishin përplot të mbushun mbi veprat reformonjëse të Mid'hat Pashës që zhvillonte në atë krahinë të Perandorisë. Ndër redaktorë të kësaj fletore ishte dhe Ismail Kemal Beu, i cili dalë-kadalë filloj të fitojë famë. Në vitin 1285 h (1868) Mustafa Pasha u emënua prefekt në Resmo dhe Mid'hat Pasha Kryetar i Këshillit të Naltë. Si njeni ashtu dhe tjetri tash ma ia kishin falë fajin e dashurisë Ismail Kemal Begut dhe Mid'hat Pasha e kishte marrë me vedi në Stamboll dhe emënue në Këshill të Naltë ndër mes të ndihmësavet të Sekretarëve të parë. E kur Mid'hat Pasha erdhi në seli të kryeministrit, Ismail Kemal Begun e emënoj prefekt në Tollçi me detyrë të shtume si kryetarë i Komisionit

të Tunës, dhe u largua Ismail Kemal begu këtij posti vetëm atëherë kur Mid'hat Pasha u internue në Bagdad me funksion të valiut. Mid'hat Pasha u ba së dytë herë Kryeministër. Këtë rradhë Ismail Kemal beu emënohet Kryesekretar i Seksionit të Jashtëm të Kryeministrisë. Mbrapa Mid'hat Pasha arratiset në Europë dhe Ismail Beu internohet në Kutahje. Ky internim i zgjati shumë Ismail beut, dhe vuajtjet e tij qenë të mëdhaja. Akif Pashë Tetova afër Eskishehrit kishte një çiflik. Për ta ndihmue Ismail Kemal in ia lëshoj në dorë këtij administrimin e çiflikut. Por Ismail Kemal beu, i shkatruem ndër çashtje llogarishë, e zemëroj Akif Pashën me llogaritë e ç'rregullta të çiflikut. Në Dukat të Vlonës Ismail Beu kishte disa druj shimshiri (fr. buis), të cilat ia shiti një të quejtuni Leiman prej Hamburgu, për një shumë dymijë lirash të verdha, të cilën shumë ia dërgoj ai nëpër dorë t'emë. Por kjo shumë nuk i mjaftoj, sepse kishte një familje të madhe me mbajtë dhe sepse ishte mësue me shkrye paren.

Në Eskishehir u ngatrrue dhe në një ndërmarrje druri. Aqif Pashë Tetova e harroj zemërimin e parë ndaj Ismail Kemal begun dhe ia ngjiti prapë dorën ndihmëtare të tij. Kur mandej Aqif Pashë Tetova erdhi në Stamboll si Ministër i Drejtësisë e ma vonë u emënu si Kryetar i Këshillit të Shtetit, me intervenimin e këtij u fal Ismail Kemal beu nga internimi

dhe u emënu prefekt i Galipolit. Prej Galipolit Ismail Kemal beu u transferua si prefekt në Bollu, mbrapa shkoj si vali në Bejrut, dhe prej këtu si ndihmës vali në Siri. Por këtu, nëpër rrenat e propaganda që përhapshin aventurierët që e kishin rrethue u trondit Saraji dhe në vilajet filloj një gërgule, prej një skaj në tjetër, nga një administrim i dobët i vendit, nga ky shkak u pushue prej këtu edhe u kthye në Stamboll ku u emënu në Komision të Naltë të Administratës si anëtar. Në Stamboll, në këtë fazë të funksionit u njoftë Ismail Beu me njerzit e Sarajit perandorak; sidomos fitoj tepër fort simpatinë e Haxhi Ali Pashës, shambelan i parë i sulltanit dhe aq iu afrue Sarajit sa që sulltani filloj me kërkue prej tij mendime! Në një kohë sulltan Abdyl-Hamidi II i dha randësi vilajetit të Tarabullus-Garbit (Tripoli) dhe dëshironte me çue atje një vali të zotin. Me ndërmjetsimin e Haxhi Ali Pashës, sulltani dërgoj në Tripoli Ismail Kemal Begun. Me urdhën të sulltanit iu vu në dispozicion një vapor i shtetit për t'a shpue në Tripoli, për të mos shkue me ndonjë vapor poste italian. Prap këtë herë, një tufë aventurierësh të stërvitun ndër intriga ishin përgatitë për t'a përcjellë Ismail Kemal Begun për në Tripoli. Ismail Kemal Beu u tremb prej këtyne dhe prej mashtrimevet e kërcënimevet t'Aras Izet Pashës. Kështu, i friksuem prej gjithë kësaj rrjete intrigash që kurdisej rreth tij,

Ismail Kemal Beu befas u arratis prej Stambolli n'Evropë!! Si kam ndigjue unë personalisht prej vetë Haxhi Ali Pashës, sulltani s'kishte ndonjë shkak me pasë mendime të këqija kundër jetës së s'Ismail Kemal Beut.

Ismali Kemal beu, tue qenë vetë shqiptarë, kishte frikë nga urrejtja kundra tij e shqiptarëve në shërbim të pallatit dhe nga një hakmarrje nga ana e tyne. Arap Izet Pasha, tue pasë marrë vesht se sulltani kishte da m'e emenuë Ismail Kemal begun Kryeministër dhe tue qenë i sigurtë se ky s'do të bahej vegël e qëllimevet e tija, e frikësoj, i shtyem prej ambicjevet të rivalitetit që ushqente kundra tij dhe kështu u ba shkak që t'arratisëj n'Europë. Si mbas informatavet të tij, italianët kishin shti në dorë një koncension. Për me ndërtue në Tripoli një liman. Izet Pasha kishte përkrahë italianët në këtë ndërmarrje, tue i sigurue vehtes një shumicë interesash. Mirëpo Ismail Kemal Beu hyni në marrveshje me një grup francezësh dhe dau me ndreqë limanin e Tripolit me anë të këtij grupi. Dhe ky qe shkak ma i fortë që e shtyeni Izet Pashën me i ndejë kundra Ismail Kemal Beut.

Ismail Beu por sa u hodh n'Europë, puna ma e parë e tij qe me i dërgue sulltanit një memorandum për të pranue një regjim konstitucjonal, dhe me këcye në krye të partisë së Xhon-Turqvet që punojshin jasht po për të njëjtin qëllim. Ky bashkpunim i Ismail beut

me Xhon-Turqit në fillim tmerroj sulltanin; por ky tmerrim nuk i zgjati shumë, pse në krye të partisë Xhon-Turke erdhi Ahmed Riza beu dhe Ismail Kemal beut natyrisht iu desht të largohej. Sulltani porsa u sigurue se Ismail Kemal Beu nuk do të mund të bashkpunonte me Xhon-Turqit, u përpoq me ba për vedi me përkëdhelje Ismail kemal Beun. Por Ismail Kemal Beu nuk u influencue prej këtyne përkëdheljevet dhe s'u vu vesh premtimevet të sulltanit. Atëherë sulltani u shtrëngue me dhanë porosi të rrepta gjithë kohë për me ndejë në përgjim kundra ndonjë turbullimi eventual që mund të nxirrte Ismail Kemal Beu. Me nxitjen e Tatar Osman Pashës, vali i Janinës dhe t'Esad Pashës, Komandant Xhandarmërie, të cilët dhe këta kishin marrë instruksionet perandorake, populli pregatiti e dërgoj protestime kundra Ismail Kemal Beut, tue e dënue veprën e tij. Bile, këta dy pashallarë po për këtë qëllim erdhën edhe në Vlorë dhe mbas shumë shtypjesh e kërcënimesh ia imponuen popullit me ba protestime të tilla. Me thanë të vërteten, Ismail Kemal Beu në kohën që ndej n'Europë s'pati relacione me Shqipninë dhe s'u muarr me ndonjë politikë serioze. Ishte në kujdesë të jetesës bile kishte mërzit miqt me vajtje-ardhje ndër ta dhe tue u kërkue të holla. Por sa u ç'pallë konstitucioni otoman, erdhi në Vlonë dhe xu selinë si deputet i Beratit në Parlamentin

Otoman. Divergjenca që pati me Xhon-Turqit në Paris dhe qëndrimi i tij larg për të mos u ba vegël e padrejtësivet dhe t'atrocistetevet të tyne e pengunë me mëvehtësinë në pozitë të ndritun në Parlament, bile dhe me hye në kabinet dy-tri herësh. Ittihatçijtë e poshtër kryen një vepër kriminale kundra këtij plaku të ndershëm, tue i dhanë një shpullë dhe hodhën në shesh një shpifje kinse ky ishte qenë ndër relacione intime me sultan Abdylhamidin II në ngjarjen 31 marsit (13 prill 1909). Kështu, deshën t'i vënë njollë nderës e dinjitetit të tij. Prandaj, Ismail Kemal Beu në tanë kohën që ndej në Stamboll, jetoj gjithmonë i shtypun e i kërcënum! Në sesionin e dytë të Parlamentit u zgjodh deputet në vendin t'em dhe si u sqarua gjendja politike e Shqipnisë, erdhi në Vlorë, ngrehi flamurin e pavarsisë, dhe kështu i bashkoj emënit të vet një kujtim të paharrueshëm.

13. Ismail Pashe Vila, Frashnjot, Mirmiranë. Qe një pashë analfabet, një kohë të gjatë qe si Serqerde (komandat, shënim i përk.) në kufi tip burri. Në Berat, në Vlorë e në Gjirokastër ku shërbej si Nënprefekt e Prefekt, mbajti kudo rend e qetësi, dhe la mjaft kujtime të mira dhe një pasuni të konsiderueshme. Me vulgaritetin si ndër sjellje ashtu dhe ndër fjalë, kishte fitue dashurinë e katundarëvet, por n'anë tjetër u kishte shti tutën cubavet. Qe naiv

sa me folë çdo kriminel ose ba keq që mohonte fajin tue u betue para tij, dhe një administrator injorant, por i mbatun. Kur donte me ba një punë, peshonte mirë interesat e veta! Turqishten e flitte keq. Vullnetin e tij ua impononte valijvet dhe kishte ba që të njihej ndër notabelt ma influent të Toskënisë. Ishin detyrue, ky dhe i vëllai Halim Pasha, me mbajt dy-tre mijë bashibuzuk (vullnetarë) në kufi dhe për kaq mereshin rrogat e ushqimet kurse efektivisht s'kishin veçse gjysmën e tyne, kaq kishte kujdes me sigurue interesat e veta materjale.

14. Ismail bej Janina, prej Janine, grada Bala. Qe i njoftun me mbiemnin "Gjiriti". Në relacione krushqie me Mustafa Naili Pashën prej Pojani, një herë kryeministër, dhe dhëndri i madh i tij, qëndroj larg bashkatdhetarëvet të vet dhe nuk u familjarizua me ta. Mbas nënpunësivet të ndryshme që pati në Drejtësi, mbriji me u ba antar i Gjykatës së Diktimit (Kasacionit). Qe dhe këshilltar i vilajetit të Gjiritit, prej ku u emënuet me gradën drejtor i Liceut Mbretnor. Vdiq tue qenë në këtë nënpunësi në vitin 1315 (1897). Qe i butë me natyrë, me u ba të mdhajvet vizitë ishte zakon i tij, sidomos ndër raste kur këtyne u bojshin ngjarje në krye; dinte gjuhë të hueja. Me një fjalë, qe një ndër njerëz shteti i rregullt dhe për t'u kujtue me të mirë.

15. Ismail Efendi, Talat-aga-Zade, Janinas, grada Ula-Eveli. Tue qenë si Kryesekretar (Korrektor) i Vilajetit të Janinës, prej këtu mbërrijti me hye në rradhë të njerzvet të shtetit otoman dhe me pasë një pozitë të naltë në Janinë.

Në vitin 1296 h (1879) erdhi në Vlorë bashkë me Mustafa Asim Pashë Gjiritin vali i Janinës; shkon në skelë me pa detin dhe vrapon, fut grushtat në detë dhe merr me pi ujë. S'e kishte dijtë deri atëherë se ujët e detit ishte i njelmë, pse kishte kujtue se asht ujë që pihet si ai i liqenit të Janinës. Mbrapa, në saj të një eksperience e të stërvitjes mbërrijti në një shkallë pjekurie në pikpamje kulture, tue mësue gjithçka. Me sjelljet e tij të njerëzishme dhe me punët e mira e të rregullta fitoi simpatinë e valijvet. Mbas pushtimit të Janinës nga Grekët emigroi me krejt popullin mysliman në Turqi. Këtu u ba shtetas i Republikës Turke tue pre kështu marrëdhëniet me Shqipnjin.

16. Islam Pasha, prej Bitinckës së Devollit, gjeneral brigade. U dërgue si rekrut në mes t'ushtarëvet që u morën prej Shqipnie mbas Tanzimatit në Anadoll, në Hixhaz e në Jemen, dhe vetëm me trimninë e tij të ndërindun u ba oficer. Në çdo ndeshje tregoi bravura të çqume dhe mbërrijti, megjithse analfabet, me u naltësue deri në gradën e gjeneralit të brigadës. Arnaud Islam Pasha

qe i gjatë e i thatë në trup. Kur qe n'Allasonjë bashkë me marshall Ahmed Ejup Pashën, hapi 23 varre në një skaj të sheshit të luftës porsa pan se kjo do të pëlsite shpejt. Ejup Pasha tue kalue andej-pari rastësisht, u tremb përpara këtyne varrevet të hapuna dhe e pyeti se ç'ishin. Islam Pasha i ishte gjegje: Lufta po fillon, qe nevoja me përgatitë vendet e dëshmorëvet. Atëherë Ejup Pasha, çudi e zemërim tue nderue naivitetin e pleksinë e tij ia prët me një tallje të vogël: Pashë a nuk do të qe ma mirë me hapë llogore në vend të këtyne varrevet. Në luftën e 1897-ës u ndodh si gjeneral i brigadës së dytë të të pestit divizion. Në këtë luftë u dallue për trimni. Mbas disa kohe u nxuer në pension, dhe u kthye në vendlindjen e tij në Bitinckë, ku dhe vdiq. Qe fisnik, i drejtë në punë dhe në fjalë, i sinqertë dhe një ushtar i zellshëm e durimtarë ndër mundime ushtarake.

17. Asaf bej, Tepedelenli-Zade (biri i Tepelenasit) grada Bala. Mbasi Tepelenasvet u qenë pre kokat e kunorzueme prej mjerimesh, Asaf beu nuk mbet i harruem, shteti e mori nën sqetull dhe e mëshiroi. Ky u ç'vesh prej ndenjave kombëtare dhe harroj mjerimet që kishte trashigue prej të parëvet të vet dhe padrejtësitë e krimet që qene krye kundra tyne; u rrit me një fjalë, me edukatën e një zotnie Stambolli. Me gradën e Pashait shërbeu ndër

disa prefektura si prefekt, ma në fund në Yskydar me gradë rutbeibala, ku qendroi deri sa vdiq. Ndër nëpunsina ku ndodhi u dallue si një administrator i zoti dhe i drejtë. Fitoi dashamirësinë e gjithkujtë dhe meritoi që emni i tij të kujtohet për mirë. Pat besimin e njerzvet të naltë të shtetit. Nuk pati kulturë, por me gjithë këtë, si i lindun e i rritun në Stamboll, qe i kandshëm e simpatik në kuvend. Nuk ka trashëgimtar as të pasunisë as të emnit të tij. Në këtë u shue e mbramja e dritë e llambës së Tepelenasvet. Qe njeri që kërkonte gjithmonë me kalue jetën në qetsi e në gëzim, pse dhe vetë qe një njeri alegro.

18. Eqerem bej Vlora, prej Vlore; grada Ula-Sani. Është djali im i madhi. Nana e tij asht Mehri hanëmi, e bija e Selim Pashë Toptanit, prej Tirane. Lindi në 28 Nenduer 1885, datë e cila koicidon me ngjarjen e lumnueshme të pavarsisë së Shqipërisë. Mësimet fillore i mori prej mësuesash të zgjedhun e të dërguem prej shkollës së naltë Terezjane të Vjenës dhe prej mësuesash të sjellun ndërgut prej France, Stambolli e prej, Italie. Shkollën e mesme e kreu në Graz të Austrisë, në të famshmen Kolegje të Sehultzit e mësimet e nalta i plotësoj n'Universitetin e Terezjanun. Ka një tok veprash të botueme shqip, frëngjisht e gjermanisht. Eqeremi qe i pari në Shqipni që vu përpara

publikut⁹ flamurin kombëtar, që dha në Berlin e në Vjenë konferenca rreth përmirësimit të gjendjes së Shqipnisë dhe me qëllim të pregatisë fushatën për pavarsinë e saj dhe ngriti zanin me anë të shtypit të huaj për rivendikimet kombëtare shqiptare. U pranua antar nderi ndër shumë institucione kulturore dhe veprat e tij politike që botoi mbi Shqipnin u lanë objekte diskutimesh ndër Parlamente t'Italisë e t'Austrisë. Në Stamboll qe ndihmës-këshilltarë.¹⁰ Prej Sulltanit qe nderue me gradën "Ula-Sani". Ndër shokë ka fitue besim dhe njihet prej tyne për serioz. Në ç'palljen e pavarsisë qe zgjedhë si delegatë në sanxhakun e Vlonës. Por aso kohe ishte tue luftue në Kuç kundra grekëvet. Me zgjedhje universale qe shënue nën-kryetar i Senatit, në kohë të Princ Widit qe emënie këshilltar në Ministrinë e Jashtme. Në luftën e përgjithshme u ndodh në Korfuz. Këtu e mashtruen Italianet dhe e çuen në Romë prej ku e internuen në Sardenjë, ku u mbajt tri vjet e tri muaj nën vëzhgim të policisë e ku kalojë një jetë mërgimi, larg miqsh e dashamirësh. Dhe mbas armpushimit u mbaj larg atdheut për një kohë gjashtë muajshe, dhe me njëmijë ndërmjetësime mundi me kthye në Vjenë. Në të dytin sesion

9. Se ç'ka dash me thanë me këtë fazë nuk kuptohet (Sh.i.përk).

10. Se i kujt ndihmës – Këshilltar, nuk e thotë (Sh.i.përk).

të Parlamentit u zgjodh deputet dhe mandej, me shumicë dërmuese votash, senator i Vlonës, ndjenjat kombëtare i ka rujtë të pastra dhe ideali i tij ka qenë me i shërbye atdheut. Jep shpresë me qenë një trashëgimtar i mirë, dhe lus Zotin që t'i jap jetë të gjatë. Prej natyre asht mizantrop, dhe si në sjellje ashtu ndër fjalë i dëshprum. S'asht i alegrivet nuk përgojon mbas sysh kërkënd, fjalën e ka fjalë dhe i qëndrueshëm në vullnet e në mendim.

19. Ilhami bej, Libohova, grada Ula-Eveli. Kur babai i tij Adem beu u jepte krah pa kursim miljonavet që kishte trashgje dhe i biri Ilhami beu nuk i linte gja mangut t'et në këtë rrugë prodigaliteti, thue se at e bir konkurojshin njani me tjetrin se cili mund të prishte më shumë pare. Ilhami beu qe njeri i shkollës, kishte mësue gjuhë të hueja, i butë në sjellje, por i dhanun së tepri mbas luksit dhe salltanetit. Në një anë vazhdonte në një zyrë të Ministrisë së Jashtme, dhe n'anë tjetër shkonte vinte në Portën e Naltë me cilësi sekretar-korrektor. Por jeta që donte të bante s'ishte e denjë për një sekretar që merrte një rrog prej pesëqind groshëvet në muej, por për një princ ose lord që zotëronte miliona. Për këtë shkak u largue prej Stambolli me detyrë Kryekonsulli një herë në Korfuz e mandej në Napoli, desht të prezantonte vehten si i vetmi trashëgimtar i titullit Tepedelenli

(Tepelena) dhe për hirë të këtij titulli kaloi një jetë luksoze deri sa u qiti fundin të hollavet që i kishin ngelë dore tue u shtrëngue me u kthye në Stamboll dhe në vendin që kishte më parë. Në një kohë e mori nën mbrojtje i kunati, i ndjeri Ferid Pasha që qe ba Kryeministër. Deziluzionet s'e lanë të qetë, dhe doli në pension me një rrogë katër pesqind groshësh, tue kalue tashti një jetë mizerje. Në luftën e Ballkanit, pa vu në hesape moshën dhe jetën e vet të kahershme, u shkrue vullnetar dhe nxorri pallën kundra armiqëvet t'atdheut. Ma në fund flaku titujt e dekoratit dhe u fut në një teqe. Prej princit u ba Dervish, dha këtu n'ekztase e në qetesi la pompën e madhnive të kësaj bote tradhëtare, vdiq e shkoj!

20. Emin Pasha, prej Skrapari, grada Mirmiran. Tue qenë një xhandar i thjesht, dalëkadale, por gjithmonë mbas një shërbimi të jashtëzakonshëm, kalojë nëpër grada të ndryshme u ba në Gjirid (Kretë) Allaj-Bej (Komandant xhandarmërie) dhe mandej mori gradën Mirmiran. Qe një katundar krejt analfabet. Por në këtë, mbrenda një kohe gjysëm shekulli, u ndodh ndër të tana ngjarjet që u zhvilluan aty, brodhi fusha e male, kudo ia doli punës në krye dhe njofti të mirët e të këqinj, të vegjlit e të parët e ishullit. Cubat tmerroheshin vetëm me të ndëgjue m'ëmnit të tij e jo ma me prezencën e tij. Atyne që meritojshin

ndihmë u ndihmonte dhe i merrte në shërbim të vet. Me vjet qëndroi në Kretë në krye të bashibuzukëvev shqiptarë dhe u ba vërtetë një strehë për ata që kishin nevojë. Megjithse i rreptë n'administrim, si eprorëvev ashtu dhe të nënshtruemvet të tij dihte me iu marrë zemrën dhe me kondendue gjithsejcinin si mbas rrethanavev në të cilat ai ndodhej.

Në turqishten e çaltë që kishte mësue, përdorte fjalë shqip, por nuk ndjente kurrë farë përshtypje për injorancën e tij. Vdiq në Kretë (në qytetin Hania), dhe la kujtimet e njeriut më të mirë.

21. Emin Efendi, Margëllicas, Grada-Senefi Sani. Edukuem ndër duer të Dinollarëvev, Emin Efendi u qe vërtetë i zoti dhe një ndër nënpunës për t'u admirue. Një kohë të gjatë punoi pranë Abedin Pashë Dinos, ku u provue i aftë e mbrapa u ba prefekt, e kudo ia shtoj vehtes nderën e dinjitetin. Në punë qe aktiv dhe i rregullt. Në shkrim kishte një stil që s'i kritikohet. Qe prej një familjeje të mesme të Margëllicës, fisnik, gjeneroz e i kulturuem.

22. Adnan Surla, Janinas, grada Ula-Senefi-Sani. Në Stamboll u muer me sarafilëk (saraf, këmbyes të hollash) dhe dalë-kadalë u pasunue. Mbrapa gjeti mënyrën se si me u fut nën sjetulla t'Abdyl Gani Agës, Darussavade-Agësë (një funksjon si prefekt i Stambollës, sh.i.p) dhe me

pasë përkrahjen e tij sa u nderue me gradën "Ula". Adhurues i kombësisë së vet, me gjithë këtë njeri i drejtë. Dhe ky si shumë shokët e tij ia la Universitetit t'Athinës një pjesë të pasunisë së tij. Ishte një tip që, si thotë proverbi, me lëmshën që merrte n'Ajo-Sofje hiqte një jetë pompoze në Bajezid, d.m.th. gjithçka merrte prej aty-këtej e derdhte n'Athinë!!

23. Ajetullah bej Libohova, Libohovit, grada, Ula-Senefi-Sani. Është djali i tretë i Neki bej Libohovës, e dhandrri i em. Mbasi kreu mësimet e veta në Liceun Mbretnore të Stambollit (Mektebi Sulltani), plotësoj studimet në fakultetin e Drejtësisë t'Universitetit të Lozanës. I njëj vërtetë mirë gjuhët turqisht, greqisht, frëngjit e gjermanisht. Punoj në zyrën e Këshillit të Shtetit në kohë të sundimit otoman, dhe një kohë qe sekretar në Legatën Mbretnore t'Athinës. Ka gradën "Ula-Senefi-Sani". Në qeverinë e Princ Wedit mori mbi vedi administrimin e një banke angleze në Durrës. U ndodh ndër shumë shërbime kombëtare me uniformë ushtarake dhe mori pjesë në një kompani vullnetarësh që qe formue nga të rinjt kur në Durrës u bastis shpia e Esat Pashës dhe krisi pushka. Ajet beu tue marrë parasysh çdo sakrificë u fut në shpi të tij dhe e bindi Esat Pashën mos me u mbrojtë por me u dorzue. Me këtë xhest Ajet beu shpëtoj shokët nga një rrezik i

vërtetë. E mu për këtë arsye Esat Pasha u armiqsu me të, aq sa kur mori frenat e qeverisjes në dorë, nuk e la me ardhë në Shqipëni! Sot ndodhet në Romë si sekretar i Legatës së qeverisë indipendente të Hixhazit, me autorizimin e qeverisë s'onë kombëtare; dhe shpesh gjeron punët e Legatës kur mungon Ministri-Titullar. Simpatizohet e nderohet prej eprorëve të vet e përgjithësisht prej qeverisë së Hixhazit. Njihet prej shokësh për karakterin e tij bujar e për ndjenjat e tij bamirëse.

24. Buhuraqi Khaneu, Janinas, gradë Ula Senefi-Sani. Në kohën e sundimit otoman fitoi në Janinë pasuni e pozitë. Kur Grekët shkelën Janinën, mblodhi plaçkat, iku dhe shkoi në Milano. Është një sarraf që ban punën gjithmonë me parsi të Shqipërisë, nuk shikon vetëm interesin e vet, por përpiqet me kondendue dhe ata, me të cilët ka rasën me punue.

25. Pertev bej Konica, grada Ula-Eveli. Pertev beu i Zejnel beut nuk qe dhe aq injorant sa me u qujtë kara-xhahil (si me thanë në shqip "injurant në kulm", sh.i.p), dihte pak të këndoje e të shkruaj; qe fort i kandshëm në shoqni, guximtar e trim dhe i zellshëm ndër punë zyrtare. Qe nënprefekt në Tomoricë e në Loras, Prefekt në Prevezë e në Dede-Agaç, dhe prej sejcilës ndër këto nëpunsina u largua mbas një

grindjeje që pati. Në Kostomoni, tue qenë Prefekt në një Prefekturë u xu me valinë e Kostomonisë ish-Kryeministrin Abdurrahman Pashën dhe një herë me valinë e Janinës Ahmed Hifzi Pashën; në Prevezë burgosi një kopshtar italian, sa i dha shkas një demonstrate morale nga ana e italianëve. Me një fjalë qe njoftë për njeri i rrezikshëm! Me i thye zemrën miqëve, me u dhanë mbas dëfrimevet, por dhe mbas thashethemevet dhe me rrojtë larg mërziçjes, qenë veset karakteristike të shpirtit të tij! Mbas mjerimit që i ra në krye me vrasjen e të vëllait të tij Ismail Mahir Pashës ra në qetsi. Vdiq në Stamboll. Qe ambicioz dhe i pa besë. Për të realizue dëshirat e tij ma të vogla bante miqt armiq dhe përpara armiqvet ulte kryet. Me fjalë të tjera, për të tërhjekë dobinë nga vetja dhe për t'u ba dam të tjerëve bahej armik i njerëzve të ndershëm dhe u thyente zemrën miqve. Kushdo që u shoqnue me të, ia pa damin. Qe një njeri "Zot ruejna sherrit (damit së keqes të tij)". "Zoti e pastë falë".

26. Besim Omer Pasha, mjek, prej Narte, gjeneral. Vetëm emëni i Besim Omer Pashës asht i tanë një jetëshkrim i shkëlqyeshëm. Mund të thuhet se s'ka njeri qe s'e njef doktorin e aftë dhe që s'ka ka dëgjue famën e tij të ndritun. Ky mjeshtër i përsosun, i cili ka gërshetue një famë emnit të vet me një mori botimesh të vlefshme që mbushin një bibliotekë

dhe me zotësinë e tij praktike me shkencën e mjeksisë, asht i njoftun njëkohësisht dhe me moralin e tij të pastër, me kujdesin e tij atnuer për të dobtët e të mjerët, me pak fjalë i veshun prej natyre me të gjitha virtytet e një njeriu fisnik. Për hirë të moderacionit ndër sjellje, ia siguroi vetes një nderë e një pozitë, ia kushtoi veten qindramija njerzvet që kishin varë tek ai shpresën e jetës së tyne, pregatiti me mijra dishepuj. Qe një mjeshtër i përsosun dhe i ç'quem në mes të kolegevet të tij. Vërtetë se Besim Omer Pasha u shkri në elementin turk dhe preu marrëdhëniet me vend-lindjen e tij, por gjaku që përshkoj dejet e tij qe gjak shqiptari dhe inteligenca e zotësia e tij qenë virtytet e një shqiptari. Ai gjithmonë u njoft si Janinas dhe emni i tij përban njenin emën ndër të rrallë të vargut të njerzvet të mëdhej shqiptar që fati historik i hodhi në prehen të Perandorisë Osmane.

27. Pertev Pasha, Psara, Janinot, gjeneral shtat-madhërie. Sa alegro qe i ati i tij Mustafa Pasha aq i zymtë qe i biri Pertev Pasha. U martue me të bijën e Behxhet beut prej Pojani që qe me graden "bala", por për shkaqe të justifikueshme u ndanë, ngjarje kjo që i përtrini një plagë në zemër të tij dhe e helmoj krejt gjatë karrierës së tij ushtarake. Prej Akademisë Ushtarake Pertev beu doli me gradën e kapitenit të Shtat-madhëris, dhe pati një pozitë të çqueme ndër shokë

për hirë t'iteligjencës së ndritun që kishte. Ndër ma të parët oficera turq vajti në Gjermani, dhe u kthye në Turqi me një kulturë të përsosun ushtarake dhe me gjuhën gjermane të mësueme ma së miri. Por sa erdhi, iu dha si shok Van Dergoltz Pashës, këtij mjeshtri ushtarak gjerman në za dhe s'u nda një herë me thanë prej tij, në sa ndahet hija prej trupit. Pertev Pashaj deri sa u ba gjeneral nuk drejtoi vetë pavarsisht ndonjë grup ushtarak por për hir të kulturës së gjanë ushtarake të mësuesit të vet Van Dergoltz Pashës punoj në zyrë të Shtat-madhërisë për riorganizim t'ushtrisë, vetëm në luftë të përgjithshme u ndodh në krye të një armate, dhe u tregue i zoti e patriot. Koha për të ishte e çmueshme, e nuk e bjerrte me punë të kotë. Me krejtë kuptimin e fjalës qe i bindun ndaj superiorëvet e i shkueshëm me kolegët e vet; shum xhentil, me veti të nalta që i sigurojshin një pozitë nderi të konsiderueshme. Jeton ende në Stamboll në pension.

28. Tahsim Pasha, Hasan-Mesare, "Puca", General i I-rë Divizioni. Djali i Elmaz bej Pucës, një familje e ndershme nga katundi i Mesares së Përmetit, Hasan Tahsim beu, qe së pari portjer-kapter pranë Fuad Pashës e mbrapa adjutant i ish-Kryeministrit Mahmud Nedim Pashës. Shkallë-shkallë mbrrijti me u ba Allaj-beg (komandant i xhandarmerisë) në Janinë, post që e

kishte dëshirue gjithmonë. Ato kohë çeta hajdutësh kishin dalë nëpër Janinë dhe s'kishte mbetur këtu as qetsi as siguri. Hasan Tahsim beu e pastroj and e kand vendin prej këtyne hajdutvet dhe kudo rivendosi rend e siguri. Mbas largimit prej Janine vajti në Stamboll prej ku u dërgue prefekt një herë në Resmo e mandej në Kandje (Kretë) ku u tregue trim e aktiv sa për shpërbllim të kësaj merite iu dha grada e gjeneralit të brigadës. Në vitin 1312 (1896) u ba ndihmësvali në Gjirid dhe në 1897, në kohën e luftës greke, u dërgue n'Alasonjë në krye të një brigade. Në zaptim të Thesalisë tregoi shumë trimni, dhe i plagosun ndër këto luftime u kthye në Stamboll. Një kohë të gjatë qëndroi si komandant garnizoni i Selanikut me gradë gjeneral divizioni. Një ngjarje e pa pritun e hodhi në disgrac: U xu me Hajri Pashën, marshallin e armatavet I e II dhe me dhandrin e vet Galip Pashën, të cilët ma në fund e raportuen pranë autoriteteve supreme me një zhurnal të tmerrshëm, i cili i shkaktoi internimin për gjashtë vjet rresht në Halep, u kthye në Stamboll vetem mbas shpalljes së konstitucionit si shumë shokë të tij të tjerë t'internuem. Prej Stambollit me pëlqim të kryeministrit, Qamil Pashës u dërgue vali e komandant në Jemen me gradë të gjeneralit të divizionit. Mbas konstitucionit, në bazë të ligjit të "Likuidimit të Gradavet" zbriti në gradën e

gjeneralit të divizionit nga ajo e gjeneralit të parë. Me intervenimin t'em si deputet i Beratit dhe të Myfid beut i Gjirokastrës u çue në Janinë si vali. Kur plasi lufta e Ballkanit, Hasan Tahsim Pasha gjendej ende në Janinë si vali. Me insistim të Ahmed Muhtar Pashës u emënuë komandant i përgjithshëm i kufirit të Greqisë. Kjo detyrë qe për të në dukje një naltësim, por në realitet e hodhi në humnerën e mjerimit. Megjithse i stërvitun në degën e xhandarmërisë, vetëm në moshë t'anvancueme mësoj me këndue e me shkruë turqisht; në çdo nënpunësi ku ndodhi u tregue i zoti me përjashtim kur mori komandën e kufirit grek. Në luftën e përgjithshme ndodhej në Lonzanë. Qarqet ushtarake turke deshën t'ia veshin Hasan Tahsim Pashës disfatën ushtarake në luftën e Ballkanit, kin për të shpëtue nga përgjegjsia që randonte mbi ta. Kjo akuzë e mjeroj shumë, së cilës iu shtuen dhe vujtjet e jetesës. Dhe nën peshën e randë e tragjike të këtyne vrejrtjevet, dha shpirtë në Lozanë. Sa do fajtor në sytë e të mëdhejve të shtetit ai s'pat pikën e fajit, asht i lam për akuzën që i veshën, prej gjith atyne që i gjykojnë punët nëpër objektivin e realitetit e të drejtësisë. Qe shumë simpatik e njeri galant. Pasuninë që kishte fitue nëpër një udhë të ndershme, ia morën grekët, dhe ky qe fakti që vetë këta përgënjeshtruen shpifjet e turqve se ai kin kishte arrit me ta n'ujdi.

29. Neki Pasha, Konica, gjeneral brigade. Njeri i lindun ushtar prej natyre, trup i fortë dhe imponant. Kishte edukatën e një ushtari të karrierës. Qe shqiptar e prej Konice e kurrëgjia tjetër nuk e lidhte me Shqipnin. I ishte shlye nga shpirti ndjenja e shqiptarizmes. Një oficer turk me plot kuptimin e fjalës. Indiferent ndaj punëve të tjerëve, as ai qe mirënjofhtës ndaj kënd as kush nuk ishte mirënjofhtës ndaj tij. Un të vëllanë e tij, Mazllum benë e gradova prej Drejtësisë së Doganës së Xhesri-Mustafa n'atë t'Erzurumit. U përpoqa për të mirën e përparimin e tij; por dy vëllezërit, tue pasë pre relacionet me Shqipninë, caktuan Stambollin si vend-banimin e tyne.

30. Servet bej, Alizoti, prej Gjirokastrë, grada Ula-Senefi-Sani. Si vdiq Sulejman Pasha i Ibrahim Pashë Vlorës, la të shoqen Merjem Hanëmin, bijën e Omer Pashë Vrionit, e cila trashëgoj nga i shoqi gjashtëmbëdhjetë çifligje. Vdekja e Sulejman Pashës dhe trashëgimi që la ky shkaktuen n'opinionin publik thashetheme dhe qe folë për një atentat. Merjem Hanëmi u martue së dytit herë me Ahmed bej Alizotin, dhe pati tre djem, ndër të cilët ma i vogli qe Servet beu. Servet beu me të vëllanë Sabri beun e shkrinë gjith atë pasuni që trashguen nga e ama dhe dhanë ndër dëfrime, harruen me zbulue misterin me të cilin qe mbulue vdekja e Sulejman Pashës!

Unë bleva prej Sabri beut e Servet beut, djemve të Merjem Hanëmit, çifligjet e Karakulës, Cervenës, Delijusufit e Zhukës, dhe në vitin 1303 h (1885) vajta në Gjirokastrë për me krye veprimet zyrtare në lidhje me këtë shit-blerje. Me këtë rast i bana një vizitë Merjem Hanëmit. Më priti me nderime e bujarisht. Në bisedim e sipër më tha: "S'asht për t'ardh keq kur pasunia kthehet në dorë të të zotit. Këto çifligje iu përkitshin familjes s'uej. Mbas këto kaluen prap në dorë t'uej gëzohem, në vend që me u mjerue". Aso kohe në Gjirokastrë qe prefekt një plak i ndershëm e me kulturë, i cili quhej Bedri bej. Ishëm miq në shpi të Timur (Demir) Pashës. Prefekti me shumë parësi të vendit m'erdhën në vizitë. Bashkë me këta ishte Sabri beu. Ky, kishte ndejë në një skaj, me krye për dhe me një pozë të përdhimbshme. Bedri beu iu drejtue Sabri beut me këto fjalë: "Sabri bej, mos u dëshpëro. Këtë fat psojnë çifligjet e blenuna me dhet para lau damin (afjuu-ruli). Këto fjalë të hedhuna si një bombë zgjuen dhe habitën të pranishmit, tue i dhanë shkas komenteve të ndryshme! Servet beu ishte në relacione me parësinë e Gjirokastrës, Beratit, Elbasanit e të Vlorës dhe kishte ba krushqi me Ministrin e Luftës Ali Saib Pashën. Bile, qe vendosë një herë martesë e tij me princeshën Emine, të bijën e princ Halim Pashës s'Egjiptit, por e penguen këtë martesë Ferid

Pasha e Esat Pasha, tue përdorë disa shkaqe e disa dredhina. Ma mbrapa sipas tij gjet një vend në Rezhë me përkrahjen e Esat Pashë Toptanit, dhe ai, Servet beu, i kalojë në mizerje ditët e fundit të jetës së tij. Pak dinte të këndonte e të shkruante; në të ritë e vet qe simpatik e aventurier, në pleqni i heshtun. Veç i ziu i vehtes; kërkujt si bani keq në jetë, s'u muer

kurr me politikë; i tanë kujdesi i tij qe me kalue një jetë dëfrimi. Ra në kurthin e dashurisë së dy dashnoreve jashtëzakonisht të bukra, të Minës e të Bihanes, dhe për to prishi një pjesë të madhe të pasunisë së tij. Vdiq në Tiranë në vitin 1924, dhe gjith kujtimet e jetës së tij ngelën andej perdes së mistereve.

Recensë mbi librin:
**“Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare
Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912)”**
të historianit, Dr. Nuredin Ahmeti

Dr. Ilirjana Kaceli
Kolegji Universitar “Bedër”

Abstrakt

Krerët fetarë ashtu si edhe figura të tjera të popullit shqiptar, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Disa prej këtyre personaliteteve, veçanërisht ata myslimanë, kanë qenë prezentë me veprën e tyre gjatë gjithë luftës së popullit shqiptar kundër osmanëve, veçanërisht në periudhën kulminante të kësaj lufte, epokës së Rilindjes Kombëtare. Ajo do të rritet më tej, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në shpalljen e pavarësisë kombëtare, në vitin 1912. Në këtë vepër, autori, për herë të parë, e pajis lexuesin me një këndvështrim tjetër nga ç’jemi mësuar të lexojmë deri më tani mbi figura të ndryshme dijetarësh dhe patriotësh fetarë, si edhe na jep të dhëna mjaft të rëndësishme për një nga vilajetet kryesore shqiptare, Vilajetin e Kosovës. Kjo monografi është e rëndësishme, sepse autori e sjell atë në mënyrë të zgjeruar, bazuar mbi dokumente autentike. Jeta dhe vepra e shumë prej krerëve fetarë, që kontribuuan në luftën për pavarësi të popullit shqiptar, kanë shërbyer si burim frymëzimi për brezat e ardhshëm në gjithë arealin mbarë shqiptar.

Historia shqiptare mbart periudha të ndryshme historike. në vetvete një mori Kombi shqiptar është i pasur me figura ngjarjesh, faktesh për të shumta historike, si kombëtare personalitete të ndryshme kombëtare, ashtu edhe fetare. Të shkruhet dhe të cilët kanë lënë gjurmët e tyre në të jepen vlerësime rreth tyre duhet



Libri i Nuredin Ahmedit

me të vërtetë një punë mjaft e palodhur, kërkimore dhe hulumtuese e historianëve e studiuesve bazuar mbi faktet dhe dokumentet e reja historike të dala veçanërisht pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri, por edhe pas krijimit të shtetit shqiptar të Kosovës. Deri në vitin 2011, kur doli monografia “Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912)” e autorit Nuredin Ahmeti, në të gjitha trojet shqiptare ishin botuar vetëm dy vepra që trajtonin rolin e ulemave (dijetarëve islamë) në çështje dhe ngjarje të ndryshme të popullit shqiptar. E para ishte monografia me titull “Myslimanët Shqiptarë në Lëvizjen për pavarësi kombëtare

(1878-1912)”¹, botuar në vitin 1968, nga albanologu i njohur gjerman Peter Bartl dhe e dyta ishte vepra e studiuesit shqiptar Ali M. Basha “Nëpër gjurmët e Islamit”². Monografia e studiuesit Nuredin Ahmeti është e para e këtij lloji dhe e pajis lexuesin me një këndvështrim të ri mbi punën e kryer nga figura të ndryshme fetare, si dhe trajton qëndrimin e tyre në luftën e popullit shqiptar e shprehur kjo përmes një vëllimi të gjerë materiali të dokumentuar. Autori, që në hyrje të punimit, na tregon arsytet pse e ka zgjedhur këtë temë studimi. Sipas tij: e para, është mangësia e një botimi të veçantë për krerët fetarë myslimanë, e dyta, në kohën e sistemit komunist në Shqipëri është shkruar për figura të ndryshme historike kombëtare, por janë mënjanuar artikujt mbi rolin dhe veprën e kryer nga personalitetet e ndryshme fetare. E fundit, sipas autorit, shtysën më të madhe do t’ia jepte qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj fesë në vitin 1967³. Në këtë vit shteti ndaloi të flitej apo të propagandohej

1. Peter Bartl, “Myslimanët shqiptarë në Lëvizjen për Pavarësi Kombëtare (1878-1912)”, (Përktheu nga Gjermanishtja: Nestor Nepravishta) Shtëpia Botuese, Dituria, Tiranë 2006.
2. Ali M. Basha “Nëpër gjurmët e Islamit” (Përmbledhje studimesh, analizash, shënimesh historiko-kritike, refleksionesh etj.), Tiranë 2005.
3. Ky lloj shkatërrimi pasqyrohet në revistën “Nëntori” në vitin 1967 ku thuhej se 2169 ndërtesa fetare në vend si xhami, teqe, kisha, manastire, kuvende, etj., do të mbylleshin dhe se Shqipëria u bë vendi i parë ateist në botë.

mbi fenë dhe Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë, duke ndaluar të gjitha studimet rreth fesë. Ky fakt ishte vërejtur më së miri në kremtimin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur Kuvendi Popullor i Shqipërisë do të nderonte me titullin “Hero i Popullit”, Abdyl Frashërin, Mic Sokolin dhe Sulejman Vokshin, kurse njëri prej figurave më të respektuara dhe kryesore të Lidhjes Shqiptare, Myderrizin Ymer Prizreni, e kishte mënjeluar⁴. Një fat të tillë do ta kishin edhe figura të tjera të ulemave, që kishin kontribuar dhe që nuk u njiheshin asgjë nga vepra apo puna e kryer prej tyre. Por, në krahasim me shtetin amë, vazhdon ai, në Kosovë, klima ishte disi më e butë në ndriçimin e figurave fetare islame dhe veprimtarinë e tyre në ndihmë të Lëvizjes Kombëtare shqiptare⁵. Pas viteve 90, gjithçka nis me ndryshimin e sistemit shtetëror. Filozofia e të shkruarit të historisë, shtoi numri i penave që do të shkruanin për figura të ulemave në Lëvizjen Kombëtare shqiptare dhe veprimtarinë e tyre në kuadër të Vilajetit të Kosovës⁶.

Monografia e autorit Nuredin Ahmeti, është konceptuar në tre kapituj. Në përmbajtjen e saj përveç kapitujve do të përfshijë hyrjen dhe përfundimet. Një vend

të rëndësishëm zënë edhe pasuria e madhe bibliografike. Vlen të theksohet, veçanërisht, citimi dhe paraqitja e disa prej dokumenteve osmane, të cilat janë ndër burimet kryesore për jetën dhe veprën e personaliteteve të ndryshme fetare. Krahas tyre janë ofruar dokumente të pabotuara më parë si dhe i referohet gjerësisht shtypit të kohës të botuar brenda dhe jashtë vendit.

Në kapitullin e parë autori trajton rrethanat politiko-shoqërore në Vilajetin e Kosovës (1878-1912). Aty do të trajtohen tezat e hedhura nga historiografia shqiptare dhe ajo turke mbi datën e themelimit të këtij vilajeti, për të vazhduar më tej me organet e tij, popullsinë, kushtet ekonomiko-shoqërore, arsimimin dhe në fund të kapitullit do të prezantohet Vilajeti i Kosovës sipas veprës së famshme të Sami Frashërit, enciklopedisë “Kamus Al-alam”.

Në kapitullin e dytë përshkruhet kontributi i brezit të ulemave në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1887), apo të Lidhjes Shqiptare të Pejës (1898-1902) deri në kapërcyellin e shekullit, në të cilin, këta dijetarë dhe figura të rëndësishme të fesë islame, luajtën rol vendimtar për mbarëvajtjen e Lëvizjes Kombëtare, duke dhënë ndihmën e tyre materiale dhe shpirtërore, si dhe duke vënë në dispozicion të saj objekte të kultit ku ata shërbenin si: xhami, teqe etj. Një vend i rëndësishëm do t’i jepet ulemasë së qytetit të Prizrenit, një nga

4. Nuredin Ahmeti “Krerët Fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912), Prishtinë 2011, f. 14.

5. Po aty, vep. e cituar, f. 14.

6. Nuredin Ahmeti po aty, f. 15.

qendrat më të rëndësishme historiko-kulturore të popullit shqiptar. Ulematë e këtij qyteti iu dërgojnë telegrame ambasadorëve të Fuqive të Mëdha pas vendimeve denigruese në kurriz të popullit shqiptar, në kohën e nënshkrimit të Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit. Është me vlerë të përmendet edhe telegrami i myderrizit Daut Efendia nga Tivari, myftiut Zejnel Abedini nga Prishtina etj. Autori do të trajtojë me detaje, jetën dhe veprën e figurës së Haxhi Ymer Prizrenit, i cili në tetor të vitit 1879 u zgjodh kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kurse në janar të vitit 1881 kryetar i qeverisë së Shtetit të parë Autonom Shqiptar, funksion të cilin e mbajti deri në fund të jetës së tij. Pas shpartallimit ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Haxhi Ymeri iku dhe u strehua në Ulqin, ku vdiq më 12 qershor të vitit 1887. Pas internimit të tij në Ulqin edhe familjen ia internuan në Izmir. Në këtë veprë vlerësohet figura dhe vepra e Ahmet efendi Korenicës, Shejh Eminit, Dervish Salihut, të cilët nuk ndalën deri në frymën e fundit të punonin në dobi të çështjes kombëtare shqiptare. Më tej vijnë figurat e Lidhjes Shqiptare të Pejës si Haxhi Zeka, apo figura të panjohura në historiografi si: Hasan Efendi Shllaku, Hafiz Ymer Guta, Mulla Musai i Strelcit. Gjithashtu janë trajtuar dhe figura të krahinave të Plavës e Gucisë si: Mulla Sadi Musaj, apo Mulla Hysen Ali Gjonbalaj.

Në kapitullin e tretë, është trajtuar kontributi i parisë islame në Vilajetin e Kosovës gjatë viteve 1908-1912. Në vitin 1908 shpërthen Revolucioni Xhonturk, për të cilin njihet edhe kontributi i shqiptarëve. Një ndër personalitet që përkrahu dhe ndihmoi në zhvillimin e kësaj lëvizjeje ishte edhe Sheh Ymer Lutfi Paçarizi, intelektual dhe orientalist i njohur me veprën e tij në shumë fusha të kulturës dhe teologjisë. Në Kongresin e Manastirit do të theksohet roli aktiv i Haxhi Vildan Efendiut, i cili ndërmoi një mision shëtitës nëpër qendrat e vilajeteve shqiptare për ta bindur popullin mysliman se Kur'ani nuk e ndalonte shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja latine. Po në këtë kapitull, një vend të rëndësishëm zënë edhe pjesëtarët e kryengritjes së vitit 1912, Mulla Idrizi, Mulla Halimi, Mulla Sinan Maxhera, si bashkëluftëtarë të Idriz Seferit. Krahas kontributit që patën në ngjarjet historike është trajtuar edhe kontributi i figurave fetare kombëtare në fushën e arsimit dhe kulturës, si dhe përpjekjet e tyre për t'i mësuar gjuhën shqipe popullit të Vilajetit të Kosovës. Vlen të përmendet, puna e ndritur e Mulla Sylës, për hapjen e shkollës së parë shqipe në Pollozhan të Vitisë në vitin 1909. Vend të rëndësishëm, në këtë kapitull, kanë zënë edhe mizoritë e masakrat e kryera nga ushtritë serbo-malazeze në vitet 1912-1913 në Kosovë, mbi të cilat jepen fakte mbi trajtimin që iu

bë popullsisë shqiptare, veçanërisht në trevën e Opojës. Autori është përpjekur dhe ka cekur në veprën e tij edhe tolerancën ndërfitare që ka ekzistuar te shqiptarët, në përgjithësi, dhe rajonin e Vilajetit të Kosovës, në veçanti. Botimi i këtij libri vjen në duart e lexuesve, gjerësisht, si një vepër e plotë mbi veprimtarinë e dijetarëve dhe hoxhallarëve kryesorë të fesë islame në Vilajetin e Kosovës, gjatë ngjarjeve më madhore të popullit Shqiptar në tërësi dhe Vilajetit të

Kosovës në veçanti. Shumë prej këtyre figurave dhe personaliteteve fetare, duke u përpjekur që ta mbrojnë popullin nga terrori dhe masakrat, apo shtypja e vazhdueshme, u flijuan dhe dhanë jetën e tyre për atdheun. Ky është një punim shkencor i vlefshëm për historiografinë bashkëkohore shqiptare, që do të shërbejë si referencë në të ardhmen me qëllim që historia jonë të pasurohet gjithnjë e më shumë.

Hafiz Halid Bushati

Abstrakt

Nga shkrimet e mbetura deri tani, mësojmë se Hafiz Halid Bushati ka dhënë ixhazete të shumta gjatë jetës së tij. Me një fjalë, ai ka qenë një shkollë hoxballarësh e njerëzish të devotsbëm e të lidhur ngushtë me fenë e tyre, fenë e të parëve të tyre, Islamin.

Përvoja mençurore, diturore e pedagogjike e Hafiz Halitit ka pasur një shkallëzim të natyrsbëm, në rritje, në përputhje me ngritjen e tij, me shtimin e aftësive të autoritetit e të popullaritetit në masat e rinisë e të popullit.

Si mësues mejtepi ai u njoh me fëmijët dhe prindërit e tyre, me përmbajtjen e programit e të tekstit, me metodat tradicionale të mësimit dhe të edukimit në atë kohë.

Pozitive për mësuesin e ri ishte përdorimi i gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimit e të edukimit, si dhe kujdesi i tij i vazhdueshëm që nxënësit të fitonin jo vetëm njohuri, por edhe aftësi, shkathhtësi e shprehje praktike për edukimin shpirtëror e për zbatimin e tyre në jetën e përditshme.

Gjatë jetës së tij si myderriz e si jurist që zotërues i arabishtes, turqishtes e persishtes. Ashtu si dijetarët e tjerë islamë pati një bibliotekë shumë të pasur me libra shqip e të buaj, me tematikë fetare, shkencore e letrare.

Në vitin 1905 jep dorëheqjen nga arsimi, sepse myftiu dhe ulematë e qytetit e zgjedhin teknik të deshbfrimit dhe nxjerrjes së fetvave, detyrë të cilën e mbajti deri në fund të jetës së tij.

“Ky personalitet asht pinjuell i fisit të Bushatlinjve.

**Për zotësinë e tij si jurist në legjislaturën islame
meriton të rradhitet në vargun e specialistëve të njohun të kohës...**

**H. Halid Bushati gjatë 20 vjetëve dha dy herë ixhazet
d.m.th. ai qiti dy palë hoxhë e myderrizë...”¹**

1. Bushati, Hamdi, “Shkodra dhe motet”, vëll. I (botim i dytë i rishikuar), Shkodër, 2005: 471.



Halid Bushati

Personaliteti më i shquar që u bëri nder pasardhësve të drejtpërdrejtë si dhe tërë fisit, është Hafiz Halid Bushati, i njohur në jetën e përditshme me shkurtimin miklues “Lito begu”...²

“Ashtu truppakët, i kërrusur dhe i hajthëm në fytyrë, me sy gjallërues, merrte rrugën, kapërcente urën dhe drejtohej për në Xhaminë e Kuqe të Perashit...”³

Nuk dihet me saktësi data e lindjes së tij, por mësojmë se: “Nga biografia e shkrueme prej dorës së tij rezulton se, në vitin 1870 mori dëftesën e lirimimit nga “Ruzhdija”⁴.

2. Bushati, Hamdi, “Bushatllinjë”, pajisur me shënime nga Nexhmi Bushati, Shkodër, 2003: 397.

3. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, 1997: 145.

4. “Si rrjedhojë e reformave të përmendura më lart (ato të vitit 1869) edhe në

Nga kjo u regjistrua në rrethet e Hasan efendi Podgoricës⁵. Në vitin 1898 mori ixhazetnamen dhe fitoi të drejtën me qenë myderriz...”⁶

Studiuesi i hershëm Hamdi Bushati, në veprën e tij voluminoze “Shkodra dhe motet” (vëllimi i parë i botimit të dytë), duke folur për personalitetin e Hafiz Halid Bushatit, që në kreun e XI-të të titulluar: **“Elita intelektuale e**


Shkodër u hapën herë pas here shkolla të ndryshme të cilat mund të klasifikohen në tre grupe: a) Shkolla foshnjore dhe fillore... b) Ruzhdije ose qytetëse 3-klasëshe (quhet edhe mektebi ruzhdije ose ruzhdije mul-qije) c) Idadije (e mesme)...”- Njazi Kazazi (Kandidat i shkencave), “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër nga fillimet deri në vitet ‘20 të shek. XX”, (Temë disertacioni në dorëshkrim), Shkodër, 1992: 32.

5. Hasan Podgorica: “Në mes të personave me kulturë të gjanë në fushën e vet asht edhe myderrizi Hasan Podgorica. Ka qenë një ndër ylematë e mëdhenj të Shkodrës, nga çereku i fundit i shekullit të kaluem... (XIX) Hoxhallarët kryesorë, teologët predikues (vaizë) ishin elita e popullsisë myslimane shkodrane. Gjykimi i tyre për çështjet politike e shoqnore gati kurrë nuk asht ba dysh nga besimtarët...

Hasan Podgorica hapi kathedren e tij në Medresenë e Pazarit, ku iu patën mbledhë shumë studentë (talebe). Ndërsa të diplomuem prej tij ma të shkëlqyeshmit dolën Hafiz Halid Bushati, Molla Veli Anamali, etj...

Ndaj ngjarjeve politike nuk qëndroi indiferent. Ai ka nënshkruar protestën e shqiptarëve drejtue Kongresit të Berlinit më 15.06.1878. Qe varrosë në varrezat e Xhamisë së Begos.” (Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”- 1/463-464.

6. Bushati, Hamdi, “Shkodra dhe motet”, vëll. I, 1998: 471.



fetvaja e Halit Bushatit

Shkodrës nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në vitet ‘20 të shekullit XX’ e rendit të 17-in, ndër 25 personalitete të këtij qyteti (pas tij përmenden Luigj Gurakuqi, Hafiz Ibrahim Kraja, Anton Xanoni, Risto Siliqi, Hilë Mosi, Vinçens Prendushi, etj.), citon: “Mbasi mori ixhazet prej Hasan Podgoricës iu vu përpjekjeve që të specializohej në jurisprudencë për dhanien e fetvave në bazë të shariatit...”⁷

Vite më pas, ai do të kalonte në zyrën e myftinisë me detyrën e interpretuesit të fetvave ose “fetva-emin”⁸. Kjo punë delikate dhe me shumë përgjegjësi morale

e shoqërore, e kryer me devocion fetar e profesional, ia rriti shumë konsideratën në opinionin fetar e qytetar.⁹

Nga shkrimet e mbetura deri tani, mësojmë se Hafiz Halid Bushati ka dhënë edhe ixhazete të shumta gjatë jetës së tij. Me një fjalë, ai ka qenë një shkollë hoxhallarësh e njerëzish të devotshëm e të lidhur ngushtë me fenë e tyre, fenë e të parëve të tyre, Islamin. Një ndër këta persona të kualifikuar nga Hafiz Halid Bushati, ka qenë edhe Hafiz Jusuf Abdullah Këlmendi (1876-1943).

Interes paraqet edhe jeta e tij e mësuesisë. Në vitin 1893 është mësues filloreje në mejtepin e Fushë-

7. Bushati, Hamdi, “Shkodra dhe motet”, vëll. I, 1998: 471.

8. Po aty, fq. 481.

9. Bushati, Hamdi, “Bushatllinjte”, pajisur me shënime nga Nexhmi Bushati, f. 398.

Çelës. Në vitin 1898 është mësues në shkollën Ruzhdije.¹⁰

Përvoja pedagogjike e Hafiz Halitit ka pasur një shkallëzim të natyrshëm, në rritje, në përputhje me ngritjen e tij, me shtimin e aftësive të autoritetit e të popullaritetit në masat e rinisë e të popullit.

Si mësues mejtepi ai u njoh me fëmijët dhe prindërit e tyre, me përmbajtjen e programit e të tekstit, me metodat tradicionale të mësimin dhe të edukimit në atë kohë. Mësues Haliti u përpoq të bëjë përmirësime, shfaqi cilësi personale për krijimin e marrëdhënieve të drejta me fëmijët e frymë bashkëpunimi me familjen, fitoi një emër të mirë që e ndihmoi për të ecur përpara. Pozitive për mësuesin e ri ishte përdorimi i gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimin e të edukimit, si dhe kujdesi i tij i vazhdueshëm që nxënësit të fitonin jo vetëm njohuri, por edhe aftësi, shkathtësi e shprehi praktike për edukimin shpirtëror e për zbatimin e tyre në jetën e përditshme.

Edhe djali i tij Hysniu, porsa përfundoi Medresenë e Përgjithshme të Tiranës më 1932, për rezultatet e shkëlqyeshme u caktua mësues i asaj medreseje.

Shkolla Ruzhdije kishte një numër nxënësish që i kalonte 100 vetët. Drejtor i kësaj shkolle qe patrioti i madh i Rilindjes Kombëtare, “Mësuesi i Popullit” Daut Boriçi.

Në dëftesat e kësaj shkolle pasqyrohen lëndët, si: Dituri fetare, arabisht, persisht, turqisht, ortografi

10. Bushati, Hamdi, “Shënime për Shkodrën”, Hafiz Halid Bushati (dorëshkrim), f. 557-558.

e sintaksë, aritmetikë, gjeometri, gjeografi, histori, kontabilitet, vizatim e lloje të ndryshme shkrimi.

Është për t’u shënuar se në këtë shkollë mësonin shumë të rinj myslimanë shkodranë dhe pas përfundimit të saj ata qenë intelektualët e parë të kohës. Veçori e kësaj shkolle është se këtu mësonin edhe nxënës të besimeve të tjera. Kjo ndodhte nga emri i mirë që kishte fituar shkolla në popull, nga përgatitja e mirë e nxënësve, nga mundësia që u jepej atyre për të marrë arsim më të lartë në profile të ndryshme, nga lehtësia që siguronin për t’u emëruar në punë, si dhe për të ndjekur studimet e larta jashtë shteti.¹¹

Në vitin 1905 jep dorëheqjen nga arsimi, sepse myftiu dhe ulematë e qytetit e zgjedhin teknik i deshifrimit dhe i nxjerrjes së fetvave, detyrë të cilën e mbajti deri në fund të jetës së tij.

Krahas kësaj, Hafiz Haliti gjatë veprimtarisë së tij ka pasur shumë kontakte me të huajt, me vizitorë nga Lindja e Perëndimi, të cilët i bënë vizita, i kërkonin shpjegime, i drejtonin pyetje dhe merrnin sqarimet e përgjigjet e duhura në sajë të horizontit të tij të gjerë fetar e kulturor.¹²

Në veprimtarinë arsimore të Hafiz Halid Bushatit një vend me

11. Kazazi, Njazi (Kandidat i shkencave), “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër nga fillimet deri në vitet ‘20 të shek. XX”, (Temë disertacioni në dorëshkrim), Shkodër, 1992: 32-34.

12. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, 1997: 147.

rëndësi zë edhe ushtrimi i detyrës së myderrizit (profesorit). Në atë kohë, krahas myderrizëve që punonin në medrese, kishte edhe myderrizë privatë. Këtë titull ata e kishin fituar nga komisione të posaçme teologësh të përmendur e të autorizuar për një detyrë të tillë. Ata mësonin të rinj që dëshironin t'u kushtoheshin detyrave fetare, të bëheshin hoxhë. Myderrizë të tillë ishin të paktë, kishin një përgatitje të thellë fetare e kulturore, dinin shumë gjuhë të huaja, kishin fituar përvojë, ishin të specializuar në disa fusha të degëve të teologjisë. Në këtë bërthamë myderrizësh të njohur e të nderuar ishte edhe Hafiz Halid Bushati, i cili i kishte të gjitha cilësitë dhe aftësitë për të qenë një myderriz i këtij kalibri.

Gjatë jetës së tij si myderriz e si jurist që zotërues i arabishtes, turqishtes e persishtes. Ashtu si dijetarët e tjerë islamë pati një bibliotekë shumë të pasur me libra shqip e të huaj, me tematikë fetare, shkencore e letrare. Një pjesë e këtyre librave janë ruajtur deri në ditët tona. Ata dëshmojnë për përdorimin e kujdesshëm nga ana e myderrizit dhe për kulturën e lartë të tij. Në mjaft prej këtyre librave vërehen nënvizime, shënime, përkthime e detyra që tregojnë aftësitë e tij për t'i shfrytëzuar në drejtme të ndryshme.

Hafiz Haliti la një libër të vetëm të shkruar me dorën e tij. Së paku, deri tani, kështu rezultojnë kërkimet nga ana e të nipit, Xhahidit. Libri është ruajtur me kujdes dhe fanatizëm, dhe "gjallë" nga nusja e shtëpisë, Hatmania (rahmet pastël), nëna e Xhahidit. Ai është

një libër i madh, me përmasa 24 cm x 18.5 cm dhe me 306 faqe, të shkruara me dorën e Hafizit të moçëm, kryesisht në gjuhën arabe, ku ka edhe pjesë në gjuhën osmane. Karakteristikë e këtij dorëshkrimi është se i mungon një titull. Nga një vëzhgim i shpejtë në përmbajtjen e lëndës së tij, do të konkludojmë menjëherë se kemi të bëjmë me një libër fikhu (jurisprudencë islame) ku fetvatë e ndryshme janë bosht kryesor dhe logjik i tij. Përmbajtja e dorëshkrimit korrespondon shumë mirë edhe me natyrën e punës së Hafiz Halid Bushatit, i cili për një periudhë të konsiderueshme kohore ka punuar dhe shërbyer në Myftininë e Shkodrës, si "mysevvid, sekretar-teknik i asaj zyre, që do të merrej drejtpërdrejt me fetva (fetva), për nxjerrjen e të cilave ishte shumë i specializuar"¹³.

Në brendësinë e tij, libri (dorëshkrim) ka edhe disa faqe të bardha, të pashkruara, që si duket Hafizi i ka lënë për shënime dhe konkluzionet e tij të ndryshme, a ndoshta koha, eksperiencat e moshës e kanë lejuar t'i mbushë nga dituria dhe bagazhi i tij i madh i njohurive, (sidoqoftë këto janë aludime, që s'ndikojnë direkt në analizimin dhe studimin e veprës së tij në dorëshkrim).

Në faqen e pestë të këtij libri, me shkrim dore, sikurse është i gjithë dorëshkrimi, me laps shkruhet: "Sahibu hadhihil-mexhmuah ve muhar-rizuhu Khalid ibn Ibrahim bek", që do të thotë: "I zoti i kësaj

13. Bushati, Hamdi, "Shkodra dhe motet", vëll. II, f. 148-149.

përmbledhje dhe ruajtësi i saj, (është) Halid Ibn Ibrahim Begu¹⁴.

Libri është një përmbledhje juridike islame, e mbushur me fetva të ndryshme, të cilat janë dhënë nga myftilerë e kadilerë të ndryshëm të Shkodrës, në kohë të ndryshme, si: Jusuf es-Siddik Efendi (kadi në vitin 1877, sipas Hamdi Bushatit në “Shkodra dhe motet”), Adem Vehbi (Myfti i Shkodrës në vitet 1904-1914, po sipas së njëjtës referencë), etj., pasi është i mbushur edhe me çështje (mesele), të cilat marrin zgjidhje në bazë të referencave burimore, që Hafizi ka shkruar me dorën e tij.

Ai përmban edhe argumente dhe pika të shumta referimi, nga më të vjetrat dhe më të spikaturat e medh’hebit hanefi, në tërësinë e tij.

Nëse do të kërkohej të përshkruhej me pak fjalë dorëshkrimi në fjalë, do të thuhej se ai i përngjet një libri dorëshkrimesh të H. Isuf ef. Tabakut. Edhe dorëshkrimi i Hafiz Halit efendiut, ka tipare të ngjashme me të lartpërmendurin, pasi edhe në fund të tij gjenden copa letrash në të cilat janë firmosur fetva të ndryshme nga myftilerë të ndryshëm të Shkodrës.

Nga studimet e para të librit të H. Halid Bushatit, gjejmë të shkruar edhe një të dhënë shumë interesante, që lidhet me fetvanë e parë të Jusuf ef. Tabakut, ku thuhet: “Myftiu i përparshëm, Jusuf Es-Sidik Efendija,

14. Gjatë kërkimeve të Muhamed Sytarit për trashëgiminë kulturore të hoxhallarëve të Shkodrës, më datë 05.04.2007, ka arritur të gjejë edhe vulën dhe një tjetër nënshkrim të Hafiz Halid Bushatit, mbi një libër të njohur jurisprudence islame të shkollës hanefite.

më 17 Muharrem 1869, në kohën kur asht ba myfti, ka dhanë fetvanë e parë. E kanë pytur për një tokë që s’ka pasur pronar, të cilën me lejen e Sulltanit dy vëllezërit, Beqiri dhe Ymeri, e kanë përdorur përgjysëm. I kanë thënë a është e drejtë kjo gjë? Ka dhanë përgjigje: Meqenëse ligji i Sulltanit ia ka lejuar diçka të tillë, asht e drejtë. Nënshkruar: Jusuf Es-Sidik, Myftiu dhe Gjykatësi i Shkodrës, Allahu e mëshiroftë.”¹⁵

Për datën e ndërrimit jetë të Hafiz Halid Bushatit, shënohet se një nga nxënësit e tij të përkushtuar, Hafiz Ibrahim Rrepishti¹⁶, në lidhje me këtë ngjarje, në ditarin e tij shkruante: “Me datën 14 qanuni evel (27 dhjetor 1916) vdes mësuesi i jem Hafiz Halit Begu dhe e varrosin nën minaren e Xhamisë Plakë”.¹⁷

Gjatë qëmtimit të jetës së këtij dijetari, po shënojmë edhe disa

15. “100 personalitetet shqiptare të kulturës Islame”, editor Dr. Genti Kruja & Andrin Rasha, botim i KMSH-së, botimi i tretë, Tiranë 2015:58.

16. Bushati, Hamdi në librin e tij “Shkodra dhe motet”, vëll. II, f. 234-236, duke folur për familjen Repishti, ndër të tjera thekson se: “Halili la dy vajza e nuk pati djalë. Gruan e tij e mori kushëriri i tij Haxhi Brahim Repishti. Nga Brahim Repishti kemi djalin, Jusufin, i cili, sipas shënimeve të tij, ka qenë imam i lagjes Dudas më 1886. Haxhi Jusufi ka qenë njeri shumë fisnik, përmendet për ndihmesën e madhe ndaj të varfërve. Ka studiuar gjithnjë dhe krijoi një bibliotekë të mirë, të cilën më pas e pasuroi i biri Hafiz Ibrahim. Biblioteka ka numëruar rreth 2000 vëllime ku ka pasur kopje unikale librash...” - Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, vëll. II, f. 234-236.

17. Po aty, f. 265.

detaje. Vitet e fundit, i plakur nga mosha dhe nga dhimbja e vdekjes, që e përjetoi keq, së djalit 27 vjeçar i quajtur Ahmed; pothuajse orët e ditës i kalonte në bibliotekën e tij personale, që aq të pasur e kishte. Nga miqtë, e vizitonte shpesh i urti Hafiz Sheuqet Boriçi. Përveç ditorisë që i bashkonte, ishte dhe miqësia. Hafiz Halidi, të shoqen (gruaja e dytë) e kishte nga dera e nderuar e Boriçëve. E quanin Mejreme, por e thërrisnin: Meme. Ndoshta një analogji e rastësishme që, si burrin, të cilin e thërrisnin: “Lito beg”. Dhe për detaje të tjera, na vijnë në ndihmë kujtimet e të nipit, Xhahidit, i cili na rrëfen: “Emrin e gjyshit e trashëgoi njëri nga vëllezërit e mi, i madhi. Edhe atë e quanin Halid. Edhe ai i ditur, por në lëndën e matematikës. Çuditërisht, ashtu si Ahmed, edhe Halidi vdiq në moshën 27-vjeçare, duke e rrëmbyer valët e egra të Drinit. Tani të vijnë te arsyeja pse Hafiz Halidi e la me amanet të varroseq pranë Xhamisë Plakë, rrëzë saj. Arsyeja ishte se, ai kishte shoqëri të ngushtë me Hafiz Halil Pukën. Kur e mësova këtë fakt, aq më shumë që jetoja dhe në lagjen “Zdralej”, dhe nuk e kisha larg ..., shkoja shpesh

te varri i gjyshit. Me mendjen time fëmijërore, mundohesha të vizatoja pozicionin e varrit të gjyshit që nuk e njoha kurrë. Kjo shpesh e ardhjes sime vazhdoi deri në vitin 1976, kur buldozeri komunist me egërsinë e tij shkatërroi Xhaminë Plakë dhe varrin e gjyshit tim. Atë ditë e qava me lot e dhimbje varrin e humbur të gjyshit tim të shtrenjtë. Po atë ditë pashë për herë të parë se cila ishte fytyra e vërtetë e shnjerezores.”

Vitet e fundit Hafiz Halid Bushati është kujtuar në disa veprimtari, të cilat janë organizuar në raste të ndryshme, si: për dekorime, perurime faltoresh, përkujtime personalitetesh etj.

Për ndihmesën e dhënë me veprimtarinë e tij Hafiz Halid Bushati është dekoruar nga Presidenti i Republikës Sali Berisha me Urdhërin “Naim Frashri” të Klasit I-rë në vitin 1994^{18,19}.

18. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, 1997: 152.

19 Artikulli është shkëputur nga libri “100 personalitetet shqiptare të kulturës Islame”, editor Dr. Genti Kruja & Andrin Rasha, botim i KMSH-së, botimi i tretë, Tiranë 2015:55.

Nji andërr e imja

Hafiz Ibrahim Dalliu

Abstrakt

Prej vitesh, duke hulumtuar nëpër arkiva dhe sidomos në AQSH (Arkivin Qendror të Shtetit) në Tiranë, kemi hasur në dokumente të rralla, pjesë e Fondit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, por jo vetëm, ku gjenden në shumicën e rasteve dokumente, libra dhe fotografi, të pabotuara kurrë më parë dhe për rrjedhojë të panjohura edhe për vetë studiuesit e fushave përkatëse.

Pas një pune më shumë se dy vjeçare në kuadër të një projekti për dixhitalizimin e Fondit të KMSH-së në AQSH, u bë e mundur skanimi i rreth gjysmë milioni dokumentesh nga viti 1912-1967, dokumente të sekuestruara nga regjimi komunist, por që për fat janë ruajtur në Arkivin Qendror të Shtetit. Këto dokumente paraqesin një rëndësi të veçantë sepse përmbajnë memorien institucionale të Komunitetit Mysliman Shqiptar, historinë e Islamit në Shqipëri gjatë shekullit të XX, deri në mbylljen zyrtare nga shteti totalitar më 1967, korrespondencën zyrtare me komunitetet e tjera fetare në vend, kongreset e zhvilluara gjatë viteve 20-30, inventarët e pronave vakëf, gjendjen financiare me detaje të hollësishme, burimet njerëzore, etj.

Krabas këtij fondi kemi arritur të gjejmë edhe të dhëna të tjera të rëndësishme, siç është edhe një poemë satirike e dijetarit, prijësit, mësuesit dhe publicistit Hafiz Ibrahim Dalliu. Poema e shkruar në vitin 1922 titullohet “Nji andërr e ime”.

Poema satirike e Hafiz Dalliu ka gjithsej 681 vargje, të shkruara njëshkolonë, me strofa treshe por të pandara.

Kjo poemë e panjohur është krijimtari artistike që i ka çliruar dogmat e kufizimet e kohës, është poemë ku kryqëzohen kohë, kultura, besime, filozofi, mite, mendësi, është poemë ku ndërthuren realja me fantastikën, ku ndeshen kontrastet e antitezat e fuqishme, ku mbruben simbole, që përcillen në kohë, ku marrin kuptime sipërore e sfidohen njeriu me të gjitha ato që përbëjnë jetën e tij sociale, ëndrra e zhytëndrra.


Satira e kësaj poeme të shkruar nga Hafiz Ibrahim Dalliu, vlen edhe për gjendjen e sotme sociale dhe politike, që përjeton Shqipëria.

Hyrje nga Dr. Genti Kruja

Prej vitesh, duke hulumtuar nëpër arkiva dhe sidomos në AQSH (Arkivin Qendror të Shtetit) në Tiranë, kemi hasur në dokumente të rralla, pjesë e Fondit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, por jo vetëm, ku gjenden në shumicën e rasteve dokumente, libra dhe fotografi, të pabotuara kurrë më parë dhe për rrjedhojë të panjohura edhe për vetë studiuesit e fushave përkatëse.

Pas një pune më shumë se dy vjeçare në kuadër të një projekti për dixhitalizimin e Fondit të KMSH-së në AQSH, u bë e mundur skanimi i rreth gjysmë milioni dokumentesh nga viti 1912-1967, dokumente të sekuestruara nga regjimi komunist, por që për fat janë ruajtur në Arkivin Qendror të Shtetit. Këto dokumente paraqesin një rëndësi të veçantë sepse përmbajnë memorien institucionale të Komunitetit Mysliman Shqiptar, historinë e Islamit në Shqipëri gjatë shekullit të XX, deri në mbylljen zyrtare nga shteti totalitar më 1967, korrespondencën zyrtare me komunitetet e tjera fetare në vend, kongreset e zhvilluara gjatë viteve 20-30, inventarët e pronave vakëf, gjendjen financiare me detaje të hollësishme, burimet njerëzore, etj.

Krahas këtij fondi kemi arritur të gjejmë edhe të dhëna të tjera të rëndësishme, siç është edhe një



poemë satirike e dijetarit, prijësit, mësuesit dhe publicistit Hafiz Ibrahim Dalliu. Poema e shkruar në vitin 1922 titullohet “Nji andërr e ime”.

Poema satirike e Hafiz Dalliu ka gjithsej 681 vargje, të shkruara njëshkolonë, me strofa treshe por të pandara.

Pedagogu i gjuhës dhe i letërsisë Prof. Rahim Ombashi është studiuesi i parë, i cili para disa kohësh bëri një studim rreth këtij libri të harruar në arkivat shqiptare, artikull i cili u botua në revistën shkencore “Zani i Naltë”, ku thotë ndër të tjera se, realiteti i zbuluar prej poetit është i dallueshëm prej atij konkret, sepse është virtual dhe sa e sa më i zmadhuar, por gjithnjë shumë personal. Autori është i lirë

të hyjë në mjedise të tilla ku nuk ka mundësi të vëzhgosh. Hapësira e lirisë i është bërë e mundur atij për të mbajtur qëndrim kritik shumë të guximshëm. Më shumë se petku i klerikut të ditur dhe të urtë, këtë mundësi ia jep zgjerimi i hapësirave të lirisë në krijimtari. Poema është kthyer kështu në një pasqyrë që zbulon të vërteta që nuk vjetrohen.¹

Prof. Ombashi thekson se poema “Nji andërr e ime”, është poemë e veçantë e shkruar në kohën e trysnisë së madhe ideologjike, por që i ka shpëtuar asaj trysnie më shumë se ç’ka qenë e mundur dhe se ç’ka qenë e menduar. Kjo poemë e panjohur është krijimtari artistike që i ka çliruar dogmat e kufizimet e kohës, është poemë ku kryqëzohen kohë, kultura, besime, filozofi, mite, mendësi, është poemë ku ndërthuren realja me fantastiken, ku ndeshen kontrastet e antitezat e fuqishme, ku mbruhen simbole, që përcillen në kohë, ku marrin kuptime sipërore e sfidohen njeriu me të gjitha ato që përbëjnë jetën e tij sociale, ëndrra e zhgënjërra. Ndonëse në kushte të vështira, në këtë poemë ndihet fort përcëllimi i fjalës që vret, ku shijohet thellë idhtësia e urrejtjes, njelmësia e fuqia jetësore e smirës, ku regjet e dergjet populli ‘me pes qint halle ne shpine’, ku të rreh padrejtësia e

1 Ombashi, Rahim, “Poemë satirike, që lexohet për vlerat semantike, gjuhësore e stilistike, artistike e letrare”, Revista “Zani i Naltë”, nr. 20, Tiranë, 2017:98.

paaftësia po aq sa jeta, ku mallkimi po mundon të mëdhenj e të vegjël, ku liria dëshirohet e duhet më shumë se ëndrra.

Ky rilexim i parë i poemës “Nji andërr e ime”, që flinte në arkiv, zbulon edhe shumë të fshehta të artit të H. Ibrahim Dalliu, edhe shumë të pathëna e të heshtura të tij, që dalin si nëntekst shumështrësor e që zbulojnë hibridizimin e tij kulturor, që i theksoi ngjyrat e dramës së tij vetjake, por që asokohe iu bë krah në krijimin artistik.”²

Gjuha dhe dialekti i përdorur është lënë si në origjinal së bashku me referencat. Pa u zgjatur më shumë ju ftoj të lexoni për herë të parë këtë poemë të Hafiz Ibrahim Dalliu, satirë e cila vlen edhe për gjendjen e sotme sociale dhe politike, që përjeton Shqipëria.

1.

NJI ANDËRR E IME³

Nji nate fort të muzgëtueme
Kjesh me zemër t’ pezmatueme
Rash n’ shtrat m’i çlodh pak
trutë

Por se gjumi ze me m’rrekun
Fillova keq m’u përprjekun
Ndjeva dhe nji qyqe n’dritë

2 Po aty.

3. Koleksion Fondesh “Hafiz Ibrahim Dalliu”, Emërtimi i sektorit: Veprimtari krijuese “Shtesë 1984”, Dosja Nr. 173, Titulli i Dosjes: Kopje e daktilogruar e poezisë së Hafiz Ibrahim Dalliu me titull: “Nji andërr e imja”.

N'katër anët shpesh shkrepinte
 Gjith kah qielli bubullinte
 Kriste her here nga j'rrefe
 Si tërmet bante hershemi⁴
 Kujtohej se do t'a shemi
 M'at çast Zoti'yne qiell e dhe
 Qyqja ndizej por si furrë
 Si ndoji nuse q'i vdes burri
 ose si ndoj nanë pa djal
 Njashtu mallnjyshëm vajtonte
 Zemren n'fund t'barkut t'a
 lëshonte
 Shpirtin t'këpuste pa fjalë
 Dhe (m..e) hajshe⁵ si poetët
 M'u duk si kur m'dulen fletet
 Mëndja zu me m'fluturue
 Si ndoj'zog po, nëper degët
 Her kah Toskët her kah Gegët
 Mendja ime zue me shkue
 Ma së mrapmi po mundojshe
 Asaj qyq-je t'iu afrojshe
 Qi t'baj m'atë pak kuvend
 Por ajo si e lagu shiu
 Si me qenë ndoj bir njeri
 Erdh nën strehnin t'im zu vend.
 Thash me vehte: Moj e shkretë
 Tue t'pas ba Zoti'yn me fletë
 Kaq i mallnjyeshëm pse qa?
 Ty nuk të ndjekin gjuetarët
 Zemër zitë e zullumqarët
 Kurkush nuk të ndjek me t'vra
 Nuk je si na me j'mi halle
 ç'ke që qa pra, rri e ba valle
 Këndo po gjith natën kangë.
 Nuk je si na qi bërtasim
 Pse s'kimi ku t'shkojm, po
 plasim

4. Gjoja: pothuaj se.

5 Nuk lexohet qartë (shënim i redaksisë).

Jemi si t'burgos me pranga
 M'nj'anë na qajnë granit e fmija
 M'tjetren anë po thurret Shipnija
 Burrani: Thotë për liri
 M'u ba mue m'at ças të errët
 Si kur ndjeva një za t'vdjerret
 E po m'thonte: or njeri!
 Na po qajme per ju te mjeret
 Për punët qi bajne bejlerët
 Bejlerët njata gaddarë⁶
 Qi bahen për t'hujët vegël
 E mundojnë të mdhaj e t'vegjel
 Po grabisin Popllin mbarë
 Përnej na shpezët e natës
 Po qajmë për zogit e të ngratës
 Shqipe, qi kan ngel në errsinë
 Ngrys e gdhi ata perpiqen
 Zbath e xhveshet po terhiqen
 Me pas qint halle në shpinë
 Me niket fare nate të zymët
 Ata shpirtzez, Zemër krymët
 Kush e di ç'hatana⁷ bajnë.
 Kush e di sa gjakna derdhin
 Sa njerz i rrafni e i tredhin,
 Sa zemra granish ankojnë
 Kush e di sa plangje digjen
 Sa njerz prej vjet përpiqen
 Kush e di se ç'ngja në kët botë
 Nesër del Fleta Zyrtare
 Tue rrejte botën ashiqare
 Thotë: Vazhdon qetsi e plotë
 E pra dhe na bashkë me ju
 Duhet me qa pa pushue
 Me vajtue popllin e mjerë
 Qi nuk pa kurr ner e krye
 Për veç koha për mbi krye

6. Gaddar (arabisht): Keqbërës i pamëshirshëm.

7. Hata (arabisht): Mëkat i madh.

Ngeli t'u robnue për herë
 All-llah Allà; ç'e zu nama
 Gjith kah mjerime e gjama
 T'mos shofi prej ku je njerzi;
 S'u gjind ndoj (plis)⁸ i dobishëm
 Me zemër t'pastër, i dishëm
 Q'i t'ju sundojë me drejtësi;
 Prej Tyrqish fort shum keq
 hoqët
 Thue pes qind vjet u përpoqët
 Mbas tyne erdhen të hujet
 Këta pa farë dhimbje ju rropën,
 Ju zhveshen, ju zgërropen
 Dhe mbas tyne po tue vujtë?
 Dëshët një Shqipni të lirët
 Prej t'hujve, krejt të dliirët
 Për faqe ksaj ja mrrite:
 Po ç'dobi ju mbyten tjerët
 Këlysh e t'hujve bejlerët
 S'po ju lanë jo me pa dritë
 S'mendoni pse i derdhni gjaqet?
 Vetëm për me rujtë oxhaqet:
 Turp i madh fort e marri,
 Sot në koh të Bolshevikvet
 T'ju a gjasni ju menshevikët
 T'jeni skllavë pa liri?
 Deri kur ju pas zotnivet
 Si harushat pas arxivet
 Do t'shkoni ksi soj pa mend?
 Kur bahi t'zot e vetit
 T'mos kini frykë prej njeriut
 T'jeni t'libër si në ç'do vend?
 Kur ligjet do t'rspektohen
 Kur vajtimet do t'mbarohen
 T'jetoni si shtet n'Europë?
 Kur ma do t'soset mjerimi
 Kur ma do t'mbretnoje bashkimi
 Mos t'jeni kështu cop mbi copë?

8. Nuk lexohet qartë (shënim i redaksisë).

Kur ma ju burrat e dheut
 S'do t'shkoni pas qejfit beut,
 Po t'punoni me kanun?
 Kur ma gjembat do t'i korрни
 Zullumqarët do t'i shporrni?
 Si kur me shporr taunë:....⁹
 Ksi sojë lot rrëkjë tue
 m'rrjedhun
 N'sabah gjumi m'kishte vjedhun
 Mbas si tepër ishëm lodh
 At-herë zuna me pa andërr
 Sikur jam tue shkue për Llonder
 Njashtu në një qytet të madh
 Sa mrrina aty pari
 Ishte në një kand pazari
 Një park i madh i stolis
 Me lule, druj bukurina
 Vajza t'bukura si hurina¹⁰
 Edhe një tryezë n'midis
 Rreth e qark un n'at park
 t'hishëm
 Pashë disa burra t'çuditshëm
 Shëmtaraqë me barqe t'mdhaj
 Shkëlye syshë e gojët hapët
 Si zagarët(n'dhe)¹¹ për vapët
 Kamë e durët plot me thoj
 M'hyni fryk praj sosh u qasa
 Me një shok m'at çast un hasa
 Bashkë me të zumë me shëtit
 I thash shokut: Mor vallahi:
 Ky asht ndo j'vend padishahi
 T'lutem prej këndeje na qit:
 Jo! jo! M'tha: Zotni! Mos tuti
 Se s'asht vend i huj, mos nguti

9. Taun (arabisht): Murtaje, sëmundje epidemike e rrezikshme.

10. Hurii (arabisht): Femna te bukura të xhenetit.

11. Nuk lexohet qartë (shënim i redaksisë).

Eja me mue, vështro
 Po, shif se ç'kan ba njerzija
 Veni vesh dhe fjalve t'mija
 Kot më kot mos kundërshto:
 Pik së pari shif tryezën
 Me gjella që të dynin ndezën
 Gjella të cilat bahen rrallë
 Qi t'i lëshojn jargët ke kambët
 T'bajn m'at cast t'i prefish
 dhambët

Dru se të vdekmin kan m'e
 ngjallë!

Ç'me pa, ishin gjith të mirat
 Me t'i mbush po, gjith dëshirat
 T'kendojë gërmazi si gjel
 Kishte gjithfar ambëlsinash
 Si me pas dal prej maqinash
 Gja t'lemueta, mos me t'ngel
 Për t'cel anën, raki rrushi
 T'cillen s'e ka pi kurkushi
 Birr, Vermut e Fërnet
 Shampaj e shishe konjaku
 Edhe venë t'kuqe si gjaku
 Qi gjinden veç n'ahiret¹²
 Rreth e qark pjatat me meze
 Si i meritojnë kesaj tryeze
 Pemë, hudhra, djathe të njomë,
 Qofte t'thata, kofsha gjelash
 Thokrrue kuq kuq; gjja
 Ha kaj çapë e bahu lamë
 E kishin stolis allafanga
 Bukuri, tue kërcit kanga
 Me kokona e çenji¹³
 Si thonë Tyrqit: "Vurr patllasën"
 Mëshoj shengut "çall ojnasën"¹⁴

12. Ahiret (Arabisht): ajo bote.

13. Çenji (Tyrqisht çengji): Kangtare valltare prostit.ta.

14. Vurr patllasën, çall ojnasën: shprehje

Qi t'ken dhe frëngjit zili
 Ju kthysh shokut t'em a i themi:
 Mor vëlla! Na ksi soj ku jemi?
 A po thue jemi n'xhenet?!
 Ç'jan këta salltanete t'hishme
 Vende t'bukra, gjella t'shieshme?
 Jo, m'tha: Jemi në Kryeqytet
 N'kopësht t'pallatit të mbretit
 Qi ja gjas lulishteve t'xhenetit
 Po, njashtu për faqe t'bardhë.
 Ky pallat thash, kur asht ngrefun
 Kësaj dite ja paçim nje fun
 Mbreti kah na paska ardhe?
 Po-po më tha: Ka ardh që moti
 Me disa malokë prej Mati
 Shqipninë shyqyr na e ka ndrit
 Aj shpëtimtar i atdheut
 Nip stërnip i Skënderbeut
 Ahmet Zogu si Jezid¹⁵
 Dhe këta njerz që jan rreth
 parkut

Qi i prujn veç pykës e barkut¹⁶
 Jan robt e nalt madhnisë
 Dahan në tri katër këshilla
 Qi s'ti ka toka as qilli
 Kto i kryejnë punët Shqipnis
 Po po, i zanë mbar edhe i sosin
 Kët tryezë njëkta e kullosin
 Me katër rryla, pa pra.
 Ktyne kurkush mos t'ju nami
 Po lypset të tanë t'ju thomi:

tyrqisht e cila përdorej me qëllim përbuzjeje me kuptimin: Ha, pi e argëtohu se për vuajtjet e popullit mos e çaj kokën fare.

15. Jezid: Mbret Emevili i biri i Mavijes, i cili vrau Imam Hysejnin, nipin e Muhamedit tue terhek mbi veten e tijë merine e botës myslimane, siç e ka përshkruar dhe Naim Frashëri ne librin Qerbela.

16. Me prujte: Me u perpjek për një qëllim.

Hani sa t'mos leni gja
 Hani, pini, fryhi, lahi
 Ngopi ekselencia e fahi
 Se na e fali i madhi Zot.
 Tak tuk pa pra si sahati
 Mëshoni, se na ndrifi fati
 Na erdh qyl si kot më kot
 Kurrë s'e deshëm, kjo kot erdhi
 Kush për të pikë gjaku s'derdhi
 Hani pra tue gërthit: Rroftë!
 Mos shikoni rreth e qarkun
 (Fani)¹⁷ xhangen edhe barkun
 N'u prishtë në t's'amës i qoftë
 Vërtet ne na ka ndif fati
 Ma n'fund u vra dhe Esati
 Qi pat qenë ba diktator
 Ku s'i shkoi n'mend far njeriut
 Q'i t'a vrasë Aj far Avniut
 Dësh Zoti shyqyr u shporr.
 Pra si shkune Tyrqit e rrebet
 Hiken Grekët edhe Serbët
 Nuk na ngeli ma ngatrrësë
 Sa për mikropat e mbrendshëm
 Me qenë se na jemi t'menshëm
 I shporrim vetë besa besë!
 Shyqyr na u dëlirë Shqipnija
 Na e fali kot Perëndija
 Rroftë deti Adriatik
 Ani pse s'kimi donanma¹⁸
 Se ata ndreqen nesër mrama
 Po, i ndreqim për një dakik
 Le qi s'kemi prej kuj droje
 Pse t'punojmë pa far nevoje
 Veç t'hamë e t'pimë me lezet
 Neve tashti na u mshi loti
 Ç'na duhet pushka e baroti

17. Nuk lexohet qartë (shënim i redaksisë).

18. Donanma (Tyrqisht): Flotë detare (Danome) dialekt Tirane.

Armiqt qark jan tu fjet.
 Ç'i duem punët e fabrikat
 Ç'po t'lypsen Elektriakat
 Kimi Hanë e Yje e Diell
 C'po na duhen inxhinjerët
 Kimi Eshrefin e ata tjerët
 Rugat shesh jan deri n'qiell
 Pra¹⁹ se s'kemi aeroplana
 Këto i ndreqim te tana
 Po po se i godisim vetë
 Bile kta s'na duhen fare
 Pse t'thyjmë qafen me tajare²⁰
 Na jemi shqipe me fletë
 Ç't'i bajm organizatorët
 A s'mjaftojnë për ne popullorët²¹
 Popullor popullor qi s'ka pa
 E pra tashti t'marrim pagëz
 vallen
 Qi t'çudisim gjith muhallen
 Se Shteti far t'mete s'ka²²
 Ç'ka pse bahen ca zullume
 Gjithkrah krisin bam e bumë
 Na shyqyr kemi bashkim
 Bashkim bashkim me gjith
 zemër
 Dashni t'plotë porsì shemër
 Nji në lindje tjetri n'perëndim
 Orthodoxit porsì t'verbët
 Dëshirojnë Grekun ose Serbët
 Katolikt dunë Italinë

19. Pra: S'ka gja, s'ka se pse.

20. Tajare (arabisht) aeroplan.

21. Popullorët: Parti e cila mbante Ahmet Zogun në fuqi. Sa do qi quhej popullore edhe bejlerët aty ishin. Këta fjalë autor i ka përdor gjithnji për përbuzje: Popullorët.

22. Kemi pësue si Nastradini kur i tha bujtësit: Të kisha pas miell e voj do të bëja një amëlsinë, por nuk kam sheqer se kusinë e gjejshta nëpër fqinjët. (Autori)

Myslimant presin Qemalin
 Si pret Nana e baba djalin
 Ksisojë do t'a bajmë Shqipnin.
 Ani pse nuk kimi pare
 Se dhe ksaj ja gjejm një çare
 Vejmë taksa t'randa gjith kund
 Shesim pyjet e çifliqet
 Se kush shet kurr nuk fëlliqet
 Deri sa t'i dalim n'fund.
 Po po përse me e ça kokën
 Për metale t'gërmojm tokën
 Populli jonë ka pare mjaft
 N'qoftë se i mejnë pak arkës
 shtetit
 N'qoft se nuk ja mbrri buxhetit
 Kanë tuxharët n'paitaft²³
 Në mos dhenshin hua, ne burg
 futi
 Se kurkush s'ban za, mos tuti
 Sepse ata janë si bagtia
 Tue i shtrengue apin m't'katra
 Vin dhe miljona nga Vatra
 Keshtu rrjedh alltuni n'Shqipni
 Ne shyqyr na u librue qarku
 Hani sa t'ju plasi barku
 Rrofshin poplloret tue thane:
 Ç'duhet Çameri e Kosove²⁴
 Mjaft asht per ne Domuzdova
 Mos t'na trazojne qefin t'one
 Ata le t'shtypen nen themer
 Se s'jan perbark e per zemer
 Jan per s'tepri fanatikë
 Në qoft se u çajne koken teper
 Juga dhe Shqipni e eper²⁵

23. Pajitaft (Persisht Paitaht): Kryeqytet

24. Autori bën thirrje për shpëtimin e Shën Naumit, por nuk lexohet dot e gjithë fjalia në referenca (shënim i redaksisë).

25. Jugu dhe Shqipni e eper: Autori ka për

Thoni keshtu, preju me thikë:
 Gjith kush ka hallet e veta
 Rrini pak nen bajoneta
 Mos nguti, kadal kadalë
 Robnoni iher e perpiqi
 Vriti, shkrihi edhe digji
 Se dhe na flasim kaj fjale
 Protestojme ke gjith dynjaja
 Ma fort ke mbretnit e mdhaja
 Ju mos bani budalla
 Se per s'shpejti do t'shpejtoni
 Vendet tueja do t'i gezoni
 Po po ishalla mashalla
 Politikisht thoni llafet
 M'asi fjalesh i shporrni qafet
 Edhe rrini teveqel
 Hani e pini, mos e ngreni
 Kasavetet mrapa leni
 Se ashtu e don ky rod rrebel.
 I thash shokut m'turbullove
 Praj se menden m'a hutove
 Ç'jan kto fjale kshtu pa logjike
 Fol drejt Allahi seversen²⁶
 Se m'lodhe e m'qite djersen
 Ose m'ep leje me ike
 M'tha jo jo, se e dha Zoti
 Pa u mundue kot se koti
 Jo, harrova mor jahu:
 Se jan mundue ata t'ndershmit
 Ti kujton hala se t'hershmit²⁷
 Jo jo se ashtu ke gabu
 T'hershmit sot quhen storira
 Paçin ndjes thuj, edhe t'mira

qëllim Çamërinë dhe Kosovën.

26. Allahi seversen (shprehje Tyrqisht): Ne do Perëndia.

27. Te hershmit: Te vjetrit, d.m.th. Patriotet e Rilindjes te cilët kane qene marre neper kambe siç pershkruan poeti.

Venju kaj qeri n'mezare²⁸
 Ne qofshin gjalle thuju tradhtore
 Se pse nuk jeni Popullorë
 Pranej duhet gri ndo vare
 Esadiste, thuj, e xhahila
 Grekomanë, Italofila
 Keshtu vulosi me kaj njolle
 Veni gjith far soj ofiqi
 Hiqi prej pune e ndiqi
 Qi t'perpiqen pors bollë
 Fort e fort po kjene Tiranas
 Kruetanë edhe Elbasanas
 Ktyne ngreja lugen n'trate
 Hele hele t'mjerit Geges
 M'at çast thuj, nuk je i deges
 Lene gjithmone me goje thatel!
 Po t'thamë m'a hjekt din e imani
 Shqipninë a di kush e bani?
 Kongres i Lushnjes t'a dijshe!
 Njaj Kongres i madhnushem
 Qi vue Statutn e mbarshem
 Qi shkelqen pors pishë.
 Statutin me kater pika
 Qi s't'a ka as Afrika
 Vjen rryp ai si llastik
 Kah t'a kesh qefin terhiqe
 Cilin do hiqe e perpiqe
 I bindet ç'do mik e anmik
 Veç Serbofil mos u thoni
 Se ashtu n'mine takoni
 Ose sharra n'gozhde ju bie
 Sepse edhe kta shkelqesat
 Gjith atje i kan varun shpresat
 Por jo n'Serbin' Jugosllavi!
 Pse e ke, kush do t'shkoj per
 para
 Gjith andej t'i vi e mbara
 T'rrokot ket mubareq Statut,

28. Mezare (Tyrqisht): Vorr.

Qi asht i shejt pors ungjilli
 Si kur me pas zbrit nga qielli,
 N'mos besofsh bahesh çifut.
 O statut t'falte Allahu
 Ty s'mund t'ndryshoje as
 Vinjahu
 Qe asht mesh-hur advokat²⁹
 Orator qi qep me nyja
 I shkelqejne fjalet si yja
 Venizello n'i ardh t'najt
